

# PERSPEKTIVA GJINORE NË SHQIPËRI

Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave 2001

Ndalohet riprodhimii këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

**Copyright © INSTAT 2004**



**INSTAT**

Instituti i Statistikes

Rr. Lek Dukagjini, Nr.5, Tirane

Tel: +355 4 222411/230484

Fax: +355 4 228300

E-mail: [botim\\_difuzion@instat.gov.al](mailto:botim_difuzion@instat.gov.al)

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

ISBN 99927-973-5-5

**N**xjerrja e kësaj serie studimesh me karakter social përbën një moment të rëndësishëm në jetën profesionale të INSTAT.

Informacioni i mbledhur gjatë Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2001 si dhe të dhënat e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës 2002, u përdorën si burime kryesore të dhënash për të analizuar fenomene të tilla si migracioni i dekadës së fundit, lëvizja e brendshme e popullsisë, gjendja e tregut të punës, impakti që kanë keto çështje në jetën e grave dhe burrave, në problemet e pabarazisë dhe të situatës së nivelit të jetesës, si dhe u përdor në projeksionet e popullsisë për periudhën 2001-2021.

Këto studime kanë rëndësi të veçantë për hartuesit e politikave dhe për hulumtues të disiplinave të ndryshme. Ato mund të përdoren për të kuptuar se si duhet të punohet për zbutjen e pabarazisë, si mund të investohet në infrastrukturën e shërbimeve, se si mund të ndihmohet autoritetet lokale për të hartuar politika të veçanta për grupet në nevojë.

Studimet gjithashtu hedhin dritë edhe në situatën e objektivave të mileniumit në Shqipëri dhe japin më shumë elemente për monitorimin e tyre të vazhdueshëm. Këto studime janë fryt i bashkëpunimit disamujor të ekspertëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve lokale. Gjithashtu ato janë edhe dëshmi e një rrjeti lokal studiuesish që fillon të bashkëpunojë me INSTAT, në analizimin e fenomeneve sociale.

INSTAT përfiton nga ky rast për të falenderuar Agjencinë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Zyrën për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Italisë, të cilet mbështeten dhe koordinuan punën për kryerjen e këtyre botimeve.

**Milva Ekonomi**

Drejtor i Përgjithshëm

	<b>HYRJE</b>	<b>7</b>
<b>1</b>	<b>ÇËSHITJE KONCEPTUALE</b>	<b>11</b>
1.1	Gjinia	11
1.1.1	Gjinia si njësi e analizës	11
1.1.2	Treguesit e mundshëm për vlerësimin e situatave të burrave dhe të grave	13
1.1.3	Njësia ekonomike familjare	15
1.2	Migrimi	16
<b>2</b>	<b>HISTORIA E MIGRIMIT TË BRENDSHËM DHE MARRËDHËNIET GJINORE NË SHQIPËRI</b>	<b>19</b>
2.1	Migrimi	19
2.2	Përshkrimi i marrëdhënieve gjinore në Shqipëri	20
2.3	Ndërthurja e migrimit dhe gjinisë	27
<b>3</b>	<b>VËZHGIME METODOLOGJIKE</b>	<b>29</b>
3.1	Të dhënat	29
3.2	Kufizimet metodologjike	29
3.3	Treguesit	32
<b>4</b>	<b>REZULTATET</b>	<b>35</b>
4.1	Përshkrimi i rajoneve të migrimit dhe familjeve	35
4.1.1	Konkluzion: Karakteristikat e njësive ekonomike familjare dhe të familjes në lidhje me gjininë dhe ndryshimet në marrëdhëniet gjinore.	42
4.2	Arsimi	44
4.2.1	Konkluzion: Treguesit e kapitalit njerëzor përsa i përket gjinisë	48
4.3	Tregu i punës	49
4.3.1	Konkluzione në lidhje me migrimin, gjininë dhe tregun e punës	53
4.4	Kushtet e jetesës	53
4.4.1	Konkluzione në lidhje me kushtet e jetesës së njësive ekonomike familjare të ndryshme	55
<b>5</b>	<b>DISKUTIM DHE KONKLUZIONE</b>	<b>57</b>
<b>6</b>	<b>BIBLIOGRAFIA</b>	<b>61</b>

**TABELAT DHE FIGURAT**

Tabela 1: Treguesit e përdorur për të zbatuar një perspektive gjinore në statistike në Regjistrimin shqiptar	33
Table 2: Kryefamiljarët sipas moshës, dhe migrantët krahasuar me jo- migrantët	36
Table 3: Shpërndarja e tipeve të njësive ekonomike familjare në bazë të kryefamiljarëve	37
Table 4: Shpërndarja e tipeve të njësive ekonomike familjare sipas kryefamiljarit dhe statusit të migrimit	38
Table 5: Statusi martesor i grave kryefamiljare në njësitë ekonomike familjare me një person	39
Table 6: Shkalla e varësisë, madhësia dhe përbërja e njësive ekonomike familjare sipas gjinisë dhe statusit të migrimit	40
Table 7: Përqindja e kryefamiljarëve migrantë dhe jo-migrantë sipas tipit të statusit të punës	50
Table 8: Përqindja e kryefamiljarëve migrantë dhe jo-migrantë sipas orëve të punës	51
<hr/>	
Figure 1: Shpërndarja e moshës në njësitë ekonomike familjare me një person sipas seksit (në përqindje së totalit të grupit)	37
Figure 2: Mosha në martesë në rast se është martuar para 1991	41
Figure 3: Mosha në martesë ne rast se është martuar në 1991 ose më vonë	41
Figure 4: Numri i viteve të shkollës të përfunduara sipas moshës dhe seksit	43
Figure 5: Gratë: Numri i viteve të shkollës të përfunduara sipas moshës në bazë të rajoneve që fitojnë ose humbasin popullsi	43
Figure 6: Përqindja dhe mosha e fëmijëve me të paktën një vit shkollë të përfunduar sipas seksit dhe rajoneve që fitojnë ose humbasin popullsi	45
Figure 7: Përqindja e atyre që kanë marrë diplomë të shkollës së mesme sipas seksit dhe statusit të migrimit	
Figure 8: Gratë: Mosha në martesën e fundit krahasuar me numrin mesatar të viteve të shkollës së mbaruar, sipas rajonit	47
Figure 9: Gratë: Mosha në martesën e fundit krahasuar me numrin mesatar të viteve të shkollës së mbaruar, sipas statusit të migrimit	47
Figure 10: Orët mesatare të punës në javë të grave të punësuar	51
Figure 11: Raporti i mallrave të luksit me mallrat bazë të njësisë ekonomike familjare, sipas gjinisë së kryefamiljarit/kryefamiljares	53
Figure 12: Dallimi midis mallrave të luksit me mallrat bazë sipas statusit të migrimit.	54



Që në fillimet e viteve 1990, kanë ndodhur procese të shpejta transformimi në të gjitha nivelet e shoqërisë shqiptare. Gjatë përshkrimit të këtyre proceseve, ne përdorim termin “transformim” për t’iu referuar një periudhe ndryshimesh me potencialin që në fund të arrihet tek njëri nga moria e rezultateve të mundshme. Ky term ndryshon nga termi “tranzicion”, të cilin shumë vetë e përdorin për të përshkruar procese me finalitet më të madh, për shembull, tranzicioni nga një regjim socialist në demokraci, apo nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu (Saltmarshe 2001). Si shembull i ndryshimeve që po ndodhin në Shqipëri mund të merret ai i popullsisë kryesisht rurale që është përfshirë në një proces të dukshëm urbanizimi, ku përqindja e banorëve ruralë është ulur me 13% në një shtrirje kohore prej njëmbëdhjetë vjetësh. Migrimi i brendshëm është një nga faktorët më të rëndësishëm që kontribuon në këtë proces transformimi. Në vendet në zhvillim, migrimi i madh i brendshëm, shpesh shoqërohet me një urbanizim të përshpejtuar që ka dalë jashtë kontrollit. Ndër efektet e padëshiruara që mund të shfaqen rëndom bashkë me migrimin drejt qyteteve, janë ngritja e vendqëndrimeve të paligjshme, lindja e getove, pamundësia e ruajtjes së kushteve të mjaftueshme sanitare për banesat, mungesa e shkollave, përqindja e lartë e papunësisë, raste të shumta të krimit, shpërbërje të lidhjeve familjare dhe të kontrollit social, si dhe një nivel i lartë i prostitucionit e i dhunës familjare. Fakti që një e pesta e popullsisë shqiptare ka emigruar jashtë vendit që në 1989, i ka krijuar vendit një valvolë të rëndësishme presioni, që ndihmon për luftimin e efekteve të këqija të urbanizimit të shpejtë. Megjithatë, autorë të ndryshëm i kanë dokumentuar efektet negative të shkaktuara nga migrimi i brendshëm në Shqipëri (p.sh. La Cava dhe Nanetti 2000), disa nga të cilat janë mjaft të dukshme në rrethin e Tiranës.

Termi transformim është një term i drejtë nëse qëndron argumenti i përdorur nga de Gaay

### Perspektiva gjinore

A ndikon migrimi i brendshëm në mënyra të ndryshme në jetën e grave dhe të burrave shqiptarë?

“Gjinia është një element thelbësor për të analizuar urbanizimin e vendeve në zhvillim. Jo vetëm që rritja ekonomike urbane shpesh nxit ndryshime në rolet midis gjinive, në marrëdhëniet dhe në pabarazitë midis tyre, por procesi i urbanizimit në vetvete, shpesh formohet në varësi të strukturave mbizotëruese të gjinisë. Me fjalë të tjera, shkaqet, natyra dhe rezultatet e urbanizimit mund të varen shumë nga gjinia. Njohja e kësaj dukurie është e domosdoshme si për të kuptuarit e evolucionit urban e të rrjedhojave të tij, ashtu edhe për formulimin e politikave” (Chant 1996:1).

Fortman. Ai shkruan se Shqipëria “nuk ka kaluar nëpër proceset historike të Rilindjes dhe të Iluminizmit, të cilat patën ndikimin e tyre në pjesën më të madhe të Europës” dhe se Shqipëria është një vend “ku në kohërat më të vona, moderniteti nuk pati asnjëherë një mundësi tjetër për t’u trupëzuar në kulturën e vendit” (de Gaay Fortman 2000:85).

Përveç migrimit, edhe ndryshimet në parimet e organizimit të shoqërisë shqiptare, që kanë ndodhur pas rrëzimit të regjimit socialist (duke përfshirë zhvillimet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore) janë thelbësore për të kuptuar transformimin e vendit. Në shtetet e tjera ku kanë ndodhur transformime të njëjta, është parë se ndryshimet kanë ndikuar në mënyra të ndryshme në mundësitë e grupeve të ndryshme të popullsisë. Gratë përbëjnë një grup të tillë. Për shkak të pozicionit thuajse të barabartë të grave dhe burrave në regjimet socialiste në lidhje me peshën e tyre në tregun e punës dhe nivelin e arsimimit të tyre, si dhe për shkak të ekzistencës së lehtësirave në ndihmë të nevojave të veçanta të grave në këto regjime, si kujdesi për fëmijën dhe ai për të moshuarit, del e nevojshme të bëhet një monitorim i kujdesshëm i ndryshimeve në këto fusha, për të siguruar që gratë të kenë mundësi të përafërta ose të barabarta gjatë periudhës së transformimit. Siç është

dokumentuar në vendet e tjera ish socialiste, marrëdhëniet gjinore po marrin trajta të tjera për shkak të ndryshimeve që rezultojnë prej rënies së sistemit socialist, përfshirë ndryshimet zyrtare në ekonominë kombëtare, si dhe integrimin në ekonominë botërore (Gal dhe Kligman 2000). Kjo është e vërtetë në veçanti në rastin e Shqipërisë, një vend i izoluar për shumë vjet nga pjesa tjetër e botës.

Fokusi i kësaj studimi është të kombinojë dhe të analizojë dy tipare të rëndësishme të procesit të transformimit të Shqipërisë – fluksin e migrimit të brendshëm në shkallë të gjërë dhe ndryshimet në statusin relativ të burrave e grave në shoqëri. Synimi ynë është që në analizën e procesit të migrimit të brendshëm të përdorim një perspektivë gjinore.

Si ndikon migrimi i brendshëm tek situatat relative të burrave e grave migrantë? Si ndryshojnë standardet e matshme të jetesës kur njerëzit migrojnë, në krahasim me rastin kur ata nuk migrojnë? Si ndryshojnë mundësitë ekonomike e sociale në varësi të rrethave që humbasin, ose përftojnë popullsi? Sipas argumentit të mësipërm të Chant-it, ne mendojmë se migrimi i brendshëm është një proces gjinor, ku mundësitë dhe rezultatet e përftuara ndryshojnë nga burrat tek gratë. Ne presim që këto të ndryshojnë në bazë të ndarjes themelore të punës që haset zakonisht në familje, në komunitet dhe, përgjithësisht, në shoqëri. Ndryshimet në mundësitë që ofrohen, krijojnë, ndryshojnë, ose përforcojnë vlerat e zakonshme të shoqërisë përsa i përket roleve të meshkujve e të femrave në të, të cilat, gjithashtu, mund të ndikojnë në statusin relativ të burrave dhe grave në përgjithësi. Për rrjedhojë, në këtë studim në jemi marrë me situatën individuale dhe strukturore të grave e burrave, siç pasqyrohet në të dhënat e Regjistrimit Shqiptar të 2001. Ne synojmë të kuptojmë cilat janë ato role në Shqipëri që lidhen me të vërtetë me gjininë, si dhe të identifikojmë ato

ndryshime që kanë më shumë mundësi të ndikojnë në mënyra të ndryshme në situatat e burrave dhe të grave. Për të arritur këtë, ne bëjmë një përshkrim të rrethanave aktuale të burrave e grave në Shqipëri, dhe më pas, vlerësojmë se sa këto pabarazi të sotme apo të ardhme do të ndikojnë në mundësitë e tyre, sipas gjinisë. Për këtë arsye ne nuk hyjmë në analiza se si ndikon gjinia në formimin e marrëdhënieve midis burrave e grave, dhe as merremi me efektin që ka gjinia tek identiteti i vetë personit. Thjesht, ne përshkruajmë situatën sot në Shqipëri duke përdorur të dhënat e përftuara nga Regjistrimi i 2001. Kjo do të thotë se ne do të lëmë mënjanë me ndërgjegje cilësitë imagjinare dhe simbolike të shoqërisë gjinore (d.m.th. diskutimet publike rreth problemit të gjinisë, përfaqësimit të grave në media, etj).

Në këtë mënyrë, pyetjet tona bazë janë: çfarë formash të pabarazisë gjinore po krijohen si rezultat i këtyre proceseve transformimesh drastike? Në ç'mënyrë ndryshon gjendja e burrave dhe e grave migrante nga ata që nuk kanë migruar? A janë këto ndryshime një tregues që migrimi është një proces i lidhur me gjininë? Dhe çfarë rrjedhojash nënkuptojnë këto ndryshime për gratë dhe burrat?

Me këtë përjasje, ne shpresojmë të plotësojmë një boshllëk në literaturën historike për vendet post-socialiste, një literaturë kjo të cilës shpesh i mungon analiza sasiore e procesit të transformimit nga pikëpamja sociale. Po ashtu, ne shpresojmë t'i japim Regjistrimit Shqiptar të 2001 një dimension historik me anë të përfshirjes në të të një vëzhgimi mbi migrimin në Shqipëri që në fillimet e shekullit të kaluar, dhe me anë të një përshkrimi të organizmit shoqëror shqiptar para, gjatë, dhe pas socializmit.

Ky punim është strukturuar si vijon: Seksioni i merret me çështje konceptuale që janë të rëndësishme për rolet e të dy gjinive dhe për



migrimin e brendshëm në Shqipëri. Në Seksionin 2, ne ofrojmë një kuadër historik për analizat tona, duke bërë një vëzhgim statistikor të migrimit të brendshëm shqiptar, si dhe një përshkrim korrespondues të roleve të gjinive. Në Seksionin 3, ne përshkruajmë të dhënat ekzistuese dhe mangësitë e tyre për qëllimet tona. Ne, po ashtu, bëjmë një përkufizim të treguesve që përdorim për analizën tonë. Në Seksionin 4, paraqesim rezultatet. Hipotezat tona ne i formulojmë në ato raste kur ato duken të besueshme, pavarësisht nga situata në terren që ndryshon me shpejtësi. Seksionin 4.1 e fillojmë duke bërë dallimin midis rretheve të Shqipërisë bazuar në faktin nëse ato (1) humbasin popullsi, apo (2) përftojnë popullsi. Seksionet 4.2 deri 4.4 hedhin një vështrim mbi ato fusha ku situatat materiale të burrave dhe grave mund të ndryshojnë sistematikisht, dhe që në këtë mënyrë, kanë një domethënie të madhe në zhvillimin e ardhshëm të Shqipërisë. Seksioni 5 përmbledh gjetjet tona dhe diskuton mbi implikimet e tyre.



## Çështje konceptuale

### 1.1 GJINIA <sup>1</sup>

#### 1.1.1 Gjinia si njësi e analizës

Gjinia është një parim kryesor organizues i shoqërisë. Gjinia, si dimensioni social-kulturor i dallimit të sekseve, konsiderohet e ndryshme nga seksi: gjinia i referohet konstrakteve social-kulturore – ideve që kanë të bëjnë me atë çka do të thotë të jesh “burrë” apo “grua”, të jesh “mashkullor” apo “femëror”, – që ndërtohen në bazë të dallimeve seksuale biologjike. Këto kuptime, të cilat ndryshojnë sipas rrethanave të tyre kulturore e historike, strukturojnë dhe justifikojnë pabarazitë midis

Gjinia është një konstrukt shoqëror i asaj çka gratë dhe burrat janë, i asaj që kanë qenë, dhe i asaj që duhet të jenë (koncepte normative) në një kohë të dhënë dhe në një kontekst të dhënë.

Në këtë seksion në përcaktojmë dy nga çështjet më të rëndësishme konceptuale për studimin tonë: gjininë dhe migrimin. Së pari, përqëndrohemi tek koncepti gjini si një njësi e analizës sonë dhe, më pas, përshkruajmë tregues të mundshëm që na lejojnë të identifikojmë ekuivalentët e saj operacionalë. Po ashtu, shkurtimisht trajtojmë rëndësinë e familjes për të bërë një analizë gjinore. Në Seksionin 1.2 përqëndrohemi tek migrimi.

burrave e grave në fusha të ndryshme të jetës shoqërore. Termi “marrëdhënie gjinore” i referohet marrëdhënive të pushteteve midis grave e burrave që ekzistojnë në një gamë praktikash, idesh dhe përfaqësimesh. Këtu përfshihet ndarja e punës, caktimi i roleve, shpërndarja e burimeve dhe perceptimi i përgjithshëm i aftësive femërore e mashkullore, i sjelljeve, dëshirave, tipareve personale, modeleve të sjelljes së tyre, e kështu me radhë (Bahsin 2000). Prandaj gjinia, luan një rol sistematik në jetën e përditshme, duke prodhuar përvoja dhe pasoja të ndryshme për gratë dhe burrat në shumë fusha.<sup>2</sup>

*“Padukshmëria” e gjinisë:* Pjesa më e madhe e njerëzve supozojnë se gjinia (ashtu si raca, grupi etnik, apo mosha) është pjesë e

<sup>1</sup>Shumë nga diskutimet konceptuale në lidhje me gjininë janë frymëzuar dhe huazuar nga Janet Saltzman Chafetz (1990-1991).

<sup>2</sup>Megjithëse gjinia i referohet burrave dhe grave, shumë nga punët kërkimore kanë patur tendencë ta përdorin termin vetëm në kontekstin e grave. Ky zakon vjen nga zhvillimi i kërkimeve gjinore - që nga origjina e tyre, nga autore gra (afërsisht që nga vitet 1970), duke kaluar më pas nëpër fazën e studimeve me orientim feminist (afërsisht vitet 1980) dhe duke mbërritur në studime të plota gjinore, ku gjinia shihet si një kategori analitike. Duke patur parasysh origjinat e saj, bëhet e qartë pra përse gjinia shpesh konsiderohet si një ‘perspektivë grash’. Meqenëse në mënyrë tipike burrat kanë qenë më të favorizuar dhe më të angazhuar me studime, situata e tyre është analizuar shumë më shpesh se ajo e grave. Si pasojë, përkufizimi i tyre për realitetin është përdorur gjerësisht për të përcaktuar edhe realitetin e grave (Visweswaran 1997). Kjo ka çuar, ndër të tjera, drejt ‘padukshmërisë’ së gjinisë. Falenderojmë Janine Dahinden për kontributin e saj në këtë çështje gjatë mbledhjes së parë ku u shqyrtua perspektiva gjinore në statistikë, në maj 2003.

pandashme e natyrës së çdo individi; ajo konsiderohet si një karakteristikë e natyrshme e qënieve njerëzore, e dhënë njëherë e përgjithmonë dhe e pandryshueshme. Kjo krijon "paragjykime" të vazhdueshme për atë çka janë gratë dhe burrat, për nevojat e tyre, vendin e tyre në shoqëri, punën që duhet të kryejnë, si dhe për aftësinë më të madhe të një gjinie në krahasim me tjetrën, etj. Këto paragjykime legjitimohen në mënyrë sipërfaqësore nga dallimet biologjike. Megjithatë dallimet biologjike e bëjnë të dukshme gjininë, në fakt, gjinia (të qenit burrë; të qenit grua) realisht përcaktohet nga një kontekst shumë më i gjërë. Domethënia që ka të qenit burrë apo grua, është thjesht një konstrukt social-kulturor. Normat dhe vlerat shoqërore, dhe shpesh edhe ato fetare ndikojnë dhe legjitimojnë këtë konstrukt social-kulturor. Konstrukti më pas riprodhohet nëpërmjet praktikave të institucionalizuara të shoqërisë.

Duke e zhvendosur përkufizimin tonë të gjinisë nga konteksti natyror, ne vëmë në diskutim mënyrën e zakonshme të perceptimit të identitetit individual. Kjo është thelbësore, duke qenë se identiteti luan një rol qendror në përcaktimin e statusit të një personi brenda familjes, komunitetit dhe shoqërisë. Për më tej, caktimi i roleve gjinore brenda familjes një-qelizore dhe asaj të zgjeruar, po ashtu kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në rendet social-kulturore dhe simbolike, të cilat krijojnë ide rreth gjinisë në radhë të parë. Procesi është ciklik dhe, në këtë mënyrë, ushtron një rezistencë të fortë ndaj ndryshimit të asaj që tashmë është sanksionuar në rendin social-kulturor. Këto rende pasqyrohen në jetën e përditshme, në mundësitë e

ndryshme individuale dhe strukturore që u ofrohen grave dhe burrave.<sup>3</sup>

Kjo nënkupton ndarje të pabarabartë të mallrave me vlerë dhe bazohet mbi marrëdhënie të pabarabarta të pushtetit të mbështetura si në rendin material (p.sh. sistemin politik dhe ekonomik) ashtu edhe në atë shoqëror (sistemet fetare apo simbolike, normat dhe vlerat kulturore). Më së shumti, pabarazia gjinore është një çështje mase, megjithatë mund të jetë gjithashtu një çështje e një dikotomie të qartë: për shembull, kur sistemet ligjore ruajnë të drejta dhe mundësi specifike për një gjini apo një tjetër (p.sh. mundësia për të votuar apo për të marrë një profesion të caktuar). Së fundi, nëse gjinia gjendet në sferat personale, strukturore, imagjinare dhe simbolike, atëherë ajo do të jetë e pranishme në një mori fushash analitike.

*Gjinia është një dukuri mikro, meso [e nivelit të mesëm], dhe makro: në rast se gjinia është një parim shtresor i shoqërisë, atëherë pabarazitë gjinore duhet të ekzistojnë në të gjitha nivelet shoqërore: makro, meso, dhe mikro. Së bashku me moshën, gjinia është një nga karakteristikat më të mprehta që i diferencen qëniet njerëzore në të gjitha shoqëritë. Ky tipar përshkruan të gjitha aspektet e jetës social-kulturore, personale dhe intrapsiqike.*

Niveli mikro i referohet faktorëve shoqërorë e kulturorë të cilët ndikojnë në veprimet e drejpërdrejta të individëve me njëri-tjetrin. Niveli mikro i referohet normave dhe vlerave që individi përjeton dhe negocion, si dhe pjesëve të gjinisë që përbëjnë identitetin dhe ndihmojnë njerëzit të pajtohen me rrethanat fizike të tyre (këto pasqyrohen në kushtet e jetesës që mund të vëzhgohen). Niveli makro i referohet në mënyrë tipike shoqërisë, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare,

**Gjinia si një parim shtresor i shoqërisë:** gjinia, ashtu si dhe raca, moshja, etnia dhe pozita sociale është një parim shtresor i të gjitha shoqërive.

<sup>3</sup>Kjo dokumentohet për problemet gjinore në një vend tjetër, për shembull Budowski (2002).

brenda një konteksti të dhënë historik dhe një zone të caktuar gjeografike (d.m.th. në kohë dhe hapësirë). Ai karakterizohet nga rendi ligjor, ekonomik dhe politik, dhe rrjedh nga ideologjitë dhe sistemet e besimit (fetë) që janë zhvilluar gjatë historisë, apo janë imponuar ose pranuar nga njerëzit me kalimin e kohës. Niveli mesem, i përmendur shpesh, i referohet organizatave, institucioneve, komuniteteve dhe grupeve racore e etnike që lidhin individin me shoqërinë. Dhe në të vërtetë, është ky nivel që ka ndoshta ndikimin më të madh në ruajtjen, riprodhimin apo forcimin e marrëdhënieve me bazë gjinore (p.sh. nëpërmjet efekteve shoqërizuese të familjes, të sistemit arsimor, të medias, të procedurave të zakonshme administrative apo të funksionimit të ndërmarrjeve private). Dhe, megjithëse dallimi aktual midis niveleve të ndryshme nuk është mjaft i qartë, ata janë të dobishëm për qëllime analitike.

Duke marrë parasysh se gjinia është një dukuri social-kulturore që ndodh në një kohë e vend të caktuar, të zbatosh një perspektivë gjinore në statistikë do të thotë:

- *Të shkosh përtej ndarjes së shoqërisë në bazë të seksit* Në të vërtetë, perspektiva gjinore fillon nga problemet metodologjike për treguesit dhe pyetjet që do të përdoren për mbledhjen e të dhënave. Gjatë mbledhjes së informacionit statistikor ekziston rreziku i përjashtimit të të dhënave që janë të domosdoshme për të kuptuar sa të ndryshme janë mënyrat e jetesës së burrave dhe grave. Për shembull, në rast se procesi i mbledhjes së të dhënave motivohet nga pyetje për tregun e punës, atëherë ka të ngjarë që përvoja në sferën shtëpiake, më së shumti ajo e grave, të përjashtohet. Me fjalë të tjera, në rast se dikush nuk bën pyetje që kanë të bëjnë me analizën e mbështetur te gjinia, atëherë perspektiva gjinore në statistikë bëhet shumë e vështirë, ose edhe e pamundur.

- *Të identifikosh sferat e rëndësishme që karakterizojnë jetën e përditshme të burrave dhe grave dhe përcaktimi i vendit ku është vendosur pushteti.* Pas identifikimit, është e rëndësishme të përcaktohet se çfarë lloj informacioni (nëse ka të tillë) mund të mbledhet rreth këtyre sferave. Në përgjithësi, sferat e rëndësishme që karakterizohen nga vendosja e pushtetit në nivel individual janë familja (përfshirë ato çështje që lidhen me riprodhimin dhe kujdesin për personat në varësi); sfera publike; tregu (formal dhe informal) i punës; institucionet fetare, sistemet e kujdesit shëndetsor; vendet e shoqërizimit të përditshëm; dhe sistemi arsimor. Në shoqëri pushteti gjëndet brenda sistemit politik, komunitetit, rendit social-kulturor, institucioneve fetare, sistemit arsimor, sistemit ligjor, etj.

- *Së fundi, në rast se janë mbledhur të dhënat dhe janë përcaktuar instrumentet para se perspektiva gjinore të futet si metodë statistikore, hapi më i rëndësishëm (i pari) që duhet ndërmarrë është ndarja e të dhënave në bazë seksi.* Kështu, i gjithë informacioni paraqitet veç për burrat dhe veç për gratë, duke lejuar në këtë mënyrë që dallimet në përvoja – nëse ka të tilla – të bëhen të dukshme dhe të shfrytëzohen për interpretime që janë të ndryshme ndaj fenomenit gjini.

### 1.1.2 Treguesit e mundshëm për vlerësimin e situatave të burrave dhe të grave

Nëse e kuptojmë gjininë si një parim shtresor të shoqërisë, me fjalë të tjera, si tregues elementësh të pandashëm të marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit të cilat rezultojnë thjesht nga të qenit grua apo burrë, ne mund të nxjerrim tregues që të përfaqësojnë situata gjinore si në rrethanat materiale të individëve, ashtu dhe në një rend social-kulturor. Në Seksionin 4 analiza jonë kufizohet në karaktersitikat social-demografike, kushtet

materiale dhe burimet njerëzore (kapitali shoqëror), që na ofrohen nga të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë, 2001. Përqendrohemi tek treguesit që mund të përfaqësojnë më mirë kushtet materiale dhe mundësitë nga pikëpamja e perspektivës gjinore. Janë këta tregues që mundësojnë vlerësimin e mundësive gjinore, të autonomisë sociale dhe familjare, dhe të pushtetit në familje.

Shkaqet e pabarazisë gjinore gjenden në familje, komunitet, tregun e punës dhe, përgjithësisht, në shoqëri (Chafetz 1990). Ndarja e punës sipas gjinisë krijon barra të ndryshme (të matura në kohë dhe energji), shkallë të ndryshme të njohjes (prestigjit), dhe të drejta të ndryshme në vendimmarrje për gratë dhe burrat. Pabarazia gjinore ndikon negativisht mbi ekuilibrin midis mundësive, të kushteve të jetesës dhe të statusit shoqëror të grave dhe burrave. Përveç kësaj, gjinia është gjithmonë e ndërthurur me parimet e tjera shtresore të shoqërisë, prandaj mund të mos ketë të njëjtat pasojë për burrat dhe gratë që jetojnë në një shtresë shoqërore që përcaktohet nga një tipar tjetër.

Një mangësi e të dhënave të regjistrimit të popullsisë shqiptare është se prej tyre nuk mund të dallojmë shkaqet e pabarazisë gjinore nga pasojat që sjell statusi i pabarabartë midis grave dhe burrave. Megjithatë, të dhënat lejojnë një krahasim sistematik midis gjendjeve dhe kushteve të jetesës së njerëzve që kanë migruar gjatë periudhës dymbëdhjetëvjeçare dhe atyre që nuk kanë migruar.

Cilët janë ata tregues që vënë në dukje mundësitë që ka njeriu për të kontrolluar dhe ndikuar jetesën e tij dhe të familjes së tij? Dixon (1978) rendit si tregues të mundshëm,

shkallën e mundësisë që ka një grua për të kontrolluar burimet materiale, si ushqimin, të ardhurat, tokën, apo format e tjera të pasurisë. Dixon, po ashtu, debaton se burimet shoqërore brenda familjes, komunitetit dhe shoqërisë si arsimi, pushteti apo prestigji janë tregues të autonomisë që individit i nevojitet për të kontrolluar dhe ndikuar jetesën e tij.<sup>4</sup> Këta tregues, megjithatë, duhet të shërbejnë si të dhëna të përafërta, pasi nuk mund të lidhen drejtpërdrejt me pushtetin për vendimmarrje.<sup>5</sup> Por edhe si të tillë, këta tregues janë të nevojshëm, pasi gjatë mbledhjes së të dhënave të regjistrimit nuk janë drejtuar pyetje për pushtetin e vendimmarrjes. Ne i interpretojmë këta tregues në sfondin e njohurive që kemi për Shqipërinë, të cilat burojnë nga përvojat tona dhe nga mendimet kritike për jetën në vend.

Treguesit që kanë lidhje me pushtetin e vendimmarrjes i kemi kategorizuar si vijon: kapitali njerëzor (ose shoqëror), veprimtaria ekonomike, të ardhurat, pronësia mbi tokën dhe karakteristikat e familjes (një kategori kjo që do të trajtohet në një seksion të veçantë).

*Kapitali njerëzor (ose kapitali kulturor):* në përgjithësi, burimet e kapitalit njerëzor si arsimi konsiderohen të jenë më të rëndësishmet për arritjen e mundësive të barabarta midis grave dhe burrave: arsimi është jetësor për hyrjen e njeriut në tregun e punës dhe shërben për të legjitimuar fitimet financiare; ai është, po ashtu, i rëndësishëm për strategjitë e tjera për të përmirësuar kushtet e jetesës së njeriut, përfshirë mbrojtjen e të drejtave personale dhe mundësinë e pjesëmarrjes në institucionet e komunitetit. Arsimi formal është shndërruar në një pasuri të padiskutueshme dhe konsiderohet si një burim kyç për kombet që kërkojnë të arrijnë zhvillim ekonomik. Shpesh,

<sup>4</sup>Ruth Dixon nxori këta tregues nga studimi i saj mbi gratë rurale në Azinë e Jugut dhe mbrojti idenë se autonomia është e rëndësishme për mirëqenien dhe zhvillimin (Dixon 1978)

<sup>5</sup>Për më tej, pushteti i vendimmarrjes nuk konsiston domosdoshmërisht në pushtetin për të vëndosur, por për të marrë pjesë në vendimmarrje.

migrimi nxitet nga dëshira e prindërve për t'u dhënë mundësi arsimimi më të mirë fëmijëve të tyre. Kjo krijon një lëvizje në shkallë të gjërë të njerëzve drejt vendeve ku ekzistojnë lehtësi më të mira arsimimi (p.sh. në qytete apo jashtë vendit). Për më tej, kur flitet për zhvillim, investimi arsimor për grate ka sjellë rezultate më të mira “shoqërore” sesa ai për burrat (World Bank 1995).<sup>6</sup>

*Veprimtaria ekonomike:* veprimtaria ekonomike bën të mundur mbijetesën e pavarur të njeriut. Veprimtaria ekonomike zhvillohet në gjithçka, nga prodhimi i ushqimeve për jetesë deri tek shitja e mallrave dhe e shërbimeve për të fituar të holla. Prodhimi bujqësor bazë lejon një farë pavarësie nga ekonomia kombëtare, por paratë në dorë, në sajë të veçorisë së tyre të “ndërmjetme”, mundësojnë një integrim më të plotë në të gjitha nivelet e sferës publike. Për këtë arsye, është e rëndësishme të vihet në dukje se në disa vende, ku gratë kryejnë veprimtari ekonomike, ato jo domosdoshmërisht kontrollojnë fitimet e tyre me para në dorë. Si rrjedhojë, treguesit e veprimtarisë ekonomike duhen kuptuar dhe interpretuar brenda konteksteve të tyre të menjëhershme dhe në bazë të vlerës shoqërore të tyre. Gjithashtu, siç është përmendur më lart, ka rëndësi të mbahet parasysh se këta tregues janë të përafërt, të ndërtuar artificialisht për qëllimin e diskutimit tonë aktual: shpërndarja gjnore e pushtetit të vendim-marrjes. Së fundi, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se veprimtaria ekonomike mund të mos shërbejë si një tregues kuptimplotë në rast se, për shembull, punojnë si burrat ashtu dhe gratë. Në këtë rast, treguesit duhet të marrin parasysh llojin e punësimit apo pozitën e të punësuarit.

*Të ardhurat* të ardhurat janë fitimi material që rrjedh nga veprimtaria ekonomike. Megjithëse

ato përfitohen nga individët, regjistrimi i popullsisë e ka llogaritur këtë të dhënë përgjithësisht si shumë në nivel familjeje. Matjet në total të të ardhurave për familje mund të mos jenë të mjaftueshme për të përshkruar kushtet ekonomike dhe mirëqenien e grave.<sup>7</sup> Shumë studime tregojnë se gratë nuk përfitojnë në mënyrë të barabartë nga përdorimi i të ardhurave familjare. Së fundi, në rast se të ardhurat nuk janë të disponueshme për t'u përdorur si tregues, atëherë si një matje e përafërt e fitimeve familjare mund të shërbejnë kushtet e jetesës.

*Pronësia mbi tokën:* siç është përmendur më lart, në shumë vende pronësia mbi tokën mund të tregojë mundësinë e personit për të përfituar nga burimet ekonomike. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve të mëdha të ndodhura këta 12 vjetët e fundit në bujqësinë shqiptare përfshirë privatizimin e tokës dhe mungesën e pajisjeve teknike për të rritur efektivitetin e punëve në bujqësi, sot pronësia mbi tokën nuk përbën një tregues të rëndësishëm, veçanërisht për arsyen se veprimtari të tjera sot kanë mundësi të prodhojnë më shumë të ardhura.

### 1.1.3 Njësia ekonomike familjare

Një arsye madhore për ta parë gjininë në kontekstin e njësisë ekonomike familjare është se kjo e fundit prodhon, përforcon dhe pasqyron më gjerësisht ide për gjininë dhe familjen. Është e qartë se njësia ekonomike familjare kuptohet si “njësia bazë e bashkëbanimit”, dhe familja kuptohet si një “bashkësi marrëdhëniesh normative”. Përkatësia në një njësi ekonomike familjare nuk bazohet gjithmonë në marrëdhëniet fisnore, megjithatë pjesa më e madhe e njësive ekonomike familjare përbëhet nga individë me lidhje gjaku apo martesë. Pjesa më e madhe e njësive ekonomike familjare ofrojnë

<sup>6</sup>Kjo metodë 'thuasje ekonomike' në lidhje me 'investimet në gratë' duhet kritikuar për arsyen se i instrumentalizon gratë. Nga ana tjetër, ajo ka çuar, megjithatë, në fitimin e avantazheve më të mëdha për gratë.

<sup>7</sup>Në lidhje me situatën në vendet në zhvillim, shih Chant (Chant 1997a; 1997b); në lidhje me situatën në vendet e zhvilluara, shih Pahl (Pahl 1983; 1989).

kontekstin themelor për shoqërizimin (procesin sipas të cilit mësohen dhe, ose fitohen ide, vlera dhe, ose qendrimet të caktuara). Për rrjedhojë, njësia ekonomike familjare është një njësi shoqërore themelore. Është vendi ku mësohen dhe shprehen rolet që lidhen me moshën, seksin, ku ushqehen ndjenjat fisnore, dhe ku njerëzit bashkëpunojnë nga pikëpamja ekonomike për të siguruar mbijetesën.

Në të vërtetë, megjithëse jo të gjitha njësitë ekonomike familjare kanë në mjediset e tyre të rritur të të dyja seksëve, shumë studiues theksojnë se njësitë ekonomike familjare luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e shoqërizimit gjinor dhe, gjithashtu, përbëjnë "një fushë parësore të shtypjes së grave" (Kabeer dhe Joekes, 1991:1; po ashtu Harris, 1981:139; Townsend dhe Momsen, 1987:40). Për këtë arsye, është e nevojshme jo vetëm të merret parasysh gjinia në lidhje me organizimin shtëpiak, por edhe të vështrohen të gjitha llojet e pabarazive meshkuj-femra që lindin në shtëpi (Chant 1996).

*Situata familjare dhe shtëpiake:* në pjesën më të madhe të shoqërive dhe shumë shpesh në histori, gratë kanë qenë përgjegjëse për

kujdesin e fëmijëve që kërkon aq shumë kohë. Kështu, prania e fëmijëve, në veçanti e fëmijëve të moshës para-shkollore dhe shkollore, është një faktor i rëndësishëm që ndikon në mundësitë e gruas për të hyrë në tregun e punës. Shpesh, gratë në shoqëritë lindore ngarkohen me detyrën e kujdesit për të sëmuret, të paaftët, si edhe për mirëqënien e përgjithshme të anëtarëve të shtëpisë. Prandaj, siç mund të shërbejë numri i fëmijëve të moshës parashkollore e shkollore si tregues i pavarësisë ekonomike të gruas, po ashtu mund të shërbejë edhe struktura tërësore e mjedisit shtëpiak. Këtu përfshihet, për shembull, numri i anëtarëve të njësisë ekonomike familjare që mund të kujdesen për anëtarët e familjes.

Studimet kërkimore të vendeve në zhvillim në veçanti të Indisë dhe të vendeve muslimane ku mbizotërojnë martesat me shkuesi flasin për rritje të diferencave në moshë midis bashkëshortit dhe bashkëshortes, dhe mund të shërbejnë si një tregues të pushtetit: gjetjet tregojnë se diferenca në moshë midis një bashkëshorti dhe një bashkëshorteje rritet (zakonisht prej të dyve gruaja është më e re në moshë), pushteti i vendimmarrjes së gruas ulet. Faktori moshë në martesë në disa kontekste mund të konsiderohet si një tregues i pushtetit brenda mjedisit shtëpiak.

Në korrik të 1990, afërsisht 5000 vetë hynë nëpër ambasadat e vendeve të huaja në Tiranë, si ato të Italisë, Gjermanisë dhe Francës, në kërkim të vizave. Pjesa më e madhe përfituan azil me ndihmën e organizatave ndërkombëtare. Afër njëzet mijë shtetas shqiptarë, në fund të 1990-ës dhe në mes të 1991-shit, u larguan në drejtim të vendeve fqinje duke kërkuar azil. Arsyeja kryesore e këtij eksodi ishte situata e vështirë ekonomike që mbizotëronte në Shqipëri në atë kohë. Në mars të 1991, turma shtetasish shqiptarë hipën në anijet e portit më të madh të vendit, Durrës, dhe pas disa ditësh lundrim mbërritën në Italinë e Jugut. Autoritetet italiane vënë në dukje se gjatë kësaj periudhe njëzet mijë shqiptarë zbarkuan në brigjet italiane. Në gushtin e të njëjtit vit ndodhi një eksod tjetër drejt Italisë. Numri i shqiptarëve që lanë pas vendin me këtë valë ishte mbi tetëmbëdhjetë mijë. Qeveria italiane ua refuzoi atyre në mënyrë kategorike hyrjen dhe brenda një periudhe të shkurtër, shtatëmbëdhjetë mijë vetë u kthyen në vendin e tyre<sup>8</sup>.

## 1.2 MIGRIMI

Pa kaluar në shtjellat e teorisë së migrimit apo nëpër analiza të hollësishme të migrimit në Shqipëri (këto çështje trajtohen nga një grup tjetër studimi që merret me migrimin në Shqipëri, siç pasqyrohet në Regjistrimin e Popullsisë në 2001 (INSTAT 2004), ne do të veçojmë dy pika të rëndësishme: (1) migrimi

<sup>8</sup>Do të dëshironim të falenderojmë anëtarët e grupit të migrimit për mbështetjen e tyre me këtë informacion (INSTAT 2004).



mund të jetë i brendshëm ose i jashtëm. Shqipëria i ka përjetuar të dy llojet në një shkallë shumë të madhe që nga rënia e regjimit socialist: në atë kohë rreth një e gjashta e popullsisë së Shqipërisë migroi jashtë vendit, disa herë edhe me rrezik të madh për jeten. Teksti në kutinë më poshtë jep një ide të përmasave të dukurisë së migrimit shqiptar dhe një vështrim mbi dëshpërimin e njerëzve që zgjodhën rrugën e migrimit.

Nuk ekziston ndonjë informacion i drejtpërdrejtë rreth migrimit as në të dhënat e përfuara nga Regjistrimi dhe as në Vrojtimin për Matjen e Standardeve të Jetesës (Living Standards Measurement Survey). Kështu, për të gjetur se cilët individë u bënë migrantë, ne iu drejtuam vendbanimeve të njerëzve në dy momente kohore: 1989 dhe 2001. Në rast se në secilën nga këto dy data banimi në një vend tjetër u konsiderua si shenjë e statusit të migrantit, atëherë mund të thuhet se të paktën 10% e popullsisë shqiptare ka migruar brenda vendit gjatë periudhës dymbëdhjetëvjeçare. Problemet e krijuara dhe/ose të zgjidhura nga ky migrim duhet të ndryshojnë në varësi të faktit nëse migrimi është kryesisht i brendshëm apo i jashtëm. Për më tej, ne presim që të dy tipet e migrimit të kenë pasur karakter gjinor. Njihet fakti se numri më i madh i atyre që migrojnë janë burrat në moshë të re, krahasuar me gratë në moshë të re. Në fillim, gratë ishin shpesh të detyruara të përdorin mjete veçanërisht të pafavorshme të migrimit (d.m.th. martesat e rregulluara jashtë shtetit, prostitucionin, trafikun e qënieve njerëzore dhe tregëtinë kriminale, e organizuar më së miri dhe e lidhur me shfrytëzimin e grave) (La Cava dhe Nanetti 2000).

Regjistrimi i Popullsisë shqiptare nuk mbledh informacion për migrimin ndërkombëtar, dhe prandaj në këtë studim ne përqendrohemi tek migrimi i brendshëm. Megjithëse nuk janë të qarta arsyet përse, edhe informacioni për migrimin e brendshëm është i mangët. Në

përgjithësi, faktorët shtytës dhe tërheqës mund të dallohen nga arsyet që jepen për migrimin. Faktorët shtytës, për shembull, mund të lindin, kur shëndeti ekonomik i personit nuk është më i qëndrueshëm në një rajon, apo kur konfliktet vendore fillojnë të kërcënojnë jetesën e dikujt. Faktorët shtytës po ashtu mund t'u referohen presioneve sociale, përfshirë përjashtimin apo diskriminimin (p.sh. paragjykimin ndaj nënave të pamartuara). Faktorët tërheqës, në dallim nga këta, janë faktorë që i bëjnë rajonet e destinacionit të duken më tërheqës sesa rajoni i banimit aktual. Këta përfshijnë, për shembull, ekzistencën e kushteve më të favorshme të jetesës, me shumë mundësi për punë të paguar, lehtësi më të mëdha arsimimi dhe kujdesi shëndetësor, etj. Faktorët tërheqës, po ashtu, mund të lidhen me tendencat sociale, si dëshira për t'u bashkuar me anëtarët e familjes që kanë migruar më parë. Gjatë të kaluarës socialiste të Shqipërisë migrimi i brendshëm nuk ekzistonte si një mundësi zgjedhjeje personale, por më së shumti si një përgjigje ndaj nevojave ekonomike dhe e vendosjeve politike. Në këtë mënyrë, faktorët shtytës dhe tërheqës nuk luanin një rol të fuqishëm. Për këtë arsye, procesi i migrimit të brendshëm vullnetar, të cilin ne trajtojmë, filloi kur u shemb sistemi socialist. Edhe nëse të dhënat e Regjistrimit të popullsisë nuk do të na lejojnë të identifikojmë qartë arsyet e migrimit të njerëzve, ato, sidoqoftë, na mundësojnë të krahasojmë migrantët dhe jo-migrantët, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë kapitalit njerëzor, statusit të punësimit dhe konfigurimit të mjedisit shtëpiak.





# ***Historia e migrimit të brendshëm dhe marrëdhëniet gjinore në Shqipëri***

## **2.1 MIGRIMI<sup>9</sup>**

Migrimi është i gjithëpranishëm në historinë shqiptare. Dimensionet, intensiteti, drejtimet dhe motivet e tij janë ndikuar nga zhvillimet ekonomike, politike dhe shoqërore që ndodhën në Shqipëri nëpër kohëra. Në përgjithësi, migrimi në Shqipëri i ka dhënë shtysë urbanizimit (UNDP 2000). Heqja e pengesave ndaj lëvizjes së lirë të njerëzve në Shqipëri në fillimet e viteve 1990 u shoqërua me një valë të fuqishme migrimi që nga fshatrat e qytezat, deri në Tiranë dhe qytetet e tjera të mëdha. Në Shqipëri filloi një transformim i fuqishëm social-kulturor, me njerëz nga zonat rurale që lëvizën si drejt qendrave urbane të rretheve të tyre, ashtu dhe drejt kryeqytetit, Tiranës. Njerëzit me origjinë nga qytetet e vogla u drejtuan për nga Tirana ose jashtë vendit. Traditat e ndryshme kulturore që i kishin rrënjët në vendin e tyre tani janë duke u zhvendosur drejt zonave të tjera të vendit, ku janë vënë në një kontekst konfrontimesh dinamike.

Migrimi i brendshëm në Shqipëri mund të përshkruhet duke e ndarë atë në disa faza: faza e parë 1923 – 1945; faza e dytë në 1945 - 1990; dhe faza e tretë nga 1990 deri sot.

Në këtë Seksion do të hedhim një vështrim të shkurtër mbi migrimin e brendshëm në Shqipëri, dhe më pas do të paraqesim një përshkrim të shkurtër të familjes dhe të ndarjes tradicionale të punës për rrethet e ndryshme të Shqipërisë. Më pas, do të analizojmë të dhënat e regjistrimit në sfondin e kësaj pasqyre.

*Faza e parë 1923 – 1945:* kjo periudhë karakterizohet nga një migrim në shkallë të gjërë i popullsisë nga vendet e largëta malore në ato të ulta dhe, në veçanti, drejt zonës bregdetare. Kjo përkoi me lindjen e kapitalizmit, me hapat e parë drejt zhvillimit të industrisë, komunikacioneve, tregtisë dhe shërbimeve. Gjithashtu i përkoi me përpjekjet e para për të zgjidhur çështjen agrare dhe krijimin e një klime të favorshme për investimet e huaja. Këta faktorë i dhanë shkas rritjes së qyteteve, të cilat nga ana e tyre mxitën migrimin drejt zonave urbane.

*Faza e dytë 1945-1990:* kjo periudhë u karakterizua nga mungesa e flukseve të migrimit të brendshëm dhe ndërkombëtar. Me vendosjen e regjimit socialist, pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, u ndalua me ligj emigrimi nga vendi. Në të njëjtën kohë, u lejua migrimi i brendshëm, por i kontrolluar dhe i drejtuar nga shteti. Periudha deri më 1960 u karakterizua nga një zhvillim i përshpejtuar i sektorit dytësor (industria dhe ndërtimi) dhe i sektorit të shërbimeve (transporti). Gjatë kësaj

<sup>9</sup> Kjo pjesë u hartua me ndihmën e çmuar të grupit të migrimit (INSTAT 2004a).

kohe, migrimi i brendshëm i popullatës kontrollohej por nuk ndalohej tërësisht, siç ndodhi disa vjet më vonë. Përqindja mesatare e rritjes vjetore të popullsisë urbane gjatë kësaj periudhe dhjetëvjeçare ishte mbi 6%. Pas vitit 1960 u zbatua një strategji që kufizonte migrimin e brendshëm nga zonat rurale drejt atyre urbane pasi qeveria provoi, pa sukses, të inkurajonte shtimin e popullsisë në zonat rurale.

*Pas 1990: Faza e tretë filloi në 1991 dhe përputhet me periudhën e transformimit. Ajo karakterizohet nga mungesa e politikave zyrtare për drejtimin e migrimit të brendshëm. Gjatë kësaj periudhe, nuk pati kontroll mbi lëvizjen e lirë të njerëzve. Zhvendosjet u shoqëruan me një zhvillim masiv, kaotik dhe disproporcional të zonave urbane krahasuar me zonat rurale. Migrimi i brendshëm drejt qendrave urbane çoi në një rënie 13% të popullsisë rurale në Regjistrimin e 2001, krahasuar me të dhënat e regjistrimit të mëparshëm të kryer në 1989. Në periudhën e mëparshme (1945-1990) popullsia rurale kishte pësuar një rritje prej 20%. Jo vetëm që popullsia lëvizi nga fshatrat drejt qyteteve, por edhe nga rrethet malore drejt zonave kodrinore, nga zonat më të largëta drejt fshatrave, nga zonat rurale me klimë të ftohtë dhe tokë të paktë bujqësore, drejt fshatrave me klimë më të butë dhe më me shumë mundësi kultivimi kulturash bujqësore.*

Tendenat statistikore që pasqyrojnë veçanërisht problemet sociale, flasin për lëvizje në masë të popullsisë drejt qendrave urbane. Ky migrim shoqërohet dhe me transferimin e makro-kultura, mentaliteteve, traditave, mënyrave të jetesës, etj. Të gjitha këto vijnë së bashku në qytetet e vogla dhe të mëdha përmes një kaosi, dhe integrohen me rrugë që mund të jenë paqësore ose të dhunshme. Identiteti fillestar i qyteteve shpesh ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga ai i banorëve të qytetit për shkak të normave e vlerave social-kulturore të të sapoardhurve. Në

të njëjtën kohë, vetë qytetet e vogla humbasin një pjesë të popullatës së tyre në favor të zonave më urbane. Kështu, si zonat urbane ashtu dhe qytetet më provinciale u përballën, dhe vazhdojnë të përballen, me një shtim të popullsisë të tyre (Fuga et al. 1998).

## 2.2 PËRSHKRIMI I MARRËDHËNIEVE GJINORE NË SHQIPËRI

---

Përshkrimi i tipeve të familjeve dhe njësive ekonomike familjare është shumë i rëndësishëm për perspektivën gjinore. Traditat kulturore dhe strukturat sociale të Shqipërisë janë të ngjashme ato të shoqërive të tjera mesdhetare (Çuli 2000). Siç është përmendur më parë, Shqipëria e Veriut njihet si vend me tradita të forta klanore të bazuara tek patrilineariteti (trashëgimia në linjë mashkullore) dhe patrilokaliteti (bashkëjetesa në banesën e burrit); kjo traditë është/ishte diçka më pak e dukshme në Shqipërinë qendrore dhe jugore. Patrilineariteti dhe patrilokaliteti janë modele të trashëgimisë dhe të banimit të ndërtuara mbi bazën e familjes atërore. Ka rëndësi të vihet në dukje se në familjet patrilineale dhe patrilokale, praktikat e trashëgimisë së pasurisë dhe të vazhdimësisë, përgjithësisht i përjashtojnë gratë. Në të tilla organizime familjesh, burrat si dhe kushërinjtë e tyre meshkuj nga ana e babait, kanë autoritet mbi anëtarët e tjerë të familjes. Zakonisht, rendet shoqërore si këto, të orientuara nga meshkujt, prodhojnë marrëdhënie gjinore të karakterizuara nga pabarazia; shpesh gratë kanë pak pushtet mbi jetën e tyre, megjithëse shkalla e pushtetit ose mungesës së tij varet nga faza e jetës së gruas

(gratë në faza të caktuara të jetës së tyre, dhe në disa kontekste, mund të fitojnë pushtet të konsiderueshëm mbi veten dhe familjen).<sup>10</sup>

Nga ana tjetër, marrëdhëniet gjinore varen nga institucione të një karakteri tërësisht lokal, si sistemi i farefisnisë (Cohen 1969). Në raste të tjera, shteti ligjërisht mund të parashkruajë të drejtat dhe detyrat e shtetasve të tij. Si i tillë, shteti gjithashtu mund të propagandojë të drejta të barabarta midis burrave dhe grave. Dhe, meqenëse shteti në mënyrë tipike rregullon vetëm ato marrëdhënie që kanë të bëjnë me "sferën publike", ka mundësi që kontekste të ndryshme të ndikojnë mbi marrëdhëniet gjinore që mund të ekzistojnë brenda dhe jashtë familjes.

Në Shqipëri, marrëdhëniet gjinore në sferën private janë dominuar nga organizimi shoqëror patrilineal dhe patrilokal. Ndërkohë shteti socialist shqiptar imponoi një strukturë tjetër për sferën publike, e cila mbështeti mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në arsim dhe tregun e punës. Madje, grave iu dhanë një sërë pozitash kyçe dhe të nivelit të larë. Si rezultat, u rrit përqindja e alfabetizimit nga një nivel i ulët, që ishte në fillim të regjimit socialist, në gati 100 per qind në 1989. Megjithatë, gratë në regjimin socialist mbanin një barrë të trefishtë: në familje kishin përgjegjësinë e plotë për kujdesin e fëmijëve dhe punët e shtëpisë, ndërsa burrat kontribuonin shumë më pak; dhe në punë gratë duhej të kontribuonin po për aq kohë e po me ato energji si burrat.

Ndryshimet që po ndodhin tani në sferën publike nuk mund ta kthejnë mbrapsht

procesin e barazisë gjinore të nisur gjatë regjimit socialist. Gjatë periudhës socialiste, individët dhe familjet pothuajse nuk e kishin lirinë e zgjedhjes ku do të jetonin apo si të punonin. Ishte shteti ai që merrte këto vendime, në bazë të nevojave e përparësive të caktuara nga ai vetë. Kjo nënkuptonte që çiftet e reja shpesh ndaheshin nga familjet e tyre dhe vendoseshin në rrethe të tjera, duke bërë që bashkëshortët të vareshin më shumë nga njeri tjetri se nga familjet e tyre të mëdha. Kjo nuk do të thotë që u zhdukën disa nga institucionet tradicionale, apo u fshinë tërësisht nga identitetet e njerëzve apo nga rrethanat shoqërore, por se shpesh këto kontekste u modifikuan.

Në varësi të natyrës së përparësive të shtetit dhe të faktit se sa është i aftë ai t'ua imponojë ato njerëzve në jetën e përditshme, ndryshojnë edhe pasojat e veprimit të shtetit mbi gratë dhe burrat. Në Shqipëri, si strukturat tradicionale, ashtu dhe rregullat shtetërore ndërveprojnë në mënyra të ndryshme në rrethe të ndryshme. Si pasojë, nëse rregullat e shtetit janë të dobëta, apo nuk mund të imponohen me anë të zbatimit të ligjit, mundësitë për gratë që ndodhen në kontekste partilineare e patrilokale kanë rrezik të jenë më të kufizuara sesa në rrethet ku traditat e tilla janë më të zbehta (p.sh. në zonat urbane).<sup>11</sup>

Përsa i takon arsimimit, ne vemë re se në Shqipëri ka shumë paradokse. Sipas mendimeve të kohës, arsimi është një pasuri e padiskutueshme. I njëjti mendim pranon se arsimi duhet të sigurojë përfitime ekonomike dhe sociale, si të ardhura, pushtet, vendimmarrje dhe prestigj. Për rrjedhojë, në

<sup>10</sup>Schlegel (1972) tregon se për shoqëritë matrilineare, është ndarja e veçantë e punës dhe shkalla e kësaj ndarjeje që ndikon mbi pozicionet e grave në shtëpi dhe në organizimin shoqëror të komunitetit. Një përmbledhje e shkurtër e gjetjeve të saj rreth grupeve etnike të organizuara në formë matrilineare, duke u dhënë kështu grave një avantazh strukturor relativ, është që në rast se gratë në shumicën e rasteve punojnë për mbijetesë, apo në rast se ato punojnë shumë pak, statusi i tyre është më inferior ndaj atij të burrave; nga ana tjetër, në rast se si burrat ashtu dhe gratë kryejnë të njëjtën sasi pune për të siguruar jetesën, gratë kanë më shumë mundësi për të fituar një status të barabartë.

<sup>11</sup>Cohen (1969) u referohet komb-shteteve të dobëta si "shtete të paformuara" dhe i përshkruan ato si "dikush që ende nuk ka përdorur plotësisht burimet vendore të solidaritetit, të besnikërisë dhe të autoritetit" (Cohen 1969:661). Një "shtet i formuar" dhe i suksesshëm është ai që ka siguruar transferimin e besnikërisë dhe ushtrimit e autoritetit nga bërthama lokale tek shteti. Kufijet lokalë vazhdojnë të ekzistojnë, por ata janë kryesisht për qëllime administrative dhe për shpërndarjen e përfaqësuesve burokratikë të shtetit. ... Në një komb me një shtet të formuar dhe të suksesshëm, besnikëritë e individit janë vetëm ndaj shtetit; ato nuk ndahen midis grupeve lokale dhe shtetit " (Cohen 1969:661-662).

një kontekst modern, arsimit është i vlefshëm si për djemtë dhe për vajzat me shpresën se ai do t'u ofrojë atyre mjetet për t'u mbrojtur dhe për të siguruar jetesën.

Në një traditë patriarkale, arsimit konsiderohet më i rëndësishëm për djemtë, të cilët mbahen si fituesit tradicionalë të bukës së gojës. Arsimit i mëtejshëm për vajzat mund të quhet si një investim i panevojshëm, meqenëse vajzat do të martohen dhe do të jenë nën mbrojtjen e bashkëshortëve të tyre. Më tej, nga pikëpamja patriarkale, të dërgosh vajzat për të ndjekur arsimin e lartë rrezikon t'i ekspozojë ato ndaj rreziqeve personale (grabitje, trafikim apo përdhunim), gjë që do të dëmtonte nderin e familjes. Arsimit i mëtejshëm për vajzat perceptohet si një kërcënim ndaj autoritetit mashkullor, pasi ai inkurajon të menduarit "kritik" dhe vendimmarrjen e pavarur. Kur arsimimi i vajzave vlerësohet nga perspektiva patriarkale, kjo bëhet për shkak të kontributit të tij jo të drejtpërdrejtë në jetën martesore të vajzës: duke e lidhur argumentin me faktin se në rast se gratë janë më të shkolluara, atëherë ato do të lidhen me burra që gjithashtu janë më të shkolluar, që do të jenë në gjendje të mbajnë gratë e tyre.

Sot në Shqipëri bashkëjetojnë dhe përzihen me njëra-tjetrën qëndrimet e forta patriarkale me ato moderne. Është e vështirë të përcaktohet se cila është logjika kur përipiqesh të kuptosh arsyet përse vajzat edhe inkurajohen, edhe dekurajohen apo pengohen të ndjekin shkollën. Faza e transformimit shqiptar ka vënë në pikëpyetje të mirën e padiskutueshme të arsimit të lartë për djemtë në veçanti, meqenëse përfitimet ekonomike dhe sociale nuk janë aq të mëdha. Shumë djem që dëshirojnë të ndjekin arsimin e lartë janë larguar nga vendi për t'u futur në këto institucione nëpër vende të tjera.

Nëse arsimimi vlerësohet si për djemtë ashtu dhe për vajzat, mendojmë se do të ketë nivele më të larta të frekuentimit shkollor, veçanërisht

sepse arsimit në Shqipëri u ofrohet përgjithësisht çdokujt, pavarësisht nga disa pengesa të dukshme që ndeshen në zonat rurale.

Gjatë periudhës socialiste, arsimit i është kushtuar një rëndësi e madhe. Për pjesën më të madhe të burrave e grave shqiptare sot arsimimi i fëmijëve të tyre është shumë i rëndësishëm, megjithëse, siç u diskutua dhe më lart, arsyet mund të ndryshojnë. Kjo tregohet pjesërisht në sakrificat e shumta që bëjnë familjet për edukimin e fëmijëve të tyre. Pritet që dallimet në arritjet në shkollë të kenë një impakt minimal mbi pushtetin e vendimmarrjes në rrethinat patrilineare dhe partilokale (në veçanti në zonat veriore), të paktën po të bëhet krahasimi me faktorët e tjerë, më të rëndësishëm (p.sh. mosha e gruas, fakti nëse ka lindur djem, etj.). Megjithatë, në kontekste më pak patriarkale, si në Shqipëri dhe mesme dhe të jugut, pritet që arsimimi të ketë një impakt më të madh mbi marrëdhëniet gjinore. Për këto arsye, është e domosdoshme historia e organizimit shoqëror në lidhje me familjen dhe njësinë ekonomike familjare.

Teorikisht, familja dhe njësinë ekonomike familjare nuk janë ekuivalentë, por shpesh ato ngatërrohen. Ndryshimi social ushtron ndikime të drejtpërdrejta në strukturën e njësisë ekonomike familjare, dhe po ashtu ndikon tek proceset e vendimmarrjes brenda shtëpisë. Për shembull, në rast se gratë, të cilat më parë kanë qenë jashtë tregut të punës, futen në punë, atëherë kjo do të ndikojë shumë në organizimin e jetës familjare, në veçanti tek familjet me fëmijë. Në dallim nga kjo, në rastet kur procesi i shpejtë i transformimit bën që gruaja të humbasë vendin e punës, njësinë ekonomike familjare është e detyruar të kërkojë zgjidhje të tjera ekonomike. Po kështu, në rast të një papunësie masive, njësinë ekonomike familjare do të përballlet çdo ditë me presione intensive. Pushteti midis anëtarëve të një njësie ekonomike familjare negocionet individualisht, dhe në këtë mënyrë

rezulton (zakonisht) në mundësi të ndryshme për burrat dhe gratë sipas roleve gjinore dhe kapitalit njerëzor.

Të huajt zakonisht e përshkruajnë Shqipërinë sikur përfaqësuesja e vendit në përgjithësi është zona veriore me historinë e saj fisnore. Karakteri i këtij rajoni është mbështetur shumë te Kanuni, një përmbledhje ligjesh dhe zakonesh që kanë shërbyer si themel i sjelljes shoqërore dhe të vetëqeverisjes (gegët).<sup>12</sup> Elementë të tjerë të këtij modeli social duken në martesat me shkuesi, prikati, lidhjet e forta të gjakut dhe gjakmarrja. Ky model social i përcakton qartë rolet gjinore në shoqëri dhe në tekstin e tij ka sugjerime të ndryshme që tregojnë se gratë ishin për të shërbyer, për të duruar dhe prodhuar trashëgimtarë. Këto kode të sjelljes kodifikonin dhe legjitimonin superioritetin e burrave ndaj grave, të cilat trajtoheshin si objekt dhe jo si një qenie njerëzore që ka nevojat e saj. Është kjo pamje e cunguar e familjeve shqiptare dhe e marrëdhënieve gjinore<sup>13</sup> që i ka kaluar kufijtë e vendit dhe ka tërhequr kohët e fundit vëmendjen e studiuesve. Ndoshta kjo mund të shpjegohet me natyrën "ekzotike" të këtyre modeleve fisnore që ekzistojnë brenda kufijve të Europës. Në fakt, në zonat qendrore dhe jugore të Shqipërisë struktura shoqërore ka qenë gjysëm-feudale, kurse Kanuni ka qenë shumë më pak i pranishëm në to. Ndërkaq studiuesit i kanë kushtuar një vëmendje shumë më të vogël strukturës që po ndryshon me shpejtësi të mjediseve shtëpijake, familjes dhe marrëdhënieve gjinore.

Theksojmë se të përgjithësosh mbi Shqipërinë në tërësi duke përdorur këtë pamje të Shqipërisë së Veriut do t'i errësonte rrethanat reale të saj edhe pse ajo i përket vitit

1918. Që në vitin 1918, kur vendi (me përjashtim të disa pjesëve të rajonit jugor) u pushtua nga ushtria austro-hungareze, "i pari Regjistrim i Popullsisë" në Shqipëri<sup>13</sup> (i quajtur kështu nga Gruber dhe Pichler (2002)) tregon se megjithëse ekzistonin struktura patriarkale, ato nuk ishin aq uniforme sa ç'përshkruhen ato në kohëra të mëvonshme. Dhe, me të vërtetë, këto struktura patriarkale nuk janë aq zotëruese në jetët e burrave e të grave shqiptare sot. "Mbizotërimi i numrit të meshkujve në popullsi" siç u sugjerua nga regjistrimet e bëra në vendet e tjera të Ballkanit, nuk rezultoi të ishte i vërtetë për Shqipërinë. Kështu, Gruber dhe Pichler vijnë në përfundimin se "me sa duket, regjistrimi i grave nuk u krye në mënyrë sistematike apo në një shkallë të gjërë" (në Regjistrimin e parë) (Gruber dhe Pichler 2002:354).<sup>14</sup> "Regjistrimi i parë" i vitit 1918 dëshmoi se modelet patrilokale dhe patrilineare të organizimit të njësive ekonomike familjare dhe familjeve që vëreheshin në zonën veriore, ishin të përhapura më tepër në zonat më të izoluara veriore. Në dallim me këtë, në zonat e tjera të Shqipërisë, përqindja e njësive ekonomike familjare bërthamë dhe të zgjeruara (në totalin e familjeve), është më e lartë sesa ajo e njësive ekonomike familjare me natyrë patrilineale që përbëhen nga disa familje.

Sipas Regjistrimit të 1918, moshë mesatare e martesës ishte tetëmbëdhjetë vjeç për gratë dhe njëzetetë vjeç për burrat (me ndryshime midis zonave rurale dhe urbane). Pra, diferenca mesatare e moshës midis bashkëshortëve ishte dhjetë vjet, gjë që flet për një model kulturor të dominimit mashkullor. Gruber dhe Pichler (2002: 360) debatojnë se ndryshimet midis modeleve martesore urbane dhe rurale kanë qenë

<sup>12</sup>Ky kod sjelljeje është hartuar nga Lekë Dukagjini (1410-1491) i cili luftoi së bashku me Skënderbeun, heroin kombëtar shqiptar.

<sup>13</sup>Gruber dhe Pichler e përshkruajnë këtë zonë veriore dhe rurale si vijon: "Malësia veriore shqiptare ishte një zonë e izoluar nga bota e jashtme që kishte një ekonomi të mjaftueshme për mbijetesë, një sistem ligjor tradicional të vetë-qeverisjes, dhe një organizim specifik social (...)" (Gruber dhe Pichler 2002:358).

<sup>14</sup>Në lidhje me hollësitë për mbulimin e saktë të rretheve, të numrit të njerëzve, të përmbajtjes së informacionit dhe të të dhënave, shih Gruber dhe Pichler (2002).

rezultat i diferencave në organizimin ekonomik, social dhe politik. Duke përdorur të dhënat e Rregjistrimit të vitit 1918, ata vijnë në përfundimin se nuk ishin "... një sistem i diferencuar i prodhimit, ndarja e punës dhe kushtet shumë të ndryshme sociale dhe ligjore në zonat urbane dhe rurale", ato që çuan në modele të ndryshme të formimit të njësive ekonomike familjare, por ishte zvogëlimi i "detyrimit për riprodhim për arsye kulturore dhe ekonomike" (si besimi fetar apo varësia ekonomike) (Gruber dhe Pichler 2002: 361) që çoi në tendencën e zvogëlimit të kompleksitetit të njësive ekonomike familjare. Ata, po ashtu, vënë në dukje hapësirën e kufizuar të banimit në rrethinat urbane. Këto rezultate tregojnë se situatat e grave dhe të burrave ishin më të ndryshueshme veçanërisht në rajonet qendrore dhe jugore të Shqipërisë, dhe ndoshta më pak të varura nga Kanuni nga ç'ishte pranuar përgjithësisht.

Siç u përmend edhe më sipër, periudha socialiste pa një modernizim të shoqërisë shqiptare së bashku me një përpjekje për përmirësim të statusit të grave. Legjislacioni i pas Luftës së Dytë Botërore sanksionoi zyrtarisht barazinë midis burrave dhe grave. Sipas këtij legjislacioni, gratë fituan të drejtat e tyre për të votuar, për të thënë fjalën e lirë, për tregun e punës, për pagë të barabartë, etj. Po të perifrazojmë Fullanin, është e vështirë të thuhet dhe e komplikuar të gjykohet se si ndikoi realisht tek gratë shteti socialist. Të drejtat e reja ligjore e përmirësuan gjendjen e tyre në letër, por nuk dihet nëse gratë mund t'i ushtronin realisht liritë e fituara. Ka mundësi që këto të drejta të jenë penguar nga detyrimet e grave si në sferat publike ashtu dhe në ato private. Gratë mund të kenë punuar me turne së bashku me burrat, të kenë gëzuar të drejtën për arsimim dhe të kenë pasur më shumë mundësi për të fituar një status më të mirë shoqëror, por në përgjithësi, situata e tyre në shtëpi nuk ndryshoi (Fullani 2000). Politikat socialiste i ndihmuan gratë në pikëpamje të potencialit të tyre ekonomik dhe përfaqësimit

politik, por kjo nuk krijoi barazi në marrëdhëniet gjinore. Kjo dukuri përshkruhet në shtetet e tjera ish-socialiste në literaturën akademike (Gal dhe Kligman 2000), si dhe në kujtimet e grave të ndryshme të cilat e përjetuan socializmin në fazat e ndryshme të jetës (Pritchett Post 1998).

Shteti socialist asnjëherë nuk i inkurajoi gratë që të ndërgegjësoheshin për lirinë e tyre të brendshme, apo të vinin në pikëpyetje pushtetin e burrave në shtëpi. Për këtë arsye, fuqizimi i grave është tepër i varur nga perceptimi i tyre për marrëdhëniet që duhet të kenë me të tjerët, me familjet dhe bashkëshortët e tyre. Megjithatë, siç dëshmojnë situatat e shteteve të tjera ish-socialiste, përpjekjet e shumta për të trajtuar pabarazitë gjinore kanë ndeshur me një rezistencë të lartë (Gal dhe Kligman 2000). Nganjëherë ato mund të ngjallin edhe dhunë, siç është vënë në dukje kohët e fundit nga Zv. Ministri i Kulturës, Edmond Dragoti (Gjoka 2004). Shpesh është thënë se të trajtosh këto marrëdhënie gjinore duhet të sulmohet, të minohet, dhe të ndërhysh në shoqëri, kulturë, dhe traditë.

Në folklorin tradicional shqiptar, gratë shpesh shihen si figura "të guximshme", mbështetëse besnike që kanë zënë vendin e burrave apo të vëllezërve të tyre të rënë në betejë, dhe që punojnë shumë në fushë për të mbajtur familjet e tyre. Kjo pamje u përforcua gjatë periudhës socialiste (siç është gjithmonë rasti në vendet e tjera ish-socialiste (p.sh. Gal dhe Kligman 2000)). Normat e periudhës socialiste kërkonin nga gratë që të ishin amvisa dhe nëna të përsosura, të sakrifikonin për familjet e tyre, të ishin të sjellshme me farefisën e burrave të tyre. Identiteti i një gruaje ishte i lidhur më shumë me rolet e saj specifike gjinore. Sistemi socialist në Shqipëri nuk e ndalonte feminitetin, por as nuk i inkurajonte vlerat femërore. Për më tej, ai theksonte se gratë duhet të ndiqnin modelin mashkullor, gjë që nuk u arrit kurrë, dhe bëri



që gratë të mohonin disa aspekte të identitetit gjinor të tyre (Çuli 2000). Siç vë në pah Occhipinti, përta i përket shkrimtarëve europiano-lindorë, "... koncepti i emancipimit të grave në socializëm nuk ishte i lidhur me individualizmin, siç ishte në Perëndim, por me kolektivizmin, 'patriarkinë socialiste' (...). Objektivi zyrtar i pabarazisë gjinore duhej të matej jo në lidhje me kënaqësinë dhe lirinë individuale, por me të mirën kolektive, me forcimin e familjes, në të mirë të socializmit në tërësi" (Occhipinti 1996:14).

Me rënien e socializmit, shoqëria shqiptare pati nevojë të gjejë mënyrën e funksionimit si politikisht ashtu dhe ekonomikisht. Si dhe në vendet e tjera, agjentë të ndryshëm shoqërorë filluan të konkurojnë për të fituar një autoritet legjitim pas përmbyesjes së regjimit socialist. Në Shqipëri mund të identifikohen dy pika kryesore ku zuri vend konkurrenca: diskutimet në lidhje me forcimin e funksionimit patriarkal të shoqërisë dhe ato mbi promovimin e një të kuptuari modern të shtetit të ri shqiptar. "Historia shqiptare e 'tranzicionit post-komunist' u karakterizua nga një tërheqje e pranisë së shtetit totalitar nga skajet më të largëta të vendit, dhe nga procese të përsëritura të shthurjes së plotë të shtetit" (Schwandner-Sievers 2001:108). Agjentët shoqërorë kërkonin modele që në të kaluarën kishin patur sukses në Shqipëri, ose që ishin të sukseshme në vendet e tjera. Shqipëria, e dobësuar nga rënia e shtetit socialist, u shndërrua në një vend ku struktura autoritare dhe patriarkale e familjeve tradicionale kishte një farë simpatie. Siç vë në dukje Holland (1998) dhe siç u citua më lart nga Cohen (1969), besnikëria ndaj organizimit para-socialist të marrëdhënieve familiare mund të forcohej më shumë se sa besnikëria ndaj komb-shtetit, tek i cili shumë vetë kishin humbur besimin. Siç deklaroi Holland:

"Mosbesimi në fuqinë e shtetit për të mbrojtur dhe mbështetur të drejtat politike dhe ekonomike të shiptarëve rrjedh nga historia e pushtimeve dhe e zotërimeve të vendit nga të huajt" (Holland 1998:67). Në fakt, shumë autorë shkojnë aq larg sa të pretendojnë që me rënien e socializmit në 1991, "Shqiptarët nuk u kthyen te ligjet e shtetit, por te konstruktet e tyre të hershme të marrëdhënieve shoqërore të mishëruara në Kanunin e Lek Dukagjinit, një përmbledhje zakonesh që lidheshin me familjen dhe nderin e klanit, të trashëguar kryesisht të pandryshuar që nga Mesjeta europiane dhe të përdorur nga të moshuarit e fisit për të rregulluar malet dhe kontrolluar gjakmarrjen... Në 1996, vlerësohej se kishte 2,000 familje që ishin në gjakësi në Shqipëri, apo 60,000 njerëz nga 3 milion banorë që ka Shqipëria" (Holland 1998:67 kur citon Pettifer 1996). Këto shifra duhet të merren me shumë rezervë, meqenëse asnjëherë nuk janë mbledhur të dhëna (zyrtarisht apo jo zyrtarisht) rreth numrit të atyre që janë ende në gjakësi në Shqipëri. Për këtë arsye mendojmë se kjo shifër nuk ka baza të forta besueshmërie. Megjithatë, ka të ngjarë që disa aspekte të kësaj kulture tradicionale të zonës veriore të vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot në Shqipëri, siç tregojnë artikujt nëpër gazeta.<sup>15</sup> Siç u përmend më parë, "Regjistrimi i parë shqiptar" në 1918 pati dëshmuar se panorama shoqërore nuk ishte aq uniforme sa paraqitet në literaturën bashkëkohore të botuar jashtë (Gruber dhe Pichler 2002). Dyzetekatër vjet socializëm sollën përvoja të reja, veçanërisht për gratë: punë të paguar në "sferën publike" dhe, për më tepër, mundësi arsimimi. Është e pamundur të ndodhë që shoqëria shqiptare të kthehet drejt një organizimi fisnor pa u ndikuar nga kohët moderne, pavarësisht nga fakti se janë rishfaqur disa sjellje shoqërore që i përkasin atij tipi organizimi (si gjakmarrja). Në analizën

<sup>15</sup>Autorët e këtij punimi nuk mohojnë apo injorojnë faktin që disa gra të disa rrethëve të kufizuara të Shqipërisë veri-lindore ende sot vuajnë pasojat e regjimit tradicional patrilinear, patrilokal dhe patriarkal, por kundërshtojnë pikëpamjen përgjithësuese që të gjitha gratë shqiptare i nënshtrohen këtij regjimi, pikëpamje që ndeshen shpesh, për fat të keq, në referencat e literatures së huaj për Shqipërinë.

e saj të procesit të transformimit, Schwandner-Sievers (2001) e përshkruan këtë sjellje, por ve në pah llojin dhe kuptimin e ndryshëm të saj në ditët e sotme.

Pas rënies së socializmit, Shqipëria pati rezultate të dukshëm në sigurimin e asistencës për të varfërit, po të krahasohet me vendet e tjera me të ardhura të ulëta (Alderman 2002). Dhe, pavarësisht nga turbullirat e mëdha që kaloi, Shqipëria gjeti rrugën e saj të shndërrimit në një komb-shtet demokratik të angazhuar ndaj barazisë gjinore. Kjo mund të shikohet në miratimin e një kushtetute demokratike në 1998 dhe ratifikimin e një sërë marrëveshesh ndërkombëtare, si Konventa për Zhdukjen e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (Calloni 2002). Një nga problemet më të mëdha sot të lidhura me gjininë duket të jetë lidhja e munguar midis barazisë së pranuar gjërësisht dhe asaj reale në drejtim të mundësisë për punësim, për biznes, për kreditim, për kujdes shëndetsor dhe shërbime sociale. Po ashtu, mbetet problem barazia gjinore në drejtim të pjesëmarrjes civile dhe pjesëmarrjes në vendim-marrje politike. Ligji shqiptar ndalon diskriminimin gjinor dhe atë në punësimin publik dhe privat. Por, pavarësisht nga ky ndalim, dhe pavarësisht nga niveli i lartë i arsimit të femrave në fusha që dominohen nga meshkujt, mundësitë e punësimit për gratë janë ende të pakëta. Në periudhën e tanishme të transformimit të shpejtë, gratë ishin kategoria e parë që vuajtën (INSTAT 2004). Ishin të parat që mbeten pa punë si rezultat i mbylljes së fabrikave, kurse në fshat situata e grave ishte edhe më e rëndë. Zhdukja e kooperativave eliminoi një vend të rëndësishëm ku gratë mund të ndërvepronin me të tjerët.<sup>16</sup> Si pasojë, shumë gra u kthyen përsëri atje ku ishin, në mjedisin shtëpiak. Kombinimi i punës së pakësuar në bujqësi dhe numrit më të vogël të vendeve të punës me migrimin në shkallë të gjerë drejt zonave

urbane, shkaktoi lindjen e një imazhi të ri të grave, ku tanimë ato shihen duke u kujdesur për shtëpitë në kushtet e vështira të një izolimi dhe vetmie totale (Miria 2000). Sipas UNDP, gratë paguhën më pak mesatarisht në krahasim me burrat (UNDP 1999). Megjithatë, një inspektim më i kujdesshëm i gjendjes tregon se në Shqipëri, diferenca në pagë ka më shumë të bëjë me mundësinë e kufizuar të grave për të arritur poste menaxheriale se sa me një pagë të pabarabartë për punë të njëjta.

Në sferën publike, ka ndodhur një rënie e theksuar e pjesëmarrjes së grave në politikë, siç është dokumentuar edhe për vendet e tjera europiano-lindore (Gal dhe Kligman 2000). Përqindja më e lartë e pjesëmarrjes së gruas në politikë në Shqipëri ishte në periudhën prej 1970 deri në 1991, kur 20% deri 33% e përfaqësuesve në Kuvend ishin gra. Në 1997 kjo shifër ra në 7.1%, dhe në 2001 ishte akoma më e ulët 6.4%. Sot pjesëmarrja e femrës në politikë mbetet e ulët (INSTAT 2003:37). Eshte interesant fakti që gratë janë përfshirë më shumë në sferën shoqërore në nivel lokal, megjithëse kjo shihet të ketë një ndikim përgjithësisht të pakët në sferën e vendimmarrjes.

Trazirat politike të viteve 1990 dhe 1991 si dhe në 1997 kërcënuan veçanërisht sigurinë e vajzave, gjë që ndihmoi legjitimimin e rritjes së rolit të kontrollit të meshkujve mbi gratë. Megjithatë, pavarësisht nga imazhi i përgjithshëm i pozitës inferiore të grave në Shqipëri, procesi i transformimit nuk përmbysi plotësisht ato të mira që patën fituar gratë në dhjetëvjeçarët e fundit. Bashkë me kujdesin tradicional familjar për mirë-rritjen e fëmijëve, ato gra që jetuan gjatë periudhës socialiste, gjithashtu, patën mundësi të kishin përvoja larg familjeve të tyre, integrim me grupe të tjera jashtë-familjare të brezit të tyre, mundësi më të mëdha për arsimim. Në të vërtetë, arsimi është bërë një e mirë e vlerësuar shumë në Shqipëri, dhe një numër i madh grash

<sup>16</sup>Për një përshkrim të hollësishëm të ndarjes së punës në bujqësi midis burrave e grave, shih Gjermani et al. (2003)

përfitojnë trajnim profesional si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij. Epoka e transformimit solli një pasiguri në lidhje me rregullat e sjelljes. Ndërkohë që mënyrat para-socialiste të jetesës kanë më shumë mundësi të rishfaqen në zonat rurale, fluksi i kulturës perëndimore (nëpërmjet medias dhe përvojave të shqiptarëve jashtë vendit) ka hapur rrugën për mundësi të reja, veçanërisht për brezin e ri. Në fakt, për hir të ndryshimeve në përvojat dhe arsimimin e grave shqiptare, pritet të ketë një farë heterogjeniteti në organizimin shoqëror, madje edhe në disa zona ku vazhdojnë të ngulmojnë mënyrat tradicionale. Ne presim që gratë e reja, në mënyrë të veçantë, të marrin në dorë mundësitë e reja që ofrohen dhe të promovojnë ndryshime në marrëdhëniet gjinore.

## 2.3 NDËRTHURJA E MIGRIMIT DHE GJINISË


Ndërthurja e migrimit dhe gjinisë ka një natyrë komplekse. Te dyja mund të ndikojnë mbi rolet e burrat dhe grave, thjesht për shkak të strukturës demografike dhe ekonomike të rajoneve të veçanta. Gjithashtu, ne mendojmë se modelet e gjinisë dhe të migrimit kombinohen për të krijuar një sërë mundësish dhe pengesash, veçanërisht për gratë në zonat urbane. Nga diskutimet konceptuale për gjininë dhe migrimin ne mund të ofrojmë disa hipoteza të mundshme, megjithatë, është tepër e vështirë të llogaritet çdo variabël më vete gjatë periudhave të një transformimi të tillë të shpejtë dhe të thellë. Një problem, për shembull, është fakti që të dhënat e regjistrimit nuk identifikojnë në mënyrë të qartë arsyet e individit për migrim, prandaj këto duhet të vlerësohen në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Migrimi mund të rezultojë nga një numër faktorësh: njerëzit mund të presin të gjejnë

më tepër liri apo mundësi më të mëdha, si arsimim më të mirë për vete dhe për fëmijët e tyre; një kujdes shëndetësor më të madh; më shumë mundësi punësimi; ose kur nuk shikojnë ndonjë të ardhme pozitive në vendin ku jetojnë (qoftë si rezultat i diskriminimit apo mungesës së mjeteve të jetesës). Ata mund të kërkojnë të migrojnë për t'u bashkuar me familjen e tyre që është vendosur tashmë në vendin e destinacionit, ose mund të dëshirojnë të kthehen në shtëpitë që kanë lënë për shkak të migrimit të detyruar gjatë periudhës socialiste. Për të tjerët, frika e hakmarrjes që vjen nga gjakmarrja mund të çojë në një përpjekje për t'i shpëtuar dhunës.

Një tjetër problem që lind është se regjistrimi i popullsisë është një proces që orientohet nga grumbullimi i të dhënave sasiore. Për këtë arsye, ai nuk merr parasysh në shkallë të madhe normat dhe vlerat subjektive që janë thelbësore për të kuptuar natyrën e marrëdhënieve gjinore.

Kështu, hipotezat për kryqëzimin e gjinisë me migrimin janë të destinuara të shfaqin disa kontradikta; dhe kur duket se një hipotezë apo një tjetër është e saktë, shpesh vërehet një epërsi e faktorëve ndërhyrës. Një tjetër problem praktik me të cilin ndeshemi është ai i përkufizimit të migrantëve. Në studimin tonë, migrimi përcaktohet si një lëvizje e njerëzve gjatë një periudhe dymbëdhjetëvjeçare. Kështu që nuk ka asnjë informacion për migrantët në lidhje me rrethanat e tyre familjare ose të njësisë ekonomike familjare para viteve 1989. Për këto arsye, ne kemi vendosur që të kryejmë analiza përshkruese sipas mendimeve që kemi paraqitur në seksionin 1. Ne i bazojmë analizat mbi tregues të pushtetit të vendimmarrjes dhe të pavarësisë personale. Ne përshkruajmë në mënyrë sistematike gjendjen e migrantëve në krahasim me jo-migrantët, të parë në lidhje me avantazhet apo disavantazhet e mundshme.





## Vëzhgime metodologjike

### 3.1 TË DHËNAT

Zakonisht, Regjistrimi i popullsisë bëhet çdo 10 vjet për të dokumentuar kushtet demografike dhe socialekonomike që mbizotërojnë në Shqipëri në nivel rajonal dhe kombëtar. Regjistrimi i prillit të 2001 ishte i pari gjatë të cilit u grumbulluan informacione duke ju drejtuar pyetje individëve dhe jo familjeve. Përpyekjet e qeverisë për ta vendosur individin në qendër të instrumentit statistikor ishin pjesë e rendit të saj të ditës në lidhje me të drejtat e njeriut dhe demokratizimin.

Regjistruesit përdorën udhëzimet e Regjistrimit të përgatitura nga Kombet e Bashkuara, UNECE dhe EUROSTAT, për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave. Qëllimi i regjistrimit të popullsisë dhe të banesave ishte mbledhja e informacionit nga çdo person që kishte lindur para 31 marsit (data e regjistrimit ishte 1 prill 2001), përfshirë edhe shqiptarët që kishin emigruar jashtë vendit. Informacioni u mbledh në bazë individësh dhe banesash. Ky

informacion u kombinua me të dhënat për ndërtesat dhe vendbanimet si edhe kushtet e jetesës dhe pronat që kishin familjet.

### 3.2 Kufizimet metodologjike

*Çështje të ndjeshme ndaj problemit gjinor:* Në mënyrë që të bëhet një analizë e çështjeve gjinore është e nevojshme që të shmanget përdorimi i modeleve dhe instrumentave metodologjikë që janë “neutrale ndaj çështjeve gjinore”. Me termin “neutrale ndaj çështjeve gjinore zakonisht i referohemi pyetjeve të cilat e anashkalojnë dallimin midis “sferave të jetës” së meshkujve dhe femrave. Pra, pyetjet neutrale ndaj çështjeve gjinore tentojnë të përqëndrohen rreth “sferës” publike (për shëmbull, tregu i punës), kundrejt “sferës” private ose shtëpiake. Nuk mund të themi se kur filloi, Regjistrimi i 2001-shit kishte ndër objektivat e tij një kujdes të veçantë ndaj mbledhjes së të dhënave që do të mundësonin analiza të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore. Regjistrimi i popullsisë shqiptare duhet të shihet si një regjistrim tipik kombëtar. Regjistrimet tipike kombëtare janë zakonisht neutrale ndaj çështjeve gjinore. Ky është edhe kufizimi më i madh i të dhënave. Megjithëse disa nga autorët e regjistrimit u përfshinë në përpunimin e instrumentave të tij, vetëm pasi u bë një shqyrtim i imët i të

dhënave doli në pah kjo mangësi. Kjo na çon në përfundimin se ndërgjegjësimi ndaj çështjeve gjinore duhet të merret parasysh në të gjitha fushat, edhe tek ato ku tradicionalisht nuk ka qenë i pranishëm, (domethënë në Regjistrimet kombëtare). Me një fjalë, cdokush duhet të përfshihet në procesin e kapërcimit të indiferencës ndaj çështjeve gjinore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për një shoqëri ku burrat dhe gratë zakonisht konsiderohen si të barabartë. Megjithatë, edhe sikur të ishte e vërtetë që gjatë periudhës socialiste u arrit barazia ndërmjet burrave dhe grave, transformimet e kohëve të fundit e kanë ndryshuar rendin e mëparshëm shoqëror dhe kanë krijuar marrëdhënie të reja shoqërore ku duhet të zbatohen instrumenta të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore.

### Kryefamiljarë (person i referencës):

Përveç faktit se njësia ekonomike familjare është vendi kryesor ku duken pabarazitë gjinore në aspektin e pushtetit për të vendimmarrje, dihet se tipe të ndryshme njësish ekonomike familjare kanë nivele të ndryshme të rrezikshmërisë për të kapërcyer pragun e varfërisë ose të "ndërthurjes së roleve". Në këtë mënyrë ne besojmë se tipe të ndryshme të njësive ekonomike familjare kanë përvoja të ndryshme dhe përballojnë migrimin në mënyra të ndryshme. Ne presim që trajektoret në mënyrë të veçantë të varen nga "kryefamiljari", meqenëse ky person zakonisht përgjigjet për krijimin e mundësive për familjen si një e tërë. Për rrjedhojë, gjinia e kryefamiljarit të njësisë ekonomike familjare ka rëndësi. Kryefamiljari i njësisë ekonomike familjare është personi i referencës, personi që administron çdo anëtar të familjes. Gjatë përpunimit të rezultateve të regjistrimit, u bë e qartë se përkufizimi i personit të referencës ishte shumë i ngushtë, ndaj dhe shumë pak familje kishin për kryetar një grua. Megjithatë, ky nuk është një problem vetëm për Shqipërinë. Çështja e identifikimit të kryefamiljarëve të njësisë ekonomike familjare është diskutuar gjerë e gjatë, si nga Buvinic

dhe Rao Gupta (1997), ashtu edhe nga Varley (1996). Siç treguan edhe Buvinic dhe Rao Gupta, kufizimi më serioz është fakti që termi "kryefamiljari i njësisë ekonomike familjare" nuk është neutral. "Ky term bart brenda vetes kuptime shtesë që pasqyrojnë theksin tradicional mbi njësitë ekonomike familjare si njësi të padiferencuara me një system patriarkal qeverisjeje dhe pa konflikte të brendshme përsa i përket përcaktimit të burimeve". (Buvinic dhe Rao Gupta 1997: 260).

Në versionin shqiptar të Manuali i Anketuesit që u hartua nga INSTAT dhe u përdor për mbledhjen e të dhënave në Regjistrimin e 2001, përkufizimi i personit të referencës si "kryefamiljarë" është si më poshtë: "Personi i referencës quhet personi i ngarkuar me përgjegjësitë kryesore në procesin e marrjes së vendimeve që lidhen me njësinë ekonomike të familjes, për pozicionin e të cilit duhet të bien dakort të gjithë anëtarët e njësisë". Në shoqërinë shqiptare, personi i referencës ose kryefamiljari është kryesisht mashkull, meqenëse tradicionalisht këtë pozicion meshkujt e kanë mbajtur. Në përgjithësi, gratë kanë shërbyer si "kryefamiljarë" vetëm në rrethana të veçanta, si p.sh. në rastin kur familja nuk ka një mashkull të rritur. Në raste të tilla, pushteti i vendimmarrjes automatikisht i kalon gruas. Me fjalë të tjera gruaja përgjithësisht e merr këtë rol vetëm kur ajo bëhet "e vetmja siguroese potenciale e jetesës" në familje.

Për shkak të këtij paragjykimi, ne morëm në shqyrtim kryefamiljaret vetëm atëherë kur kjo kishte kuptim për analizën, përndryshe i dalluam ata që u përgjigjën mbi bazë gjinie. Ne morëm gjithashtu parasysh strukturën e njësisë ekonomike familjare. Ky trajtim është i justifikuar për sa kohë që njësia ekonomike familjare është një hapësirë shoqërore kryesore, ku mundësitë për burrat dhe gratë ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme. Siç përmendëm edhe më sipër, jo të gjithë anëtarët e njësisë ekonomike familjare kanë të njëjtën

mundësi për burime, shërbime ose shanse. Pabarazitë gjinore kanë depërtuar në shumë aspekte të jetës së përditshme. Për shkak të këtyre pabarazive, mjaft shkencëtarë socialë argumentojnë se familja është vendi ku luftohet dhe bihet në ujdi për pushtet. Ekonomisti i mirënjohur Amartya Sen e quan këtë një model të bashkëpunimit dhe konfliktit. Sipas Bina Agarwal, një ekonomiste feministe e cila e zhvilloi më tej këtë koncept, njëسيا ekonomike familjare/familja është një matricë komplekse marrëdhëniesh në të cilën ka negociata të vazhdueshme që i nënshtrohen kufizimeve të vendosura nga gjinia, moshja, lloji i marrëdhënies dhe “traditave të padiskutueshme”. Ndërveprimet mbi bazë gjinie brenda familjes si edhe në komunitet, në treg dhe në shoqëri në përgjithësi, përmbajnë elemente të bashkëpunimit dhe të konfliktit (Bahsin 2000).

Ka tipe të ndryshme njësisht ekonomike familjare me kryefamiljarë meshkuj. Për një grua që jeton me burrin e saj në një familje qelizë, ku burri është kryefamiljar, jeta ofron mundësi shumë më të ndryshme sesa për një grua që jeton me familjen e burrit dhe me vjehrrin si kryefamiljar. Një grua e pamartuar që jeton me prindërit ose një vejtushë që jeton me familjen e burrit të saj nën ndikimin e kunitit të saj, gjithashtu kalon një përvojë me mundësira dhe kufizime të ndryshme. Struktura e familjes ndikon në faktin se si janë përcaktuar dhe trajtuar nevojat e gruas kur ato janë pjesëtare të familjes. Planifikuesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm për potencialin që gratë të cilat jetojnë në familje ku kryetar është burri, si në familjet qelizë, ashtu edhe në strukturat e familjeve të zgjeruara të bëhen të padukshme. Ata gjithashtu duhet të jenë të ndërgjegjshëm për marrëdhënjet e pushtetit brenda familjes, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mundësinë e grave për të shfrytëzuar burimet. Tendenca drejt organizimit të jetës në familje të vogla në Shqipëri si dhe hyrja në skenë ligjeve të reja kohët e fundit, kanë patur një ndikim të

rëndësishëm në çështjet e trashëgimisë dhe të praktikave të tjera të ndërtuara nën ndikimin e traditës patrilineale. Kështu për shembull, në familjet bërthamë, ka një shkallë më të lartë të bashkë-veprimit në vendimmarrje, dhe në procesin e kontrollit mbi kursimet dhe të ardhurat si dhe mundësi për gratë për të trashëguar tokën.

Por çfarë ndodh me familjet ku kryefamiljare janë gratë? Domethënia e këtij fenomeni në një shoqëri patrilineale në aspektin e vendbanimit të gruas, trashëgimisë, lirisë së lëvizjes dhe të arsimit - për të përmendur vetëm disa nga faktorët – meriton një vëmendje më të madhe. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet e vejtushave meqenëse gjendja e tyre ka sjellë shumë diskutime ndër studiuesit.

Imazhi që krijohet menjëherë kur flitet për familje me kryefamiljare gra, është ai i një gruaje të vetme (të divorcuar, të vejtë, të ndarë ose të braktisur), që jeton më vete ose me fëmijët e saj (në qoftë se ata nuk janë rritur akoma). Në kontekstin më të gjerë, atë patrilineal, ka një sërë faktorësh që ndikojnë në jetën e gruas si kryefamiljare. A jeton ajo me familjen e burrit? Ç’lloj kufizimesh i vihen asaj lidhur me mundësinë për të lëvizur, për të bërë zgjedhjet e saj individuale, për përgjegjësitë dhe përkujdesjet për fëmijët etj? A ka të drejtë ajo të shesë pjesën e tokës që zotërohet nga burri apo duhet që kjo pjesë t’i mbetet familjes dhe t’i kalohet vetëm fëmijëve të tij? Nëqoftëse ajo jeton më vete, me çfarë prone e siguron ajo jetesën? A e ka trashëguar atë në mënyrë të ligjshme dhe a ka të drejtë të marrë vendime për përdorimin e saj apo për ta shitur atë? A janë fëmijët nën kujdesin e saj, apo kalojnë nën kujdesin e familjes së burrit? A kanë gratë e divorcuara të drejtë të përkujdesen për fëmijët, apo kjo e drejtë i takon familjes së burrit? Nga pikëpamja ekonomike, familjet me kryetare gra, mund të jenë shumë të pambrojtura ose relativisht të sigurta. Një grua që është kryefamiljare e familjes mund të jetë

në një pozicion më të mirë financiar sesa një grua me një bashkëshort të papunë dhe me një familje të madhe për t'u përkujdesur. Ka mundësi që ajo të gëzojë më shumë liri lëvizjeje dhe të ketë më shumë të drejtë në vendimmarrje sesa homologia e saj, në një familje bërthamë ku kryefamiljar është burri. Ajo mund të ketë më shumë prona sesa një grua e martuar në një familje të zgjeruar. Por nga ana tjetër, ajo mund të jetë shumë e varfër<sup>17</sup>. Prandaj është e rëndësishme të mënajnohen hamendësimet që marrin për bazë vetëm këtë variabël dhe po ashtu supozimi se mungesa e punës së maskullit sjell varfëri dhe vulnerabilitet.

Secili nga këto variabla ndikon në pushtetin dhe pozicionin e kryefamiljarës si edhe në kushtet e saj të jetesës. Prandaj në disa raste ne do mënyrë që të afrojmë perspektivat e ndërgjegjshme për çështjet gjinore me të dhënat t'i ndajmë familjet në tipet përkatëse të njësive ekonomike familjare në bazë të seksit, në regjistrimin.

## 3.3 TREGUESIT

---

Më poshtë ne përmbledhim treguesit dhe variablat e përdorur për të krahasuar situatat e migrantëve dhe jo-migrantëve. Tabela 1 përmbledh metodën e përdorur për të transformuar çka kemi hamendësuar në seksionet e mëparshme në formën e një analize statistikore, prandaj mbi këtë tabelë nuk do të bëjmë komente të mëtejshme.

---

<sup>17</sup> Asnjë nga diskutimet e mësipërme nuk duhet të shihet si një nënvleftësim i nivelit të varfërisë së gruas. Në të vërtetë, feminilizimi i varfërisë është një tendencë globale për të cilën duhet të jenë të ndërgjegjshëm si planifikuesit, ashtu edhe vendimmarrësit dhe qytetarët. Gjithashtu, pa dyshim, varfëria tek familjet me kryefamiljare gra po shtohet në shkallë të gjerë. Ka një numër faktorësh që shpjegojnë lidhjen e të pënit një femër në krye të familjes me varfërinë. Këto përfshijnë (i) numrin e madh të personave për të cilët duhet të përkujdeset, (ii) faktin që gratë fitojnë mesatarisht të ardhura më të pakta dhe kanë më pak mundësi dhe shanse për punë me të prestigjioze, si dhe më pak burime të tilla si: kredi dhe tokë, (iii) gratë kryefamiljare duhet të gjejnë punë të cilat nuk i pengojnë ato për të përmbushur përgjegjësitë në familje. Punë të tilla zakonisht janë ato me paga më të ulta (ZNP, 1955a:2). Megjithatë, varfëria dhe familjet me kryefamiljare gra nuk duhet të trajtohen si çështje që lidhen automatikisht me njëra tjetrën. (Chant 2003).



Indicator	Variable	Concept	Operational definition
Migrimi	Shtresa rajonale	Rajonet, karakterizuar sipas idesë nëse ato pësojnë më tepër shtim sesa humbje të popullsisë, ose anasjelltas.	Migrimi pozitiv neto: rajonet me rritje më se 20 përqind të popullsisë nga viti 1989 deri 1991. Migrimi negativ neto: rajonet me humbje më se 20 përqind të popullsisë nga viti 1989 deri 1991.
Gjinia	Personi në referim, kryetari i njësisë ekonomike familjare	Shih Pjesën 4.2. për të diskutuar dhe përcaktuar kryetarin e familjes.	Personi i caktuar si kryetar i familjes.
Karakteristikat e familjes e të pjesëta-rëve të familjes	Tipi i familjes	Tipi i familjes cakton mundësi të pabarabarta për pjesëtarët e saj sipas rolit gjinor.	Gjashtë tipe familjesh:
			- Familje me një vetë
			- Familje e zgjeruar (Familje bërthamë me të afërm të tjerë)
			- Cift pa fëmijë
			- Cift me fëmijë
			- Familje me një prind
	Mosha	Për qëllim deskriptiv, grupmosha	
	Raporti i varësisë socialo-demografike	Struktura e familjes, raporti i moshës së shkollës dhe pensionit, duke përjashtuar pjesëtarët e familjes me moshë pune: proxy for për të mbajtur barrën e punës në shtëpi, proxy for pengesa strukturore për t'u inkuadruar në fuqinë punëtore (për gratë)	Raporti i varësisë socialo-demografike = $((\text{mosha}=0-14)+(\text{65 e lart}))\div 15-64$ vjeçarët)
	Mosha e martesës	Sa më i madh dallimi në moshën mesatare për martesë midis burrit e gruas, aq më pak i dëgjohe zëri gruas. Sa më e madhe është gruaja në moshë kur martohet, aq më të mira janë perspektivat e saj për t'iu	Mosha e martesës (së fundit) për burrat e gratë
Struktura e familjes	Karakteristikat e familjes	Mundësitë si pasojë e strukturës së familjes	- Raporti i varësisë
			- Përqindja e familjeve me fëmijë parashkollorë
			- Përqindja e tyre me fëmijë
Kapitali njerëzor	Arsimi	Arsimi i lartë si burim për t'iu dëgjuar zëri gruas	- Niveli arsimor: fillor, i mesëm, i ciklit të lartë, të shkollës së mesme, tretësor
		Arsimi si burim për tregun e punës.	
		Arsimi si mjet për fuqizimin, emancipimin dhe mbrojtjen e të drejtave vetjake dhe e të drejtave të tjera	- Numri i viteve
		"Vlera" e arsimit për fëmijët	- Shkollimi: po ose jo
Veprimtaria ekonomike	Karakteristikat e punës së paguar	Pavarësia/autonomia nëpërmjet punësimit të paguar;	- i punësuar, punëdhënës, punonjës në shtëpi, punonjës për llogari të vet
		Statusi i punës: Puna e paguar mundëson pozita më të mira	- mesatarja e orëve të punës të kryera në një javë
		Sasia e punës së kryer (orët e punës që kryen në javë)	- mesatarja e orëve të paguara në javën e mëparshme
Niveli i jetesës		Struktura e mallrave si një tregues i mirëqenies ose i modeleve të konsumit	- Raporti midis artikujve të luksit dhe sendeve të domosdoshme shtëpijake



## Rezultatet

### 4.1 PËRSHKRIMI I RAJONEVE TË MIGRIMIT DHE FAMILJEVE

Në muajin prill të vitit 2001 Shqipëria kishte 726, 859 njësi ekonomike familjare. Këto ishin të përqëndruara kryesisht në rajonin bregdetar. Vendndodhja e familjes varet gjërësisht nga modeli i migrimeve që ka përjetuar vendi gjatë 12 viteve të kaluar. Po të krahasojmë të dhënat e dy regjistrimeve të fundit të popullsisë në Shqipëri (1989 dhe 2001), do të konstatojmë se në nivel rrethesh ekzistojnë luhatje në të gjithë popullsinë. Duke marrë si bazë këto luhatje, e shohim të volitshme që në analizën tonë vendin ta ndajmë në dy rajone që karakterizohen nga: (1) rajoni me bilanc pozitiv të migrimit ose (2) rajoni me bilanc negativ të migrimit.

(1) Rajoni me bilanc pozitiv të migrimit përcaktohet si ai me një rritje rajonale prej më shumë se 20 % të popullsisë gjatë viteve 1989 deri 1991. Migrim me bilanc pozitiv është konstatuar dukshëm në rrethet e mëposhtme: Tiranë, Lezhë, Durrës, Krujë, Lushnje, Peqin, Kurbin, Elbasan, Librazhd.

(2) Rajoni me bilanc negativ të migrimit përcaktohet si ai me një humbje rajonale prej më se 20% të popullsisë midis viteve 1989 dhe 2001. Migrim me bilanc negativ gjatë këtij

Në këtë pjesë ne fillojmë me një krahasim midis situatave të jetesës së migrantëve dhe jo-migrantëve, duke i pëshkruar ato sipas treguesve të paraqitur në pjesën 3.3. Siç e përmendëm edhe më sipër, struktura e familjes është vendimtare për të ndërmarrë një krahasim të tillë. Ne fillojmë me krahasimin midis burrave dhe grave në tipe të ndryshme të familjes dhe më tej hedhim një vështrim mbi situatat e jetesës së migrantëve të ndryshëm. Gjithashtu, shikojmë nëse rajonet me "modele" të ndryshme migrimi kanë shpërndarje të ndryshme të tipeve të familjes.

Në hapin e dytë, ne paraqesim karakteristikat social-demografike, veprimtarinë ekonomike, veçoritë e strukturës së familjes dhe nivelin e jetesës, të cilat mandej në mënyrë sistematike i krahasojmë për kryefamiljaret.

Këto përshkrime na japin mundësinë për të hyrë në detaje më të imta për disa aspekte të jetës së përditshme, në të cilat luan rol e gjithë popullsia e jo thjesht kryefamiljaret. Ne përqendrohemi, gjithashtu në probleme që dalin nga tendenca të ndryshme që ekzistojnë në marrëdhënien midis migrimit dhe, p.sh. arsimit (që mund të sjellin drejt fluksit rrjedhjes së trurit).

intervali kohor është konstatuar në rrethet e mëposhtme: Berat, Bulqizë, Devoll, Dibër, Gramsh, Gjirokastrë, Has, Kuçovë, Malësi e Madhe, Vlorë, Shkodër, Kavajë, Fier, Mallakastër, Pogradec, Delvinë, Kolonjë, Kukës, Korçë, Mat, Mirditë, Përmet, Pukë, Sarandë, Skrapar, Tepelenë, Tropojë.

Njerëzit migrojnë për arsye të ndryshme, por shumica e tyre kryesisht kërkojnë një jetë më

të mirë. Prandaj dhe synimi ynë është që të shqyrtojmë nëse njerëzit që migruan në vazhden e 10 vjetëve të kaluar tashmë po përjetojnë kushte jetese që relativisht janë më të mira se ato të jo-migrantëve. Për fat të keq, të dhënat e regjistrimit të popullsisë nuk na lejojnë të përcaktojmë nëse migrantët aktualisht janë më mirë nga gjendja ekonomike sesa para periudhës së studimit. Duke patur për bazë pikëpamjen tonë se migrimi është një proces me karakter gjinor, ne i kushtojmë një vëmendje të posaçme atyre treguesve që sugjerojnë një përmirësim të pushtetit negociuse të gruas kundrejt burrit brenda familjes, por edhe në raport me shoqërinë në përgjithësi.

Për të karakterizuar gjininë e familjes, tipet e familjeve i kemi emërtuar sipas seksit të kryefamiljarit. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë në Shqipëri evidentojnë ekzistencën e disa tipeve të njësive ekonomike familjare, të cilat ne i kemi kategorizuar si më poshtë:

- Njësi ekonomike familjare me një person;
- Njësi ekonomike familjare e zgjeruar: familje bërthamë me pjesëtarë të tjerë të familjes që nuk përbëjnë një familje të dytë;
- Çift pa fëmijë: çift pa fëmijë që jetojnë në familje;

- Çift me fëmijë: çift me fëmijë që jetojnë në familje;

- Tipe të tjera njësive ekonomike familjare: p.sh. njësi ekonomike familjare me një ose dy familje bërthamë që jetojnë së bashku.

Hamendjet tona përse i përket karakteristikave social-demografike të njësive ekonomike familjare janë si më poshtë: në përgjithësi, supozojmë se familjet me kryetarë burra migrojnë më shpesh sesa familjet me kryefamiljare gra. Kjo për arsyen se, përse kohë që hapësira publike kuptohet si një arenë që mbizotërohet nga mashkulli, është më e vështirë për gratë t'i përshtaten sferave të jetës me të cilat ato nuk janë të familiarizuara. Frika që mbërthen gratë se mos humbasin sigurinë e jetës, sidomos kur kanë fëmijë, bëhet një pengesë edhe më e madhe për migrimin e tyre. Parashikojmë, gjithashtu, që moshë mesatare e kryefamiljareve migruar të jetë relativisht më e re (d.m.th., moshë për punë), në krahasim me njësitë ekonomike familjare jo-migruar; të rinjtë janë në përgjithësi më të gjendje për t'iu përshtatur situatave të reja dhe shpesh kanë në ngarkim familje më të vogla. Për këtë arsye parashikojmë të gjejmë në bashkësinë migruar një mbizotërim të familjeve me moshë të re.

Siç tregohet në Tabelën 2, kryefamiljarët migruar kanë një moshë mesatarisht më të re sesa kryefamiljarët jo-migruar (3 vjet më e

**Tabela 2:** Kryefamiljarët sipas moshës dhe migrantët në raport me jomigrantët

Kryefamiljarët e njësive ekonomike familjare	Moshë mesatare			
	Burra		Gra	
	Jo-imigrante	Migrante	Jo-imigrante	Migrante
Njësi ekonomike familjare me një vetë	51	39	66	57
Njësi ekonomike familjare e zgjeruar	43	34	62	47
Çift pa fëmijë	59	51	62	55
Çift me fëmijë	45	43	65	58
Familje me një prind	50	45	50	44
Shtëpi të tjera me shumë familje	61	57	61	57
<b>Totali</b>	<b>49</b>	<b>46</b>	<b>59</b>	<b>50</b>

Shembull: Kryefamiljari.

Burimi: Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

re për burrat dhe 9 vjet më e re për gratë; shiko tabelën "Totali" për burrat dhe gratë përkatësisht). Kur krahasojmë kryefamiljarët meshkuj me kryefamiljarët femra, si dhe kur krahasojmë tipet e njësive ekonomike familjare, duhet të tregojmë kujdes për shkak të diferencave mbi tipet e familjeve që gjenden në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave.

Karakteristikat e familjes dhe të njësive ekonomike familjare:

Siç paraqitet në Tabelën 3, modeli i shpërndarjes së tipeve të familjeve me kryefamiljar mashkull ose femër ndryshon në mënyrë të konsiderueshme. Gjithashtu, në familjet me një vetë (24.7% gra kundrejt 2.2% burra) dhe në familjet me një prind (40.1% gra kundrejt 1.3% burra) ka më shumë kryefamiljare gra. Po ashtu, ka më pak kryefamiljare gra në familjet që përbëhen nga çift (3.5% kundrejt 12.2% në familjet me fëmijë dhe 21.1% kundrejt 71.1% në familjet pa fëmijë).

Nuk është për t'u habitur kur konstatojmë se familjet me një prind më shpesh kryesohen nga gra. Ky dallim cilësor mund të shpjegohet me faktin se në rastet e divorcit është nëna ajo që merr ligjërisht në ngarkim fëmijët. Për më tepër, në Shqipëri nënat e divorcuara apo të veja zakonisht nuk rimartohen, gjë që ndodh shpesh me homologët e tyre meshkuj. Nuk është për t'u habitur, gjithashtu, që përqindja e kryetarëve meshkuj në familjet me një person është shumë më e ulët sesa përqindja e kryefamiljarëve femra tek i njëjti tip. Këtë e shpjegojmë pjesërisht me faktin se shoqëria shqiptare ende mbështetet gjërësisht në struktura shoqërore patrilineale dhe patrilokale, njëllonj si në vende të tjera mesdhetare, pavarësisht nga fakti se këto ndikime kanë pësuar e po pësojnë ndryshime të shpejta që nga rënia e regjimit socialist, në vecanti në zonat qytetare. Pjesërisht ky

Tabela 3: Shpërndarja e tipeve të familjes sipas krefamiljarëve


	Burra		Gra	
	N	Përqind	N	Përqind
Njësi ekonomike familjare me një vetë	14025	2.2	20571	24.7
Njësi ekonomike familjare e zgjeruar	3015	0.5	2694	3.2
Çift pa fëmijë	78701	12.2	2878	3.5
Çift me fëmijë	457361	71.1	17562	21.1
Familje me një prind	8238	1.3	33354	40.1
Shtëpi të tjera me shumë familje	82360	12.8	6136	7.4
<b>Totali</b>	<b>643700</b>	<b>100</b>	<b>83195</b>	<b>100</b>

Shembull: Kryefamiljari.

Burimi: Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

shpjegim lidhet me faktorë social-demografikë që ndikojnë sjelljen (në vende të tjera evropiane, p.sh., burrat kanë tendencë të rimartohen më shpesh dhe, madje, të vdesin më herët sesa gratë. Burrat janë të aftë të krijojnë familje në një moshë të vjetër më me sukses sesa gratë. Vërtet, shpërndarja e moshës midis burrave dhe grave në familjet me një person e tregon qartë se familjet me një person tek burrat janë kryesisht për arsye se burrat e rinj jetojnë më vete, ndërsa tek gratë duket se kjo është rrjedhojë e divorcit apo e vdekjes së bashkëshortit. Vetëm një pakicë e grave me moshë të re jetojnë në familje me një vete (shih Figurën 1).

Figura 1: Shpërndarja e moshës në njësitë ekonomike familjare me një person sipas seksit (në % të totalit të grupit)



Kampioni: Popullsia: të gjithë në moshë 14 e më sipër.

Burimi: Regjistrimi i popullsisë 2001 INSTAT

Duke pasur parasysh traditën e familjes së zgjeruar në Shqipëri, do të parashikonim se migrantët jetojnë më shpesh më vete ose në familje bërthamë më të kufizuara në krahasim me jo-migrantët. Duke u bazuar tek përvoja e kontrollit më të dobët social të migrantëve në rajonet e reja ku ata vendosen, gjithashtu ka mundësi që divorcet dhe ndarjet të ndodhin me një ritëm më të madh në bashkësinë migrante. Një gjë e tillë krijon në këtë bashkësi më shumë familje me një prind me fëmijë të vegjël (për shkak të moshës më të re të prindërve migrantë) në krahasim me familjet jo-migrante me një prind (ku kryefamiljarët kanë tendencë të kenë moshë më të madhe ose të jenë të ve). Një pasojë e mëtejshme e migrimit do të qe larmia më e madhe e tipeve të familjeve, të tilla si bashkëjetesa jashtë martesës, që në të kaluarën ka qenë e rrallë. Në rajonet që pësojnë humbje të popullsisë parashikojmë një përqindje më të madhe të familjeve me një prind në krahasim me tipet e tjera të familjes, në mënyrë të veçantë të atyre me kryefamiljare gra.

Tabela 4 tregon se tipi i familjes së zgjeruar, ndonëse i pazakontë, është një rregullim disi më i zakonshëm i jetesës në familjet me kryefamiljare gra, në krahasim me familjet me kryefamiljar burra. Një krahasim i tipeve të familjes sipas statusit migrant ose jo-migrant të familjes tregon se familjet migrante me kryefamiljar burra, ka më shumë të ngjarë të përbëhen nga çifte me fëmijë sesa familjet jo-migrante; gjithashtu, familjet migrante me kryefamiljar burra ka më pak të ngjarë të

përbëhen nga çifte pa fëmijë. Siç parashikohet, përqindja e familjeve migrante me një prind dhe kryefamiljare gra, është më shumë se 10% më e lartë në krahasim me familjet jo-migrante; ndërkohë përqindja e familjeve migrante me një person dhe kryefamiljare gra, është më shumë se 10% më e ulët në krahasim me familjet jo-migrante me një person. Kjo përbën një element të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të tipeve të familjes, duke patur parasysh se familjet me kryefamiljare gra në përgjithësi janë më të brishta ndaj disavantazhit ekonomik dhe stresit. Po të krahasojmë rajonet që pësojnë shtim ose humbje të popullsisë, nuk shohim ndryshime në shpërndarjen e tipeve të familjes në lidhje me kryefamiljarin. Për më tepër, dhe në kundërshtim me parashikimet tona, konstatojmë më tepër gra kryefamiljare të martuara tek familjet migrante me një prind, në krahasim me ato jo-migrante me një prind, siç prisnim të shikonim.

Tabelat 3 dhe 4 sugjerojnë që t'i shqyrtojmë në mënyrë më të detajuar familjet me një prind. Pasqyra 5 tregon se jo tamam dy të tretat e kryefamiljareve gra në familjet me një prind janë të veja; diçka më pak se një e treta janë të martuara dhe pjesa që mbetet janë të divorcuara. Nuk është e zakonshme për gratë shqiptare që të kenë fëmijë jashtë martese, siç është rasti në shumë vende të tjera evropiane. Po të shprehemi më saktë, nuk ndodh që gratë të jenë kryetare familjesh me statusin e nënave të pamartuara (vetëm një përqind e grave kanë deklaruar se janë

Tabela 4: Shpërndarja e tipeve të familjes sipas kryefamiljarëve dhe sipas statusit të migrimit

	Burra		Gra	
	Jo-imigrante	Migrante	Jo-imigrante	Migrante
Njësi ekonomike familjare me një vetë	2.2	1.7	25.7	13.8
Njësi ekonomike familjare e zgjeruar	0.5	0.6	3.1	4.3
Çift pa fëmijë	12.6	9.2	3.5	3.5
Çift me fëmijë	70.6	74.9	21.2	19.6
Familje me një prind	1.3	1.2	39.2	50.5
Njësi ekonomike familjare të tjera me shumë familje	12.8	12.5	7.3	8.3
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

Shembull: Kryefamiljar.

Burimi: Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

kryefamiljare në familjet me një prind). Megjithatë, rastet e nënave të pamartuara mund të paraqiten më shumë në tipe të tjera të njësive ekonomike familjare.

Siç kishim parashikuar, raporti i grave të veja është më i lartë tek familjet jo-migrante me një prind sesa tek familjet në bashkësinë migrante (60% kundrejt 53%). Por, ndryshe nga parashikimet, megjithatë, raporti i grave migrante të martuara është më i lartë sesa raporti i grave jo-migrante të martuara (39% kundrejt 29%). Kjo sugjeron se burrat e martuar pasi migrojnë brenda vendit,

**Tabela 5.** Statusi martesor i grave kryefamiljare në familjet me një prind

	Jo-imigrante	Migrante
Beqare	1%	1%
E martuar	29%	39%
E ve	60%	53%
E divorcuar	10%	7%

*Shembull:* Kryefamiljarët e njësive ekonomike.

*Burimi:* Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

vazhdojnë të migrojnë edhe jashtë shtetit, duke lënë pas bashkëshortet dhe fëmijët e tyre. Kjo, gjithashtu, ka mundësi të jetë edhe pasojë e dobësimit të lidhjeve me familjen bërthamë, gjë që, së bashku me mungesën e bashkëshortit të migruar, i inkurajon gratë të migrojnë në një drejtim tjetër, p.sh., drejt familjeve të tyre. Për fat të keq, të dhënat e regjistrimit të popullsisë nuk janë në gjendje të vërtetojnë shpjegimet e mundshme.

Dallimi në gjendjen civile tek familjet me një prind të kryesuar nga gra është minimal kur krahasojmë rajonet që kanë pësuar shtim ose humbje të popullsisë. I vetmi rezultat i dukshëm nga një krahasim i tillë është se gratë në rajonet që pësojnë humbje ose shtim të popullsisë kanë më tepër mundësi të martohen sesa ato në rajonet që pësojnë rritje të popullsisë. Në të njëjtën kohë, një përqindje paksa më e lartë e grave në rajone që pësojnë shtim të popullsisë janë të divorcuara në

krahasim me ato rajone që pësojnë humbje të popullsisë. Një rezultat i tillë parashikohet, pasi rajonet që pësojnë rritje të popullsisë janë më urbane nga natyra sesa ato rajone që pësojnë humbje të popullsisë.

Madhësia e familjes luan rolin e vet në barrën e shtëpisë që ka gruaja; sa më i madh të jetë raporti i varësisë social-demografike aq i madh është numri i personave për t'u përkujdesur e mbajtur. Kjo është më se e vërtetë vecanërisht sot pas përmbysjes së regjimit socialist së bashku me dispozitat e tij për kujdesin e fëmijëve e të moshuarve<sup>18</sup>. Përsa i përket korelacionit midis madhësisë së familjes dhe migrimit, janë ngritur dy hipoteza të kundërta, të cilat duket se janë që të dyja njëjloj të vlefshme: (i) Si familjet migrante të kryesuar nga meshkuj ashtu edhe ato që kryesohen nga femra do të kenë më pak pjesëtarë në familje si dhe një raport më të mirë varësie, me më shumë njerëz në moshë për punuar e mbajtur ekonomikisht pjesëtarët në ngarkim, në krahasim me familjet jo-migrante. Kjo është e mundur, sepse migrantët (relativisht të rinj) braktisin familjet e tyre të origjinës, ndërsa ata pjesëtarë më pak të aftë për t'u inkuadruar në tregun e punës mbeten pas (me përjashtimin e mundshëm të fëmijëve më të vegjël). Ne supozojmë se familjet migrante të kryesuar nga meshkuj sigurojnë kushte jetese më të mira sesa homologet e tyre femra, sepse zakonisht ato përbëhen nga çifte. (ii) Meqenëse migrimi shumë shpesh ndodh për të kërkuar mundësira më të mira jetese, njerëzit në procesin e migrimit përpiqen t'i kursejnë shpenzimet e investimit duke jetuar në njësi të mëdha familjare, zakonisht së bashku me një familje të zgjeruar, e cila ka migruar më parë. Së fundmi, është e rëndësishme të tërheqim vëmendjen se për fëmijët nën 14 vjeç që jetojnë në familje lind nevoja e përkujdesjes, gjë që vështirëson

<sup>18</sup> Përsëri ekzistojnë dispozita të tilla, por më të pakta se gjatë periudhës socialiste dhe cilësia e tyre konsiderohet të jetë dobësuar kur bëhet krahasim me situatën.

inkuadrimit e grave në tregun e punës, vecanërisht kur ato janë i vetmi prind. Pasqyra 6 tregon si është ndërtuar një familje mesatare në raport me moshën e pjesëtarëve të familjes.

Tabela 6 jep të dhëna që mbështesin hamendjen tonë fillestare për familjet e vogla migrante: raporti i varësisë socialdemografike është përgjithësisht më i favorshëm për burrat kryefamiljarë sesa për gratë kryefamiljare si dhe më i favorshëm për migrantët sesa për jo-migrantët. Megjithatë, në kundërshtim me parashikimet tona, shkalla e varësisë për gratë kryefamiljare tek familjet migrante me një prind është më e lartë sesa ajo e homologeve të tyre jo-migrante. Përveç raportit të lartë të varësisë, numri i pjesëtarëve në

familjet migrante me një prind është, mesatarisht, më i madh sesa numri i pjesëtarëve të familjeve jo-migrante me një prind. Për më tepër, njësitë ekonomike familjare me një prind që kanë migruar kanë një përqindje më të lartë të fëmijëve të vegjël sesa njësitë ekonomike familjare me një familje që nuk kanë migruar (p.sh., 1.499 fëmijë në familje me moshë nën 18 vjeç, në krahasim me 1.13). Në këtë mënyrë, struktura e familjeve me një prind me kryefamiljare gra ndryshon sipas faktit nëse familja ka emigruar apo ka qëndruar. Kjo parashikon se gratë migrante që tashmë janë kryefamiljare të familjeve me një prind të jenë në disavantazh kur krahasohen me homologet e tyre jo-migrante për sa i përket strukturës së familjes dhe raportit të varësisë. Kryefamiljaret gra të

**Tabela 6:** Raporti i varësisë, madhësia dhe përbërja e familjes sipas gjinisë dhe statusit të migrantit

	Raporti i varësisë <sup>(1)</sup>	Moshë					Madhësia mesatare e familjes	Fëmijë <18
		0-6	7-14	15-17	18-64	mbi 64		
<b>JOMIGRANT - Kryefamiljarë mashkull i njësis ekonomike familjare</b>								
Njësi ekonomike familjare e zgjeruar	0.38	0.13	0.22	0.15	1.82	0.39	2.71	0.5
Çift pa fëmijë	0.54	0.02	0.02	0.02	1.38	0.71	2.15	0.06
Çift me fëmijë	0.57	0.58	0.91	0.33	2.53	0.15	4.5	1.82
Familje me një prind	0.46	0.21	0.47	0.25	2.01	0.37	3.31	0.93
Shtëpi me shumë familje	0.59	0.99	0.54	0.2	3.74	0.81	6.28	1.73
<b>KRYEFAMILJARE GRA QË NUK KANË MIGRUAR</b>								
Njësi ekonomike familjare e zgjeruar	0.73	0.11	0.22	0.11	1.3	0.7	2.44	0.44
Çift pa fëmijë	0.35	0.05	0.08	0.06	1.94	0.57	2.7	0.19
Çift me fëmijë	0.84	0.8	0.87	0.24	2.5	0.64	5.05	1.91
Familje me një prind	0.55	0.27	0.61	0.25	1.75	0.22	3.1	1.13
Shtëpi me shumë familje	0.5	1.02	0.52	0.2	3.81	0.48	6.03	1.74
<b>KRYEFAMILJARE BURRA QË KANË MIGRUAR</b>								
Njësi ekonomike familjare e zgjeruar	0.24	0.12	0.22	0.24	2.06	0.22	2.86	0.58
Çift pa fëmijë	0.31	0.02	0.02	0.03	1.63	0.48	2.18	0.07
Çift me fëmijë	0.62	0.73	0.94	0.32	2.54	0.11	4.64	1.99
Familje me një prind	0.4	0.24	0.46	0.3	2.23	0.31	3.54	1
Shtëpi me shumë familje	0.54	1.04	0.58	0.25	4.05	0.69	6.61	1.87
<b>KRYEFAMILJARE GRA QË KANË MIGRUAR</b>								
Njësi ekonomike familjare e zgjeruar	0.5	0.19	0.37	0.16	1.73	0.38	2.83	0.72
Çift pa fëmijë	0.28	0.08	0.09	0.06	2.01	0.41	2.65	0.23
Çift me fëmijë	0.83	0.88	0.89	0.23	2.49	0.5	4.99	2
Familje me një prind	0.69	0.53	0.71	0.25	1.71	0.12	3.32	1.49
Shtëpi me shumë familje	0.44	1.05	0.52	0.23	4.11	0.36	6.27	1.8

Verejtje: <sup>(1)</sup>((mosha=0-14)+(65 e lart))÷15-64 vjeç në familje).

Shembull: Të gjithë pjesëtarët e familjestë përmbledhur në shkallë familjeje.

Burimi: Regjistrimi 2001 INSTAT 2001.




familjeve me një prind janë gjithashtu në disavantazh kur krahasohen me homologët e tyre meshkuj.

Rezultatet që kanë të bëjnë me madhësinë e njësisë ekonomike familjare të lënë të kuptosh se migrimi po kontribuon në një proces ndryshimi në marrëdhëniet gjinore. Në kontrast nga sa kemi informacion nga studimet e mëparshme, sidomos ato jashtë vendit, tipi më i zakonshëm i njësisë ekonomike familjare është familja bërthamë me një përbërje nga 4 deri në 5 pjesëtarë. Kjo përkon me vëzhgimet e bëra në vitin 1918. Tipet jo-bërthamë të njësisë ekonomike familjare (familje të zgjeruara dhe njësi ekonomike familjare me shumë familje) përbëjnë më pak se një të gjashtëtën e të gjitha familjeve në Shqipëri. Sipas parashikimeve, tipet e njësisë ekonomike familjare së zgjeruar kanë më shpesh burra sesa gra si kryetarë familjesh. Njësitë ekonomike familjare shqiptare jetojnë zakonisht në familje bërthamë, gjë që jo domosdoshmërisht nënkupton se ato jetojnë larg familjeve të tyre të origjinës.

Vërtet, ekziston mundësia që grupe familjesh më të mëdha të copëzohen në njësi bërthamë që vazhdojnë të jetojnë pranë njëri-tjetrit. Nëse vendbanimi është ende patrilokal ose po ndryshon në drejtim të modeleve neolokale (që karakterizohen nga një çift që jeton larg si nga familja e burrit ashtu dhe e gruas, ky nuk mund të përcaktohet nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë. Mesatarisht, familjet migrante janë pak më të mëdha sesa familjet jo-migrante. Familjet jo-migrante me kryefamiljare gra, kanë tendencë të jenë pak më të mëdha se homologët e tyre të kryesura nga meshkuj, ndërsa, nga ana tjetër, tek familjet migrante nuk konstatohet pothuajse asnjë ndryshim përse i përket madhësisë së familjes. Pra, disponojmë fakte në mbështetje të argumentit tonë të dytë të shtjelluar më sipër përse i përket madhësisë së konsiderueshme të familjeve migrante. Madhësia mesatare e


familjes ndryshon sipas tipeve të familjes, por ajo nuk ndryshon thelbësisht sipas seksit të kryetarit të familjes apo sipas statusit të familjes si migrante apo jo-migrante. Megjithatë, familjet migrante me një prind dhe kryefamiljare gra tipikisht kanë struktura që ndryshojnë nga ato të homologëve të tyre jo-migrantë, sidomos përse u përket fëmijëve e të moshuarve. Në familjet migrante, numri i fëmijëve të moshave nën 6 vjeç është gati dy herë më i lartë sesa ai tek familjet jo-migrante (.53 për për migrantët kundrejt 27 për jo-

**Figura 2:** Moshja e martesës kur martesë është lidhur para vitit 1991



Shembull: Burra dhe gra martuar para vitit 1991, moshë 14 deri 50 vje  
Burimi: Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

**Figura 3:** Moshja e martesës kur martesë është lidhur në vitin 1991 e më vonë



Shembull: Burra dhe gra martuar para vitit 1991, moshë 14 deri 50 vje  
Burimi: Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

migrantet). Familjet migrante me një prind dhe kryefamiljareve gra kanë gjithashtu më pak pjesëtarë të moshuar sesa homologet e tyre jo-migrante (.12 në krahasim me .22), gjë që nënkupton se mundësitë për sigurimin e kujdesit janë më pak, ose kërkohet më pak kujdes për të moshuarit (nëse ata kanë nevojë për t'u përkujdesur). Kjo nënkupton se familjet me një prind dhe kryefamiljare gra përballen me të njëjtat sfida që përjetojnë familjet me një prind në vende të tjera: vështirësia e sigurimit të kujdesit për fëmijët e vegjël, ndërsa prindi bën përpjekje për të hyrë në tregun e punës.

Siç vumë re në pjesën 1.1.3, mosha e martesës, në disa kontekste, mund të merret si një tregues i pushtetit vendimmarrës të individit në familje. Mosha e martesës supozohet më e lartë për ata që janë martuar pas periudhës socialiste, pjesërisht për arsye të pasigurisë së përgjithshme për të marrë vendim për t'u martuar. Gjithashtu, mosha e martesës mendohet më e lartë tek migrantët sesa tek jo-migrantët, sepse, në vecanti, janë të rinjtë, ende pa përgjegjësi familjare, ata që migrojnë. Megjithatë, meqenëse këndvështrimi ynë fokusohet në migrimin e brendshëm, vërejmë gjithashtu se çiftet e reja migrojnë së bashku. Ilustrimet 2 dhe 3 pasqyrojnë moshat e martesës për ato çifte që janë martuar para vitit 1991.

Në dy figurat e mëposhtme (2 dhe 3) vërejmë se martesat e bëra nga viti 1991 e më vonë kanë një shpërndarje disi më të gjërë përse i përket moshës së martesës në krahasim me martesat e lidhura para vitit 1991. Kulmi i moshës së martesës për gratë është 20 vjeç në të dy grafikët (gati 14% për ato që janë martuar para vitit 1991, gati 12% për ato që janë martuar në vitin 1991 ose më vonë). Kulmi i moshës së martesës për meshkujt është 26 vjeç për të dy periudhat (përafërsisht 11% e martesave para vitit 1991 dhe përafërsisht 10.5% e martesave nga viti 1991 e më vonë). Po të bëjmë krahasim me

periudhën para vitit 1991, në vecanti, tek gratë mosha e martesës ka tendencë të jetë më e lartë për ato gra që janë martuar në vitin 1991 ose më vonë. Nga ana tjetër, dallimi tek burrat nuk është aq i dukshëm sa tek gratë. Nuk pritet të ketë ndryshime të shpejta në këto tendenca dhe kjo ka rëndësi po të marrim në konsideratë se pushteti vendimmarrës i gruas mund - në varësi të kontekstit - të pësojë rritje thelbësore nëse ajo martohet në një moshë më të madhe. Kjo është më se e vërtetë në qoftë se mosha e martesës për burrat, siç parashikojnë të dhënat, nuk pëson ulje thelbësore, e vetmja mundësi tjetër kjo për për të zvogëluar dallimin në moshë midis dy bashkëshortëve.


#### 4.1.1 Konkluzion: Karakteristikat e njësisë ekonomike familjare dhe të familjes në lidhje me gjininë dhe ndryshimet në marrëdhëniet gjinore.

Çfarë domethënieje kanë dallimet që vume re për mundësitë e burrave dhe grave?

Vërejmë se kryefamiljaret gra janë në përgjithësi në disavantazh përse i përket raportit të varësisë në rastin kur ato jetojnë në familje me një prind ose në familje çift me fëmijë. Në këtë drejtim, gratë migrante janë në dizavantazh të konsiderueshëm. Kryefamiljaret gra të familjeve migrante jetojnë në familje me më shumë fëmijë të mitur dhe me më pak pjesëtarë të moshuar. Në këtë mënyrë, gratë migrante si kryefamiljare duket se mbajnë mbi supet e tyre një barrë më të rëndë të shtëpisë në krahasim me homologet e tyre jo-migrante. Si rezultat i konfiguracionit mesatar të familjes, konkludojmë se gratë migrante në krye të familjeve me një prind përballen me problemin e bashkërendimit të punës së paguar me punët në shtëpi. Të dhënat sugjerojnë se në ditët e sotme gratë martohen në një moshë më të madhe, ndërsa mosha mesatare e burrave në kohën e martesës nuk ka përparuar me të njëjtin hap. Kjo flet për një ngushtim të boshllëkut midis


për një rritje potenciale të pushtetit vendimmarrës brenda familjes. Një koment i përgjithshëm që nuk mund të shqyrtohet duke u bazuar tek të dhënat që disponojmë, por që, megjithatë, vlen të përmendet, ka të bëjë me pasojat e vëzhgimeve të mësipërme: (i) Nga njëra anë, nëse migrimi u ka dhënë migrantëve statusin e të porsaardhurit në vendin pritës, gratë që jetojnë me një partner kanë të ngjarë të përballen me përgjegjësi brenda familjes në një kohë kur ato nuk mund të mbështeten domosdoshmërisht te ndihma e të tjerëve. Sic dihet nga përvoja e grave në vende të tjera, të qenurit shtëpiake, dhe, për pasojë, të izoluar nga një rrjet social i gjerë, mund të krijojnë pengesë për sigurimin e një pushteti vendimmarrës për gratë. (ii) Nga ana tjetër, migrimi shpesh bën që disa pjesëtarë të familjes të bëhen më të ndërvarur ndaj njëritjetrit, pikërisht për arsyen se në afërsi të vendbanimeve të tyre nuk disponohet rrjete të tjerë mbështetës. Kjo mund të nxisë një ndërveprim më të madh midis pjesëtarëve të familjes, veçanërisht nga ana e burrave, të cilët tradicionalisht përfshihen më pak në sferën shtëpiake. Ky ndërveprim mban në vetvete potencialin për të nxitur një mjedis edhe më të barabartë midis burrit dhe gruas në sferën shtëpiake. Se cili nga këto rezultate ka më tepër gjasa, kjo nuk mund të parashikohet mbi bazën e të dhënave të regjistrimit të popullsisë. Ajo që tregojnë të dhënat, megjithatë, është se ndryshimet në strukturën e familjes kanë pasojat e drejtpërdrejta mbi marrëdhëniet ekzistuese gjinore. Në disavantazh më të madh në këtë tablo janë gratë migrante në krye të familjeve me një prind, me fëmijë nën 18 vjeç. Zakonisht këto gra përballen me domosdoshmërinë për të plotësuar si kërkesat ndaj shtëpisë ashtu dhe ato të punës. Ky grup i popullsisë ndihet veçanërisht i brishtë për shkak të mungesave ekonomike dhe mbingarkesës së rolit të tyre. Vërtet, siç konstatohet nga të dhënat e Studimit për Matjen e Nivelit të Jetesës, konsumi mesatar mujor i familjeve me kryefamiljare gra dhe fëmijë nën 18 vjeç është më i ulët sesa ai

**Figura 4:** Numri i viteve të shkollës plotësuar sipas moshës e seksit.



Shembull: E gjithë popullsia  
Burimi: Regjistrimi i popullsisë (INSTAT) 2001

**Figura 5:** Gratë: Numri i viteve të shkollës plotësuar sipas moshës, sipas rajoneve që pësojnë shtim ose humbje të popullsisë



Shembull: Gratë: e gjithë popullsia  
Burimi: Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

i familjeve me kryefamiljarë burra; gratë kryefamiljare kanë shpenzime konsumi në masën 89% të atyre të homologëve burra; shifër kjo e standardizuar për familjen mesatare shqiptare me 4.3 pjesëtarë. Po të përfshijmë në këtë krahasim të gjitha familjet me femra, atëherë shpenzimet mujore të konsumit bien në 80% të shpenzimeve të familjeve me meshkuj. Siç ka qenë rasti edhe për familje të tjera evropiane, kjo popullsi e brishtë me gra ka tendencë të pësojë rritje në të ardhmen në Shqipëri. Për këtë arsye, shteti duhet të marrë në konsideratë praktika që minimizojnë këtë brishtësi dhe pasojat që ajo sjell te gratë dhe fëmijët.

## 4.2 ARSIMI

Në fund të vitit 1990, Shqipëria kishte arritur një përqindje të lartë shkollimi sidomos në krahasim me raportet e konstatuara në vende shumë më të pasura se Shqipëria. Shkalla e analfabetizmit, sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 1989, në atë kohë ishte 7.3 për 100 vetë të moshave 6 vjeç e lart. Kjo përbën vërtet një arritje të konsiderueshme, po të kemi parasysh gjendjen menjëherë pas Luftës së Dyrë Botërore, kur analfabetizmi ishte 80%; në zonat rurale analfabetizmi u ul në masën 90 deri në 95%. Gjatë vitit 1990, pati përmirësime të mëtejshme në fushën e arsimit. Të dhënat e përfuara nga regjistrimi i popullsisë të vitit 2001 flasin për një ulje nën 22 % të analfabetizmit (INSTAT 2002).

Në periudhën socialiste, një rëndësi e madhe iu kushtua sigurimit të mundësive të barabarta për burrat dhe gratë. Në të njëjtën kohë, qeveria veprroi në mënyrë aktive për t'i rivendosur shumë shqiptarë në ato pjesë të vendit ku mundësitë e tyre iu përshtateshin më së miri nevojave të shtetit. Si rezultat, niveli arsimor për burrat dhe gratë në zonat rurale dhe urbane ishte pothuaj i barabartë. Supozojmë që kjo gjendje të ketë ndryshuar

nga ndikimi që ushtroi migrimi i brendshëm dhe ai i jashtëm. Siç tregon figura 4, deri në moshën 18 vjeç nuk vihen re dallime të theksuara në arritjet në nivelin arsimor. Në këtë moshë të rejat kanë rezultate më të mira sesa djemtë, por pas moshës 30 vjeç situata ndryshon në favor të meshkujve. Kjo nënkupton se në grupin e të rinjve dhe të rejave që frekuentonin shkollën gjatë fazës së tranzicionit (moshat 10 deri 20 vjeç në atë kohë), vajzat duket se kanë përfituar më shumë sesa djemtë. Kur krahasojmë rajonet që pësojnë humbje ose shtim të popullsisë, konstatojmë se një nivel më i lartë arsimimi arrihet nga njerëzit që banojnë në rajone që kanë migrim pozitiv. Megjithatë, këto dallime rajonale nuk shfaqen deri në moshën 18 vjeç. Mjafton grafiku për gratë për të treguar këtë krahasim, pasi modeli arsimor ka qenë i ngjashëm si për gratë ashtu edhe për burrat (Ilustrimi 5). I njëjti grafik u ndërtua për burrat dhe gratë veçant, mbi bazën e statusit të tyre si migrant ose jo-migrant. Modeli ishte i njëjtë me grafikët që tashmë kemi paraqitur dhe kjo është arsyeja që këtu nuk paraqiten grafikë të tjerë. Me një fjalë, si burrat ashtu edhe gratë që migrojnë janë më të arsimuar. Të rejat migrante ose jo-migrante në përgjithësi arrijnë ose kanë arritur një nivel më të lartë arsimimi në krahasim me burrat që nuk kanë migruar. Burrat migrantë, megjithatë, kanë prirjen të kenë një nivel arsimor më të lartë.


Supozojmë se që nga viti 1990, në rajonet më të thella të Shqipërisë janë investuar më pak burime në fushën e arsimit. Kjo përbën një shqetësim që tashmë është identifikuar nga Ministria e Arsimit. Gjithashtu, ndërsa gratë përballen me më shumë kërcënime ndaj sigurisë vetjake nga ana e trafikantëve dhe elementëve të tjerë negativë, ka tendencë që frekuentimi i femrave në shkolla të bjerë. Gjithashtu ka të ngjarë që vajzat në shkollat e mesme të mbahen në shtëpi, ndoshta për të vazhduar shkollimin e tyre në një moshë të madhe. Kjo, sipas hamendjes sonë, parashikohet sidomos në rajonet më të thella,

ku rruga për të shkuar në shkollë është më e gjatë sesa në qytete (me fjalë të tjera në rajone që kanë pësuar humbje të popullsisë). Një studim i detajuar, i ndërmarrë nga UNICEF-i nxjerr në pah diskriminimin përse i përket shkollimit të vajzave në familjet rurale, por edhe të atyre që kanë mundur të zhvendosen nga zonat e thella e të jetojnë në qytete. Disa prindër, sidomos baballarët, i pengojnë vajzat e tyre kur ato arrijnë moshën e pubertetit për të vazhduar shkollimin e institucionalizuar. Mohimi patriarkal i vlerës së shkollimit të vajzave që konstatohet në zonat e thella, përforcohet nga rreziku kur vajzat bien ndesh me dhunën dhe mashtrimin (UNICEF 2003). Ç'është e vërteta, me përmbysjen e regjimit socialist, normat dhe vlerat gjinore patriarkale kanë nxitur më tej debatin mbi vlerën e arsimit të barabartë për burrat dhe gratë.

Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që të shënohet me kujdes çfarë ka ndodhur gjatë fazës së transformimit përse i përket shkollimit të vajzave si dhe të vepohet më tej me monitorimin e arritjeve në fushën e arsimit për grupmosha të ndryshme të popullsisë. Për arsyet e paraqitura më sipër, supozojmë që frekuentimi i vajzave në shkolla të jetë ulur në ato rajone që kanë pësuar humbje të popullsisë gjatë fazës së transformimit.

Megjithatë, shqetësimi se vajzat mund ta frekuentojnë shkollën më pak ose të regjistrohen në një moshë më të madhe tani për tani mund të lihet mënjanë. Ç'është e vërteta, 94% e të gjithë fëmijëve të moshës 8 vjeç kanë kryer të paktën një vit shkollë, ndërsa për moshën 10 vjeç kjo shifër është 98%. Nuk ka ndryshime të dukshme midis djemve dhe vajzave, rezultat për t'u krenuar për një vend që ka përjetuar kaq shumë trazira në dhjetë vitet e fundit. Megjithatë, duke pasur parasysh problemin e sigurisë dhe problemin e aksesit në disa rajone, nevojitet një analizë më e detajuar, në shkallë rajonesh të vecantë, që këto shqetësime të lihen mënjanë pa u lëkundur. Përse i përket mundësive që ofrohen


**Figura 6:** Përqindja dhe mosha e fëmijëve që kanë kryer të paktën një vit, sipas seksit, dhe rajoneve që pësojnë shtim ose humbje popullsie



*Shembull:* Të gjithë fëmijët të moshave 6 deri 20 vjeç  
*Burimi:* Regjistrimi i popullsisë (INSTAT) 2001

në fushën e arsimit, sipas Ministrisë së Arsimit shqetësimi është ngritur për gjashtë rrethe. Në këto rrethe, shqetësimi përqendrohet në dy komuna mjaft të thella. Pikërisht për këto dy rrethe: rrethin e Pukës dhe rrethin e Tropojës ne ndërmorrëm një sërë analizash vëzhguese. Krahasuam vitet mesatare shkollore të plotësuara në komunat që konsiderohen më kritike, me vitet shkollore të plotësuara në komuna të tjera rurale në rreth, si edhe me qendrën e rrethit. Për të përcaktuar nëse problemi ishte unike për 12 vitet e fundit që nga përmbysja e socializmit, shembujt tonë i përzgjodhëm sipas grupmoshave dhjetëvjeçare (grupmoshat e 20-vjeçarëve, 30-vjeçarëve etj.). Kemi dy vëzhgime: (i) Shkollimi te banorët e dy rretheve në fjalë është rritur për të gjitha moshat, si për burrat ashtu dhe gratë. Megjithatë (ii), në qendrën e rrethit vërejmë një ulje afërsisht një vit në numrin mesatar të viteve shkollore të plotësuara nga 20 deri 30-vjeçarët (përsëri, e njëjta vlen si për burrat ashtu dhe gratë). Ky rezultat ndoshta pasqyron migrimin në shkallë kombëtare ose ndërkombëtare të individëve më të arsimuar. Një ulje më e vogël në mesataren e viteve të

**Figura 7:** Përqindja e atyre që kanë marrë diplomën e shkollës së mesme, sipas seksit dhe statusit të migrimit.



Shembull: Popullsia e moshës 20 vjet e lart

Burimi: Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

shkollës të kryer për grupmoshat e 30 dhe 20-vjeçarëve konstatohet në komunat rurale dhe në ato më të thella. Ky rezultat tregon se grup-moshat më të reja (20-vjeçarët në vitin 2001) janë ndikuar negativisht nga procesi i transformimit përsa i përket shkollimit. Kjo, megjithatë, do të ishte një lloj shqetësuese si për burrat ashtu dhe gratë. Me qëllim nuk kemi paraqitur pasqyra ose grafikë, sepse mendojmë se çështja në fjalë ende kërkon një analizë më të detajuar. Në veçanti, lind nevoja të ndërmerret një analizë për shpërndarjen e totalit të viteve të shkollës të plotësuar edhe në rrethet e tjerë. Po ashtu, duhen marrë në konsideratë disa nga rrethet më të privilegjuar, për të parë nëse modeli që konstatohet atje është i ngjashëm me atë që është konstatuar në dy rrethet në studim. Publikimi i UNICEF-it argumenton se çështja e arsimit për vajzat nuk lidhet me rajonin e vendbanimit, por me atë të prejardhjes (UNICEF 2003). Në qoftë se është kështu, atëherë të dhënat e regjistrimit të popullsisë nuk disponojnë informacionin e duhur për analiza të tilla. Për më tepër, studimin tonë e kemi kufizuar thjesht në analizën e atyre rajoneve që kanë pësuar shtim ose rënie të

popullsisë. Meqenëse më parë kemi konstatuar pak ndryshime midis djemve dhe vajzave përsa i përket frekuentimit në shkolla, mund të supozohet se vajzat në nivelin e arsimit të mesëm mbahen larg shkollës më shpesh sesa djemtë. Supozojmë gjithashtu se njerëzit që migruan, një veprim të tillë e ndërmorën për të gjetur mundësira shkollimi më të mira për fëmijët e tyre. Një hamendje e tillë parashikon raporte më të larta frekuentimi në shkolla të fëmijët migrantë, me një ndryshim të vogël midis vajzave dhe djemve. Megjithatë, në qoftë se njerëzit kanë migruar për t'i shpëtuar rrethanave të varfërisë, ka të ngjarë që ata t'i inkurajojnë fëmijët e tyre, e në veçanti të rinjtë, të kontribuojnë në mbajtjen e familjes. Kjo do të bënte që përqindja e vajzave që frekuntojnë arsimin e mesëm e atë të lartë të rritet në krahasim me djemtë migrantë. Në veçanti, ky fenomen do të ishte pengesë për djemtë për të arritur nivele më të larta arsimimi.


Siç shihet në Figurën 7, një përqindje më e lartë burrash dhe grash të grup-moshave nga 20 deri 30 vjeç kanë marrë diplomat e arsimit të mesëm, si në rajonet që kanë pësuar shtim të popullsisë ashtu edhe në ato që kanë pësuar humbje (një fenomen i tillë konstatohet në një sërë vendesh të tjera ish-socialiste). Megjithatë, pas moshës 30 vjeç përqindja e grave me diploma të arsimit të mesëm ulet. Gratë në rajonet që pësojnë shtim të popullsisë del se kanë mundësira më të mëdha shkollimi në krahasim me homologët e tyre në rajone me popullsi në rënie. Kjo mund të thuhet edhe për periudhën e regjimit socialist. Një gjë e tillë nënkupton se të rinjtë vërtet mund të kenë qenë në pozitat e të humburve gjatë transformimit, në veçanti për ato rajone që pësuan rënie të popullsisë. Vërtet, këta janë po ata burra që në vitet e mëparshëm kanë qenë më të suksesshëm se homologët e tyre femra. Në përgjithësi, gratë në rajonet që pësuan rënie të popullsisë kanë qenë në pozitat e të humburave përsa në fushën e arsimit në periudhën socialiste, me përjashtim të më të rejave në moshë në

këtë kategori. Të dhënat tregojnë se përqindja e migrantëve që marrin diplomën e arsimit të mesëm është më e madhe se ajo e jo-migrantëve, veçanërisht kur bëhet krahasim midis burrave të të dy grupimeve. Djemtë e rinj migrantë midis moshave 20 dhe 29 vjeç përbëjnë grupimin e popullsisë me përqindjen më të ulët të arsimit të mesëm. Për më tepër, ndërsa të dy grupimet moshohen, ka mundësi që këta të rinj të mos i arrijnë homologet e tyre më të shkolluara. Në të vërtetë, edhe përqindja e të rejave jo-migrante që kanë mbaruar arsimin e mesëm është më e lartë.

Duke pasur parasysh se mundësitë për shkollim të lartë përqendrohen në zonat urbane, parashikojmë që ritmet e arsimit të jenë më të larta në ato rajone që kanë pësuar rritje të popullsisë. Megjithatë, migrimi shpesh karakterizohet nga një shpërndarje bi-polare e arritjeve arsimore të migrantëve midis atyre që kanë një nivel arsimimi më të lartë se mesatarja dhe atyre me një nivel arsimor më të ulët se mesatarja. Nëse një shpërndarje e tillë ekziston për migrimin shqiptar, atëherë mund të flasim për një "rrjedhja e trurit" 'të brendshëm' në Shqipëri si edhe për një situatë ku individët më të varfër të një rajoni të caktuar migrojnë për t'i shpëtuar mjerimit. Megjithatë, në kontekstin shqiptar, ku niveli arsimor është pothuaj i njëjtë në të gjithë vendin, nuk mund të supozojmë një shpërndarje bi-polare midis migrantëve. Për më tepër, në qoftë se dallimet janë të dukshme, supozojmë që ato të jenë të një-anëshme përsa i përket kontributit të tyre ndaj "rrjedhja e trurit" rural.


Përsa i përket gjinisë, mund të supozojmë më tej se gratë me më shumë vite shkollë do të kishin tendencën për të migruar larg zonave në të cilat qëndrimet, normat dhe vlerat tradicionale do t'i pengonin apo frenonin ato për të siguruar një mënyrë jetese më të pavarur. Megjithatë, gra të tilla zakonisht parapëlqejnë të emigrojnë jashtë shtetit, sepse shpesh ato presin të gjejnë më shumë mundësi jashtë sesa në qytetet shqiptare. Siç

**Figura 8:** Gratë: Moshë në martesën e fundit krahasuar me mesataren e numrit të kryer të viteve të shkollës, sipas rajonit



*Shembull:* Popullsia: gratë e moshave 14 deri 40 vjeç  
*Burimi:* Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

**Figura 9:** Gratë: Moshë e martesës së fundit krahasuar me numrin mesatar të viteve shkollorë të kryer, sipas statusit të migrimit



*Shembull:* Popullsia: gratë e moshave 14 deri 40 vjeç  
*Burimi:* Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

flet Figura 9, interesant është fakti se niveli mesatar arsimor i grave migrante dhe jo-migrante është thajse i njëjtë; përqindja e grave migrante që plotësojnë arsimin e mesëm është paksa më e lartë sesa homologet e tyre jomigrante. Ky fenomen, megjithatë, duket se kufizohet në grupmoshën e 30 dhe 50-vjeçareve. Prandaj, përsa i përket grave në përgjithësi, duket se nuk ka shumë

dëshmi që mbështesin supozimin se gratë e shkolluara do të migronin më shpesh. Në kategorinë e burrave (Pasqyra nuk tregohet), përsëri duket se të pafavorizuar janë jo-migrantët përse i përket nivelit të tyre arsimor. Në fakt, dallimi midis migrantëve dhe jo-migrantëve meshkuj ekziston gjatë gjithë kohës deri në moshën 56 vjeç, ndonëse më shumë tek meshkujt më të rinj. Duke pasur si bazë ato pak fakte në lidhje me raportet më të lartë të shkollimit të grave migrante, testuam nëse mund të konstatohej një shpërndarje bi-polare në moshën e martesës, duke u nisur nga fakti se martesë në moshë të re zakonisht shoqërohet me arritje më të ulëta arsimore. Por, siç kuptohet nga Figura 9, nuk është moshë e martesës ajo që shërben si një tregues i rëndësishëm për arritjet arsimore, por prejardhja rajonale.

Nëse migrantët gjejnë apo jo mundësi më të mira shkollimi kjo përbën një çështje tjetër që nuk do ta adresojmë në këtë studim. Ç'është e vërteta, kur njerëzit migrojnë, ata shpesh vendosen në periferitë e bashkësive dhe qyteteve që pësojnë shtim të popullsisë, gjë që shkakton gjithashtu pasoja ngative në shkollimin e vajzave dhe djemve. Pasoja të tilla negative, do të ishin mungesa e institucioneve arsimore në rajonin e destinacionit. Megjithatë, një analizë më e thellë në nivelin e këtyre njësive lokale i kapërcen caqet e kësaj studim. Siç tregon Figura 8, moshë e martesës është e ngjashme për rajonet që kanë pësuar shtim dhe rënie të popullsisë, ndonëse gratë në rajonet që kanë pësuar shtim të popullsisë kanë një nivel më të lartë arsimit sesa gratë në rajonet që kanë pësuar rënie të popullsisë. Ky rezultat të lë të kuptosh se moshë e martesës për gratë në Shqipëri nuk lidhet drejtpërdrejt me numrin e viteve të shkollës të kryer. Tek gratë migrante vërejmë dy grupime, që pasqyrohen në Figurën 9: (i) ato gra që martohen herët me arritje të ulëta në arsim (krahasuar me gratë jo-migrante të cilat po ashtu martohen herët) dhe (ii) ato që martohen

në një moshë më të madhe me arritje të larta në arsim (krahasuar me gratë jo-migrante që gjithashtu martohen vonë).

#### 4.2.1 K O N K L U Z I O N : TREGUESIT E KAPITALIT NJERËZOR PËRSA I PËRKET GJINISË

Në vartësi nga mënyra se si ndodh, migrimi mund të ketë ndikim të ndryshëm në kapitalin njerëzor në dispozicion të individëve në rajonet që përjetojnë ndryshime në popullsi. Nga analiza e rajoneve që pësojnë rënie të popullsisë vërejmë një model të caktuar "të rrjedhjes së trurit" brenda Shqipërisë. Njerëzit më të arsimuar rivendosen me dëshirë në zonat urbane që pësojnë shtim të popullsisë. Këtë model e vërejmë si tek burrat ashtu edhe tek gratë. Kjo të lë të kuptosh se në ato zona që pësojnë humbje të popullsisë ka humbje potenciali për një zhvillim në të ardhmen. Kjo shkakton një pabarazi më të madhe arsimore midis rajoneve dhe njëkohësisht e bën të vështirë për rajonet që kanë mbetur prapa që në të ardhmen të arrijnë nivelin e rajoneve të tjerë. Vërtet, siç del nga analiza e Ministrisë së Arsimit për rajonet që konsiderohen në rrezik, vërejmë se te 20-vjeçarët që jetojnë në qendrën rajonale, rënia e mesatares së viteve të shkollës të kryer nuk ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga mesatarja e viteve të shkollës të kryer në komunat më të thella; po ashtu, kjo rënie nuk ndryshon nga ajo e komunave të tjera rurale të rajonit. Për më tepër, vërehet një rënie e lehtë në mesataren e viteve të frekuentimit të shkollës tek 20-vjeçarët në komuna kur ata krahasohen me 30-vjeçarët. Kjo nënkupton se ka pasur një ndikim negativ në arsimin rural gjatë 12 viteve të transformimit të Shqipërisë. Megjithatë, këto janë veçse analiza fillestare që kërkojnë fakte më të detajuara. Për fat të mirë, ndryshimet e



arritjeve në arsim midis migrantëve dhe jo-migrantëve, si dhe midis burrave dhe grave, nuk kanë filtruar deri në nivelin fillestar. Ato konstatohen vetëm në nivelet të arsimit të mesëm e të lartë. Mund të supozohet se dallimet tek arsimi lartë shoqërohen me mundësitë e reja të migrantëve për arsimim të lartë në qendrat rajonale dhe metropolin urban. Nuk është krejtësisht e qartë se cili është shkaku i dallimeve në aspektin e gjinisë. Grupi i popullsisë që duket se ka pësuar më shumë humbje në fushën e arsimit nuk rezultuan gratë apo vajzat siç pritej, por të rinjtë jo-migrantë. Një shpjegim i mundshëm është se gjatë viteve të para të transformimit, ishte pikërisht ky grup të rinjsh që qe veçanërisht i aftë për të nxjerrë të ardhurat e domosdoshme të familjes, por që nga ana tjetër mbeti pa kryer arsimin e mesëm.

Problemi aktualisht është nëse të rejtat e shkolluara kanë qenë në gjendje t'i konvertojnë avantazhet e tyre në arsim në avantazh ekonomik. Për fat të keq, nuk disponojmë të dhëna që të mund t'i japim një përgjigje definitive kësaj pyetjeje, sepse regjistrimi i popullsisë nuk përmban të dhëna mbi ardhurat personale. Por edhe kjo është e koklavitur për faktin se shumica e profesioneve që përmenden në përgjigjet tek formularët e regjistrimit të popullsisë i referohen profesioneve në bujqësi, dhe kjo të pengon të bësh një dallim të qartë midis burrave dhe grave. Një mënyrë tjetër për të krijuar një ide më të përafërt për konvertimin e avantazhit arsimor të grave në avantazh financiar është të vësh nëse dhe si ato janë në gjendje të inkuadrohen në tregun e punës.

### 4.3 TREGU I PUNËS<sup>19</sup>

Në periudhën socialiste burrat dhe gratë ishin pak a shumë njëlloj të integruar në tregun e punës. "Shifrat që i takojnë vitit 1985 tregojnë se niveli i pjesëmarrjes së gruas në tregun e

punës ishte pothuaj i barabartë me atë të burrit" (Ekonomi et al, 1999: 60). Por pjesëmarrja e grave ra në vitet që pasuan. "Në vitin 1989 kjo përqindje ishte 43.8" (Ekonomi et al, 1999: 6). Aktualisht mbrojtja sociale apo ligjore ekzistuese për gratë nuk është e mjaftueshme, sidomos në tregun privat. "Sipas të dhënave që disponohen, 70 përqind e grave dhe vajzave që janë të punësuar në sektorin privat nuk kanë lidhur ndonjë kontratë ligjore dhe, rrjedhimisht, nuk kanë një siguri sociale" (Ekonomi et al, 1999: 58). Prandaj, pabarazitë ligjore në lidhje me pjesëmarrjen në tregun e punës dhe në kushtet e një pjesëmarrjeje të tillë janë shtuar në periudhën pas rënies së socializmit.

Kodi i Punës percakton pagë të barabartë për punë të barabartë; megjithatë, nuk disponohen të dhëna se sa korrektësisht zbatohet ky kod në praktikë. Në realitet, gratë në Shqipëri vuajnë nga mundësitë e pabarabarta për punë si dhe nga pabarazia në pagesë. Gratë gjithashtu e vuajnë më shumë fenomenin e papunësisë (INSTAT 2004). Siç duket, megjithëse gratë gëzojnë mundësi të barabarta për arsimim të lartë, shkollimi nuk u siguron atyre mundësi të barabarta në tregun e punës.

Modelet e një pabarazie të tillë vihen re në shumicën e shteteve të periudhës post-socialiste dhe ato përfshijnë fenomene të tillë si humbja e vendit të punës, ngarkesa më e madhe në punë, më pak përfaqësim politik, një Indeks të ulët të Zhvillimit Gjinnor si dhe një mbingarkese të rolit të grave në shtëpi (Holzner 2000; Culi 2000). Por gjendja e grave shqiptare është edhe më e rëndë sesa ajo e grave në vende të tjera post-socialiste. Gjatë dekadës së kaluar, tranzicioni i Shqipërisë nga një ekonomi e centralizuar me punësimin e plotë, në tregun e lirë që drejtohet nga ligjet e ofertës dhe kërkesës, ka bërë që ritmet e papunësisë të rriten në mënyrë dramatike. Ne

<sup>19</sup> Një informacion i bollshëm mbi këtë çështje mund të gjendet në publikimin e grupit të punës (INSTAT 2004b)

supozojmë që këto ndryshime të kenë ndikuar në mënyrë të ndryshme te gratë dhe burrat, siç ka qenë rasti në ekonomi të tjera ish-socialiste, në të cilat po ndodh një tranzicion i ngjashëm ekonomik. Pra, supozojmë se në përgjithësi në tregun e punës ka më shumë gra sesa burra të punësuar. Një hipotezë alternative është se ka më shumë jo-migrantë të papunësuar (si burra dhe gra) sesa migrantë, sidomos nëse supozojmë se njerëzit migrojnë pjesërisht me motivin për të kërkuar mundësi për punë. Por një hipotezë që mund të ngrejme është edhe se nuk ka ndryshim, pasi shpesh arsyeja pse jo-migrantët zgjedhin të mos largohen, është se kanë punësim të mjaftueshëm. Gratë përballen me më shumë vështirësi e pengesa në përpjekjet e tyre për t'u integruar në tregun e punës, sidomos kur ato vendosen në një vend të ri. Përsa u përket grave të pamartuara, shpesh është e vështirë për to që të gjejnë mundësi strehimi dhe të ndihen të sigurt larg kujdesit e përkrahjes së familjeve të tyre. Nga ana tjetër, gratë e martuara duhet t'u përgjigjen edhe detyrimeve

shtëpiake, shpesh duke pasur një mbështetje të vogël strukturore (si, p.sh. disponimin e kopshteve për fëmijët etj.). Përveç kësaj, arsye që ndikojnë në përfaqësimin më të ulët të grave në fuqinë punëtore mund të jenë edhe çështjet e sigurisë sociale dhe ndikimi i qëndrimeve provinciale. Megjithatë, arsyeja kryesore për frekuencën e ulët të grave në pjesëmarrjen në tregun e punës është mungesa e mundësive për punësim. Është interesant fakti se gratë e pamartuara shpesh fillojnë punë njëkohësisht me burrat e martuar, ndonëse përqindja e grave që punojnë është shumë më e ulët dhe modeli i punësimit ngjason më atë të burrave të martuar. Një nga arsyet kryesore pse njerëzit migrojnë është se ata janë në kërkim të mundësive më të mira ekonomike. Për fat të keq, dhe sic e kemi konstatuar më parë, nuk disponojmë të dhëna nga regjistrimi përse i përket të ardhurave personale. Prandaj për të matur këtë ne mjaftohemi me vlersime të ndryshme. (i) Një prej tyre është të shikojmë nëse migrantët janë të punësuar apo të papunësuar, si në nivelin e kryefamiljarit ashtu


Tabela 7: Përqindja e kryefamiljarëve migrante dhe jo-migrante, sipas statusit të punësimit

KRYEFAMILJAR	Statusi i punësimit: %		Statusi i punësimit: punëdhënës		Statusi i punësimit: i vetëpunësuar		Statusi i punësimit: punonjës shtëpie	
	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
<b>JOMIGRANT</b>								
Njësi ekonomike familjare me një vetë	31.6	51.3	8.6	9.4	41.8	24.1	18	15.3
Familje e zgjeruar	27.5	42.7	5.9	7.1	48.4	31.9	18.2	18.2
Çift pa fëmijë	32.9	31.9	6.9	5.2	46.7	41.3	13.5	21.6
Çift me fëmijë	30.2	32.1	6.2	3.7	50	46.8	13.5	17.5
Familje me një prind	30.3	41.5	5.4	7.3	49.6	36.5	14.6	14.7
Njësi ekonomike familjare me shumë familje	25.3	25.9	4.8	3.5	58.8	50	11.1	20.6
<b>Totali</b>	<b>35.6</b>	<b>45.1</b>	<b>7.6</b>	<b>7.3</b>	<b>59</b>	<b>46.1</b>	<b>17.8</b>	<b>21.6</b>
<b>MIGRANT</b>								
Njësi ekonomike familjare me një vetë	37.2	59.3	8	10.8	33.6	16	21.1	13.9
Familje e zgjeruar	46.1	61.7	7.9	7.4	27.7	18.1	18.4	12.9
Çift pa fëmijë	42.4	42.6	9.7	7.9	30.8	29.9	17.1	19.6
Çift me fëmijë	39.9	41.8	8.7	5.3	33.8	36.1	17.6	16.8
Familje me një prind	38.6	42.8	6.7	8.7	35.6	30.5	19.1	18
Njësi ekonomike familjare me shumë familje	38.5	33.1	8.4	4.9	39.3	42.7	13.8	19.3
<b>Totali</b>	<b>48.5</b>	<b>56.3</b>	<b>9.9</b>	<b>9</b>	<b>40.2</b>	<b>34.7</b>	<b>21.4</b>	<b>20.1</b>

Shembull: Kryefamiljarë

Burimi: Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

**Figura 10:** Mesatarja e orëve të punës për gratë e punësuar



*Shembull:* Të gjitha femrat e rritura të punësuar, sipas gjendjes civile ( të martuarat kundrejt të pamartuarave, d.m.th., beqare, e divorcuar, e ndarë ose e ve), moshës së fëmijës më të mitur të familjes, statusit të migrimit dhe rajonit ku

*Burimi:* Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

**Tabela 8:** Përqindja e kryefamiljarëve migrante dhe jomigrante, sipas orëve të punës

KRYEFAMILJARE	Numri i orëve të punës javën e mëparëshme, (vetëm të rriturit e aftë për punë)		Numri i orëve të punës zakonisht, e gjithë familja	
	Burra	Gra	Burra	Gra
<b>JOMIGRANT</b>				
Njësi ekonomike familjare me një prind	34.7	33.6	15.5	5
Familje e zgjeruar	35.8	34.6	15.4	9.3
Çift pa fëmijë	35.6	33.9	11	8.7
Çift me fëmijë	36.4	34.6	19.5	10.8
Familje me një prind	35.9	33.7	12.7	12.9
Njësi ekonomike familjare me shumë prindër	37.4	34	12.3	9.5
<b>Totali</b>	<b>36</b>	<b>34.1</b>	<b>14.4</b>	<b>9.4</b>
<b>MIGRANT</b>				
Njësi ekonomike familjare me një prind	35	36.5	23.4	10.1
Familje e zgjeruar	36.5	37.1	19.1	16.4
Çift pa fëmijë	35.6	33.7	17.1	10.1
Çift me fëmijë	36.1	35.1	23.6	9.8
Familje me një prind	35.5	34	14.8	14.3
Njësi ekonomike familjare me shumë prindër	37.6	34.4	13.2	9
<b>Totali</b>	<b>36</b>	<b>35.1</b>	<b>18.5</b>	<b>11.6</b>

*Shembull:* Të gjithë pjesëtarët e rritur të familjes, përmbledhur në nivel njësisë ekonomike familjare;

*Burimi:* Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

edhe për të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes. Meqenëse njerëzit që disponojnë mjetet e prodhimit (d.m.th., tokën prodhuese, bizneset e vogla, apo klientelën personale në qoftë se punojnë në mënyrë të pavarur) kanë më pak gjasë të migrojnë, parashikojmë se një përqindje më e lartë kryefamiljarësh migrantë sesa jo-migrantë do të kenë status punësimi në tregun e punës. Duke pasur parasysh se është më e lehtë të parashikosh të ardhura të rregullta dhe të përfitosh nga marrëdhëniet kontraktuale me një status prej të punësuar, parashikojmë të kemi një përqindje më të madhe të grave kryefamiljare të punësuar. Tabela 7 konfirmon parashikimin tonë se kryetarët e familjeve migrante do të punësohen në një raport më të lartë sesa kryetarët e familjeve jo-migrante (p.sh., 48.55 kundrejt 35.6%) dhe se do kemi një përqindje më të lartë kryefamiljaresh gra të punësuar sesa kryefamiljarësh burra (56.3% kundrejt 48.5%). Kjo sugjeron se migrantët kanë qenë mjaft të aftë të përmirësojnë gjendjen e tyre ekonomike duke u vendosur në një vend tjetër. Në të kundërt, midis të vetëpunësuarve konstatohen më pak kryefamiljare gra sesa kryefamiljarë burra. Megjithatë, diçka interesante është se të dhënat flasin për një përqindje afërsisht të barabartë të familjeve me kryefamiljar burra dhe kryefamiljare femra që janë punëdhënës. Te jo-migrantët gjejmë një numër pak më të madh kryefamiljaresh gra të angazhuara si punonjëse në ndërmarrjen e familjes sesa meshkuj; një gjë e tillë nuk ndodh në familjet migrante, në të cilat si kryefamiljarët burra ashtu edhe ato gra angazhohen gati njëjloj në ndërmarrjen e familjes. (ii) Një mënyrë tjetër për të përcaktuar angazhimin në tregun e punës është krahasimi i orëve të punës të kryera për pagesë në javën e mëparshme nga pjesëtarët e punësuar të familjes me numrin e orëve zakonisht të kryera nga të gjithë pjesëtarët e rritur të familjes. Për arsye të raporteve më të larta të varësisë social-demografike, përveç supozimit se njerëzit migrojnë për të kërkuar punë, ne parashikojmë edhe se migrantët (si burrat dhe gratë) kryejnë më shumë orë pune

në javë, si në tregun e punës ashtu edhe në familje. Supozojmë gjithashtu se mesatarja e orëve të tyre të punës do të jetë më e lartë, sepse parashikojmë që në rajonet që pësojnë shtim të popullsisë ofrohen më shumë mundësi për punë. Pasqyra 8 tregon se në kategorinë e atyre që punojnë me pagë, burrat dhe gratë punojnë pothuajse njëjloj. Megjithatë, nëse i hedhim një vështrim familjes dhe kombinojmë orët e punës të kryera nga të gjithë të rriturit të aftë për punë, konstatojmë se si total më shumë orë pune janë kryer nga familjet që kryesohen nga burra sesa nga familjet që kryesohen nga gra (14.4 orë pune për javë për familjet jo-migrante me kryefamiljarë meshkuj kundrejt 9.4 orë pune për familjet me kryefamiljare gra). Rrjedhimisht, edhe përqindja e orëve të punës në familjet migrante, krahasuar me familjet jo-migrante, është më e madhe për familjet që kryesohen nga femra sesa për familjet që kryesohen nga meshkuj. Megjithatë, një analizë më e detajuar sipas grupmoshave mund të nxjerrë në pah një model tjetër. Në qoftë se i hedhim një vështrim më të detajuar konfiguracionit të familjes për gratë, siç tregohet në Ilustrimin 10, vërejmë se tre nga të katër kategoritë e grave migrante ka më tepër të ngjarë të punojnë, dhe madje për më shumë orë pune në javë sesa ato jo-migrante. Përjashtim bëjnë gratë jo-migrante të punësuar që janë të martuara dhe nuk kanë fëmijë nën moshën 15 vjeç. Të gjitha gratë me një fëmijë nën 15 vjeç (më përjashtim të grave migrante të martuara) kryejnë më pak orë pune. Modeli nuk është i njëjtë kur rajonet që kanë pësuar shtim të popullsisë krahasohen me rajonet që kanë pësuar rënie të popullsisë. Gratë në rajonet që kanë pësuar rënie të popullsisë kanë kryer numrin më të madh të orëve të punës, me përjashtim të grave jo-migrante të pamartuara me një fëmijë nën moshën 15 vjeç (p.sh., një nënë e pamartuar). Dallimi më i madh në orët e punës midis kategorive të grave që përcaktohen si nga mosha e fëmijës më të mitur ashtu edhe nga statusi i migrimit vërehet te migrantët e pamartuar (gjë që nënkupton ata që janë të

pamartuar, të ndarë, të divorcuar apo të ve), të cilët kanë një fëmijë nën moshën 15 vjeç dhe jetojnë në rajonet që kanë pësuar shtim të popullsisë. (Dallimi vërehet, me fjalë të tjera, midis nënave migrante të pamartuara me fëmijë të mitur në zonat urbane dhe nënave të pamartuara migrante në zona më rurale). Kjo tregon se për nënat e vetme me fëmijë të mitur ekzistojnë më tepër mundësi në rajonet që pësuan shtim të popullsisë.

#### 4.3.1 Konkluzione në lidhje me migrimin, gjininë dhe tregun e punës


Pjesëtarët e njësive ekonomike familjare migrante vërtet kanë patur mundës më të mëdha për t'u punësuar, në krahasim me homologët e tyre jo-migrantë. Në përgjithësi, del se ata kanë bërë më shumë orë pune gjatë javës para regjistrimit të popullsisë; po kështu njësitë ekonomike familjare migrante në tërësi kanë bërë më shumë orë pune sesa pjesëtarët e aftë për punë të familjeve jo-migrante. Situata në rajonet që kanë pësuar shtim të popullsisë paraqitet paksa më e favorshme për gratë: të dhënat tregojnë se në rajonet e populluara gratë janë të afta të bëjnë më shumë orë pune sesa homologët e tyre që jetojnë në rajone që po pësojnë humbje të popullsisë. Është më e lehtë gjithashtu të ruhet një raport i favorshëm varësie social-demografike midis njësive ekonomike familjare migrante sesa midis njësive ekonomike familjare jo-migrante, ndoshta kjo si pasojë e drejtpërdrejtë e migrimit. Pavarësisht nga përmirësimet, kur bëhet krahasim midis migrantëve dhe jo-migrantëve, duhet të konkludojmë se gratë - nëse supozojmë se ka pasur një punësim të plotë të grave 10 vjet më parë kanë humbur shumë peshë në tregun e punës, një situatë kjo që mund të ndikojë së tepërmi në vetëbesimin e vajzave të reja, si edhe në pushtetin vendimmarrës që vjen krahas pavarësisë ekonomike. Mbi të gjitha, ky përjashtim nga tregu i punës ka lënduar autonominë ekonomike të grave, sidomos pas

heqjes së përkrahjes financiare në Shqipërinë post-socialiste.

### 4.4 KUSHTET E JETESËS

Duke qenë se periudha e transformimit ka sjellë ndryshime në të gjithë aspektet e jetës së përditshme, analiza e strehimit dhe kushteve të jetesës, si tregues të mirëqenies ekonomike, janë thelbësore për kontekstin shqiptar. Në mënyrë më specifike, ngrejmë pyetjen: a ka ndryshime midis kushteve të jetesës në tipet e ndryshme të njësive ekonomike familjare? A ndryshojnë kushtet e jetesës sipas tipeve të njësive ekonomike familjare? Siç shprehet Fernandez Kelly në artikullin e saj (Fernandez Kelly, 1981), zhvillimi nuk mund të përcaktohet thjesht me terma

**Figura 11:** Raporti i artikujve të luksit kundrejt sendeve të domosdoshme shtëpiake, sipas gjinisë së kryefamiljarëve




*Shembull:* Të gjithë kryefamiljarët e njësive ekonomike familjare  
*Burimi:* Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

ekonomike; në përgjithësi, zhvillimi nënkupton mundësi më të barabarta ndaj burimeve të disponueshme dhe një pjesëmarrje më të gjërë për gjithë njerëzit. Sipas literaturës së shtjelluar në pjesën 2, vërtet ekzistojnë mundësi të tilla që përparësitë brendafamiljes

të përcaktohen ndryshe në varësi të faktit nëse kryetari i familjes është mashkull apo femër. Hipoteza jonë është se artikuj të caktuar shtëpijakë gjenden më shpesh në familjet që kryesohen nga meshkuj (si përqindje në totalin e familjeve që e zotërojnë këte artikull) sesa në familjet që kryesohen nga femra. Si provë fillestare, ne krahasuam shpërndarjen e artikujve të ndryshëm. Mallrat e ndryshëm janë: televizorë, antena parabolike, frigorifer, makinë larëse, sobë gatimi elektrike, sobë gatimi me gaz, mikrovalë, kondicioner, kompjuter dhe makinë. Rezultatet qenë si më poshtë: thujse nuk gjetëm dallime përsa i përket pronësimit të mallrave sipas tipeve të familjes apo sipas staturit të migrimit të familjes. Kjo sugjeron se shpërndarja e mallrave të tilla është thujse e barabartë për shumicën e familjeve. Nëse supozojmë se

familjet së pari blejnë sende shtëpiake të domosdoshme dhe më vonë të shtrihen në sendet e luksit, atëherë një tregues i mirë i mirëqenies ekonomike duhet të jetë raporti i artikujve të luksit me sendet më të domosdoshme shtëpijake. Për ta lehtësuar analizën tonë, ne i kemi përkufizuar "artikujt e luksit" dhe "sendet e domosdoshme" si më poshtë: artikujt e domosdoshëm janë ata që bëjnë të mundur apo thjeshtësojnë punët në shtëpi, pra, punën e gruas në shtëpi e bëjnë më pak të sforcuar (d.m.th, frigoriferi, makina larëse, soba elektrike dhe ajo me gaz për gatim). Konsideruam si artikuj luksi televizorin, antenat parabolike, mikrovalën, kondicionerin, kompjuterat dhe automjetet. Raporti i numrit të artikujve të luksit me numrin e artikujve të domosdoshëm bën një standartizim midis

**Figura 12:** Dallimi midis artikujve të luksit dhe sendeve të domosdoshme shtëpiake, sipas statusit të migrantit\*



**Remarks:** \* Dallimi midis artikujve të luksit dhe sendeve të domosdoshme shtëpiake për jomigrantët dhe migrantët përlogaritet duke bërë zbritur përqindjen e artikujve të luksit dhe sendeve të domosdoshme shtëpijake të migrantëve nga ajo e jomigrantëve. Një vlerë pozitive tregon se jomigrantët kanë më shumë artikuj luksi sesa sende të domosdoshme shtëpiake në raport me migrantët; një vlerë negative tregon se migrantët kanë më shumë artikuj luksi sesa sende të domosdoshme shtëpiake në raport me jomigrantët.

**Shembull** Të gjithë kryefamiljarët e njesise ekonomike familjare

**Burimi:** Regjistrimi i popullsisë INSTAT 2001

familjeve të madhësive të ndryshme. Hipoteza jonë është se në shtëpitë që kryesohen nga burra do të vërejmë më shumë artikuj luksi sesa artikuj të domosdoshëm në raport me familjet që kryesohen nga femra. Kjo ndodh sepse familjet që kryesohen nga meshkuj kanë më tepër fuqi blerëse dhe përparësi më të mëdha që përcaktohen nga vetë kryetarët e familjes. Figura 11 tregon vërtetësinë e kësaj hipoteze. Dhe vërtetë grafiku tregon se raporti i artikujve të luksit kundrejt artikujve të domosdoshëm shtëpijakë është përherë më i madh në familjet që kryesohen nga meshkuj. Për më tepër, ai është më i lartë në familjet me një person dhe në familjet e zgjeruara. Në qoftë se marrim parasysh strukturën e ndryshme të moshave në familjet me një person (gratë në përgjithësi janë më të vjetra, ndërsa burrat janë disi të rinj), atëherë e kemi të lehtë të shpjegojmë ndryshimin e madh midis raporteve. Raporti është gjithashtu i lartë në familjet me një prind mashkull. Ky rast mund të shpjegohet me faktin shpesh se djemtë e rritur konsiderohen si kryetarë të familjeve kur jetojnë me nënat. (Këtu përsëri ballafaqohemi me problemin e përkufizimit të kreut të familjes tek pyetëtori i Regjistrimit të Popullsisë).

Kur krahasojmë migrantët me jo-migrantët vërejmë se migrantët përgjithësisht kanë përqindje pak më të ulëta të artikujve të luksit sesa jo-migrantët. Vërejmë gjithashtu se dallimi në raporte është disi më i madh për familjet me kryefamiljar burra sesa për familjet me kryefamiljare gra. Megjithatë, është e rëndësishme të mbajmë mend se raporti standardizon madhësitë të ndryshme familjesh dhe, në këtë mënyrë, nuk jep ndonjë tregues për numrin e sendeve shtëpiake. Nëse supozojmë se familjet në fillim sigurojnë artikujt e domosdoshëm shtëpijakë dhe më vonë ato të luksit, atëherë ky konstastim sugjeron se jo-migrantët kanë qenë në gjendje të akumulojnë më me lehtësi sesa migrantët, mallra në përgjithësi dhe artikuj luksi në veçanti; kjo sidomos në familjet me

kryefamiljar burra. Të dhënat sugjerojnë se blerja e artikujve të luksit është përparësi më e madhe për familjet me kryefamiljar burra sesa për familjet me kryefamiljare gra. Dallimi midis familjeve migrante dhe jo-migrante me kryetare gra, sic e përmendëm më sipër, nuk është aq i madh sesa ai midis atyre me kryefamiljarë burra (shih ilustrimin 12). Nëse kryefamiljaret e familjeve meshkuj e femra do të kishin të njëjtat përparësi konsumi, atëherë kjo gjë do të sugjeronte se në përgjithësi dallimet kanë të bëjnë me shëndetin ekonomik të kryefamiljar(it)/es dhe, në këtë mënyrë, do të konkludonim se burrat sesa gratë gati në të gjitha tipet e familjes. Në të kundërt, nëse supozojmë se midis familjeve me kryetarë meshkuj dhe atyre me kryefamiljare femra ekzistojnë përparësi të ndryshme konsumi, atëherë të dhënat sugjerojnë se burrat u japin përparësi artikujve të luksit dhe se familjet jo-migrante me kryefamiljar meshkuj disponojnë mundësi më të mëdha për t'i blerë ato. Në të kundërt, kryefamiljaret femra duket se u kanë dhënë vetes të njëjtat përparësi, pavarësisht nga statusi i tyre migrant, duke qenë se ndryshimi në raportin midis dy tipeve të familjeve është më i vogël. I vetmi grup që po e "përmirëson" gjendjen e tij në këtë drejtim janë familjet migrante me kryefamiljare femra tek çiftet pa fëmijë. Megjithatë, për shkak të kufizimeve në përlogaritjen e raportit të artikujve të luksit me artikujt e domosdoshëm shtëpiakë, ndërmarrja e një studimi të mëtejshëm do të ishte shumë e dobishme.

#### 4.4.1 Konkluzione në lidhje me kushtet e jetesës së njësive ekonomike familjare të ndryshme

Analiza e të dhënave të përfutuara nga regjistrimi i popullsisë mundëson një vështrim të shpejtë të kushteve të jetesës të familjeve. Megjithëse kryefamiljaret femra duket se janë në përgjithësi në disavantazh material, grupe të caktuar grash që kanë migruar në 10 vjetët

e kaluar kanë mundur ta përmirësojnë gjendjen e tyre në krahasim me homologet e tyre jo-migrante. Ndërkohë, grupi që është më i privilegjuar në përgjithësi duket se është ai i meshkujve të rinj migrantë që jetojnë më vete. Kështu, duket se procesi i transformimit nuk i ka prekur njëllot të gjitha familjet. Sigurisht, nevojiten studime të mëtejshme për të identifikuar më mirë proceset që lëvrojnë pas këtyre ndryshimeve.



## ***Diskutim dhe konkluzione***

Ne zgjodhëm të hulumtonim mbi ndikimin e migrimit të brendshëm masiv tek burrat dhe gratë, sepse migrimi ka qenë një fenomen i gjithëpranishëm në shoqërinë shqiptare për gati një dekadë të tërë. Migrimi ndikon në mënyrë të konsiderueshme mbi kushtet e jetesës së gjithë shqiptarëve. Në të njëjtën kohë, ndërsa flasim për migrimin e brendshëm, duhet gjithashtu të theksojmë se migrimi në botë në shkallë të gjerë ka kontribuar për të zbutur ndikimin e transformimeve të vrullshme ekonomiko-sociale. Të tilla ndryshime të thella në shoqëri kanë ndikim të ndryshëm te burrat dhe gratë. Sigurisht, ekzistojnë një mori grupimesh të popullsisë që transformimet i përjetojnë ndryshe nga njëri-tjetri, por në kumtesën tonë kemi parazgjedhur që këtë studim ta kufizojmë tek përvojat e grave dhe burrave. Në vende të tjera evropiano-lindore studimet kanë treguar se gratë, më shpesh sesa burrat, konsiderohen si të humburat në periudha tranzicioni. Për këtë arsye, ne u përpoqëm t'u përgjigjemi disa pyetjeve kyçe me karakter social-ekonomik, duke shfrytëzuar të dhënat e grumbulluara nga Regjistrimi i Popullsisë së Shqipërisë i vitit 2001 (INSTAT) si dhe duke përdorur dëshmi historike, argumente të botuara dhe detaje narrative mbi jetën e përditshme në Shqipëri. Pyetjet ishin si më poshtë: Çfarë formash të pabarazisë gjinore po formohen si rezultat i procesit të vrullshëm

të transformimit në Shqipëri? Në ç'mënyrë ndryshojnë situatat e migrantëve nga situatat e atyre që nuk kanë migruar? A tregojnë këto ndryshime se migrimi është një proces gjinor dhe, nëse kjo është e vërtetë, çfarë pasojash kanë ato te gratë dhe burrat? Shfrytëzimi i të dhënave të regjistrimit për të gjetur përgjigje për pyetjet tona ishte disi e vështirë. Jeta e përditshme e grave rrallë preket nga pyetësorët e regjistrimit të popullsisë. Ashtu si edhe të tjerë para nesh, u ballafaquam edhe me përkufizimin problematik "kryefamiliar" përdorur në regjistrimin e popullsisë. Duke qenë se gjininë e konsiderojmë si njësi të analizës që mund të kuptohet vetëm si raporti midis burrave dhe grave në një kontekst specifik kulturor, ekonomik, politik dhe shoqëror, ne zgjodhëm që në qendër të studimit tonë të vendosim familjen (pasi familja është një njësi sociale dhe ekonomike ku mund të eksplorohej më mirë raporti i pushtetit midis burrit dhe gruas). Prandaj, për ta shtjelluar problemin nga këndvështrimi gjinor, menduam se ishte e domosdoshme të përqendroheshim tek kryefamiljari, për faktin se është pikërisht ky person që kontribuon thelbësisht në marrjen e vendimeve brenda familjes dhe rrjedhimisht në mundësitë që u ofrohen pjesëtarëve të saj. Për të kuptuar si janë krijuar mundësitë në familjet perëndimore është përdorur për vite me radhë analiza e familjes me kryefamiljare

femra si dhe analiza e strukturës së familjeve në përgjithësi (p.sh., McLanahan 1983; 1985; McLanahan dhe Booth 1989; McLanahan dhe Garfinkel 1989; 1995). Megjithatë, ashtu si edhe në regjistrime të tjera të popullsisë, përkufizimi i "kryefamiljarit" është i paragjykuar në kuptimin që burrat shpesh shfaqen pa të drejtë si kryefamiljarë (për diskutim shih Buvinic dhe Gupta 1997; Varley 1996). Prandaj, në disa raste gjatë studimit tonë ne ishim të detyruara të merrnim në konsideratë si treguesit e tërthortë të kushteve të jetesës ashtu edhe shpërbërjen e familjeve të tëra nga seksi. Jemi në gjendje që pyetjeve tona t'u ofrojmë disa elemente të përgjigjeve, ndonëse ende lind nevoja për një studim të mëtejshëm. Socializmi pati një ndikim pozitiv në arsimimin e grave, përvijën e punësimit dhe përfshirjen politike. Gratë dhe burrat përcaktoheshin sipas rolit të tyre brenda sferës private dhe publike dhe jo domosdoshmërisht si individë, gjë që lehtësonte barrën e rolit tradicional të grave në mjediset patriarkale. Transformimi jashtë socializmit në Shqipëri ka sjellë ndryshime të thella si për burrat ashtu edhe për gratë. Janë paraqitur mundësi të ndryshme, që në disa raste i favorizojnë burrat, por që i disfavorizojnë në raste të tjera. Megjithatë, pavarësisht nga rëndësia e rastit, ndryshimet favorizojnë burrat ose familjet në rastet ku burri ka pozicionin e kryefamiljarit. Kushtet e jetesës të përcaktuara nga raporti i sendeve të luksit kundrejt sendeve të domosdoshme të familjes janë më të favorshme për kryefamiljaret meshkuj. Në shkallë individuale, pavarësisht nga një nivel i lartë papunësie, burrat, janë shpesh më të punësuar sesa gratë. Gjithashtu, literatura vë gishtin mbi faktin se burrat kanë mundësi më të mëdha për të siguruar një pozitë më të ngritur dhe një vend pune me pagesë më të lartë sesa gratë (Ekonomi e të tjerë 1999). Po ashtu, del se burrat më të vjetër në moshë janë një ndihmë më shumë në një familje sesa gratë më të moshuara. Për pasojë, gratë me moshë më të vjetër jetojnë më shpesh vetëm në krahasim me burrat më

të moshuar, një rrymë kjo që është përkeqësuar me ndërprerjen e përkrahjes nga shteti në periudhën pas-socialiste. Megjithatë, konstatojmë gjithashtu situata të tilla në të cilat burrat janë në disavantazh në krahasim me gratë. Duket se gratë tashmë po marrohen në një moshë disi më të vjetër, ndërkohë që mosha e martesës për burrat nuk ka ndryshuar. Kjo do të thotë se ndryshimi i moshës për martesë midis burrit dhe gruas me kohë do të zvogëlohet dhe, në teori, do të përmirësojë pozitën e grave përsa i përket dëgjimit të zërit të tyre brenda familjes. Ky avantazh potencial përforcohet me rritjen e nivelit të arsimit të gruas, meqenese arsimi është një faktor kyç për mbrojtjen e të drejtave, autoritetit dhe pavarësisë. Por, siç del në pah nga të dhënat ekzistuese, gratë kanë vështirësi për të konvertuar arritjet e tyre arsimore në përfitime në tregun e punës, në pjesëmarrjen shoqërore apo në të drejtën e tyre vendim-marrëse. Rrethanat e ndryshuara (në vecanti pakësimi i institucioneve të kujdesit për fëmijën nga ana e shtetit) e bëjnë më të vështirë për gratë që të bëhen pjesë e fuqisë punëtore, sidomos në sektorin privat. Kudo ku është e mundur, kujdesi për fëmijën nga pjesëtarë të tjerë të familjes parapëlqehet përkundrejt institucioneve shtetërore të kujdesit për fëmijët, meqë këto të fundit kanë pësuar një rënie të cilësisë së tyre. Gjithashtu, në këtë aspekt, mundësitë e reja u kanë lënë vendin mënyrave tradicionale të funksionimit, dhe si të tilla kanë bërë që të zgjerohet fusha e veprimtarisë së grave, ndonëse jo përherë ato sigurojnë të ardhura të mëdha - disa herë gjyshërit kujdesen për nipat e mbesat e tyre, ndërsa gjyshet punojnë dhe u japin mundësi grave të reja që të ndjekin karrierat, edhe pse ato (ende) nuk paguhen mirë. Në fakt të dhënat sugjerojnë disa dallime në strukturën e familjes midis migrantëve dhe jo-migrantëve, gjithësesi, ndikimi ndaj burrave dhe grave mund të vlerësohet vetëm me hamendje. Të dhënat e regjistrimit 2001 tregojnë se të rinjtë jo-migrantë që jetojnë në rajone ku ka pasur largim të popullsisë, kanë qenë ata që kanë

humbur nga pikëpamja arsimore gjatë dhjetë viteve të kaluara. Edhe pse gratë kryefamiljare në përgjithësi duken se janë në disavantazh nga pikëpamja materiale, grupe të caktuara grash që kanë migruar gjatë dhjetë vjetëve të fundit kanë mundur të përmirësojnë gjendjen e tyre në krahasim me homologet e tyre që nuk kanë migruar. Në përgjithësi, pamja në Shqipëri është komplekse dhe kontradiktore. Gratë kanë humbur përsa i përket pozitës së tyre në tregun e punës, por kanë fituar nga pikëpamja arsimore. Çështja është nëse këto gra do të jenë në gjendje të shfrytëzojnë arsimimin e tyre për të gjetur punë të përhershme të paguara më mirë, pavarësisht nga përgjegjësitë shtëpiake. Për fat të keq, ka pak bazë për optimizëm në rast se merren si udhërrëfyese zhvillimet në vende të tjera të Europës lindore. Së fundmi, ka shumë rëndësi të vihet në dukje se perspektiva gjinore nuk duhet të nisë nga përgjigjet, por nga pyetjet. Studimet për çështjet gjinore në Shqipëri janë të pakta, dhe në letërsinë e përgjithshme ajo që njihet si "Bibla e vendit" dhe që përfaqëson realitetin shoqëror është i famshmi Kanun i Lekë Dukagjinit që në fakt krijon një ide jo të saktë për të. Në një pjesë të madhe të letërsisë së huaj, shoqëria shqiptare portretizohet si një shoqëri shumë patriarkale, kurse gratë si skillave të burrave. Ne jemi përpjekur të argumentojmë gjatë gjithë këtij studimi se ky imazh është tejte i thjeshtëzuar për të përshkruar gjendjen e grave dhe burrave në Shqipëri sot, por edhe në të shkuarën. Tri fakte të rëndësishme nuk janë marrë ende në konsideratë: së pari, në vitin 1918 "Regjistrimi i parë shqiptar" tregonte se "padukshmëria e grave" nuk prononcohej as në vende të tjera të të njëjtit rajon; kjo sugjeron se edhe në ato ditë të hershme, shqiptarët duhet të kenë gëzuar më shumë barazi në marrëdhënjet gjinore sa sa vendet e tjera të rajonit. Së dyti, tipet e familjeve në Shqipëri janë shumë më heterogjene se sa ishte menduar, vecanërisht përsa i përket tipeve të ndryshëm të familjeve bërthamë. Së treti, "Regjistrimi i parë shqiptar" tregoi qartë se rajoni i veriut ndryshonte shumë

nga pjesa më e madhe e Shqipërisë përsa i përket respektimit më të ngurtë të rregullave të Kanunit. Kjo do të thote se përfytyrimi i Shqipërisë në përgjithësi ishte i pasaktë që në vitin 1918. Në kohët e sotme Kanuni dhe ndikimi i tij në kushtet e jetesës dhe në marrëdhëniet gjinore është akoma më pak përfaqësues i jetës së përditshme të vendit. Por për fat të keq, studiuesit e huaj përsëri i kanë kushtuar pak rëndësi faktit se socializmi u siguroi grave arsimim, një pozitë të pranuar shoqërore në tregun e punës, dhe mbështetje institucionale (për shembull, kujdesin për fëmijët). Kjo gjë u dha mundësi grave të rrisin gamën e veprimtarive të tyre, si edhe shkallën dhe hapjen ndaj influencave të tjera në identitetin e tyre. Prandaj vihet në pikëpyetje që të gjitha këto të jenë zhdukur pas rënjes së socializmit. Edhe nëse gratë kanë pësuar një humbje të madhe në tregun e punës dhe në arenën politike, kjo nuk do të thotë se shoqëria është kthyer prapa në mënyrën patriarkale të të jetuarit që mishërohet në Kanun. Për më tepër, influencat e huaja në Shqipëri, si rezultat i emigrimit, (Nicholson 2002), medias, dhe hyrjes së agjensive ndërkombëtare (Sampson 1996) i kanë ndryshuar tepër mendimet në vend. Shumë gra të reja shkojnë jashtë për studime me shpresë që të ndjekin karriera profesionale. Shumë gra janë të angazhuara në organizata civile të komunitetit, edhe pse pjesëmarrja e tyre në pozita vendimmarrëse politike është ulur në mënyrë të ndjeshme. Kjo situatë ka të ngjarë të mbetet e njëjtë në rast se nuk zbatohen strategji pro-active dhe afirmuese politike për t'i inkurajuar gratë të bëhen active politikisht. Ndryshimet e shpejta në dekadën e kaluar kanë krijuar mendime dhe mënyra të reja të të menduarit, edhe pse nuk kanë krijuar mundësi të reja ekonomike. Këto ndryshime do të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në jetën e grave dhe të burrave, veçanërisht të brezit të ri, që zakonisht është më i hapur ndaj ndryshimeve kulturore. Edhe pse gratë nuk kanë mundur të zënë pozitën më të "fuqishme" në shoqëri, siç janë ato në politikë dhe ekonomi, ne nuk

shohim ndonjë arsye për të besuar se ato do të kthehen në pozitën e nënshtruar në shtëpi që përkrahej pjesërisht edhe nga regjimi socialist. Në fakt, studimet cilësore në Shqipëri tregojnë (për shembull Sampson 1996), se po ndodhin ndryshime graduale në ndarjen e punës midis burrave dhe grave në nivel komuniteti. Një ndarje gjinore po bëhet e dukshme midis sektorëve privatë dhe publikë të ekonomisë, një përqindje e lartë e grave punojnë në institucione shtetërore, sidomos në fusha të tilla si kujdesi shëndetësor, arsim, shërbime sociale, dhe në statistika. Gratë e reja, nga ana e tyre, shpesh rekrutohen për të bërë punë në "frontin e parë" (që nënkupton punë ku kontakti me klientët dhe përshtypja që lënë tek ta janë të rëndësishme). Ka rëndësi të mbahet mend në këtë kontekst se punësimi në sektorin publik në përgjithësi është më pak i paguar se sa puna në sektorin privat. Nga ana tjetër, burrat ka më shumë të ngjarë të punojnë në sektorin privat, sidomos në industrinë e ndërtimit që është në lulëzim. Edhe pse është ende shumë herët të përqëndrohemi tek çështjet gjinore që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës së njerëzve, megjithatë, ato duhet të mbahen parasysh në dritën e ndryshimeve të shpejta që ndodhin në Shqipëri.

Rëndësia që ka kjo për marrëdhënjet gjinore mbetet ende për t'u diskutuar dhe duhet monitoruar nga regjistrimi dhe nga studime të tjera në të ardhmen. Si konkluzion i përgjithshëm, mund të themi se shohim që duhen bërë kërkime të mëtejshme për ndikimin që kanë transformimet e fundit të Shqipërisë në çështjet sociale dhe gjinore. Marrëdhëniet tradicionale midis burrave dhe grave na japin një kontekst të rëndësishëm për këto çështje, por nuk janë aq të rëndësishme sa të vihen në qendër të kërkimeve. Ndonëse edhe sot në Shqipëri vazhdojnë të ekzistojnë qëndrime patriarkale, shoqëria shqiptare është shumë më tepër heterogjene nga sa lë të kuptohet imazhi i saj jashtë vendit. Përqasja e shkencëtarëve të

çështjeve shoqërore në vazhden e kërkimeve nuk duhet të jetë e verbër ndaj gjinisë. Supozimet e paqarta për kushtet e jetesës së burrave dhe të grave në familje duhen vënë në pikëpyetje, kurse përparimi i transformimeve të fundit duhet hetuar për të parë ndikimin që ka gjinia në të. Në praktikë, ne presupozojmë se regjistrimet e ardhshme në Shqipëri do të përfshijnë pyetje të qarta dhe të sakta për ndarjen e punës në familje për të përcaktuar se cilët anëtarë janë përgjegjës për detyra të veçanta. Këto duhet të përfshijnë pyetje për fitimin e të ardhurave, punët e shtëpisë, dhe veprimtaritë e kujdestarisë. Monitorimi i ndryshimeve në ndarjen e punës në shtëpi është shumë i rëndësishëm, meqenëse shpesh ndryshimet në pozitën e grave çojnë në ndryshime në pozitën e burrave, që mund të kenë një efekt transformues në struktura sociale më të përgjithësuara.

Gjithashtu sugjerojmë që regjistrimet e ardhshme të mbledhin informacione specifike për marrëdhëniet në familjet e migrantëve. Për shembull, ato duhet të përfshijnë pyetje për kontributet ekonomike individuale në familje, sikurse edhe për influencën vendimmarrëse të individëve. Çështja se si mund të përkthehen këto gjetje në politika specifike është komplekse, veçanërisht duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë. Gjithsesi, një pasojë është e qartë: Gjinia duhet të dalë në pah në kontekstin e hartimit të politikave. Siç thotë Caroline Moser, "...për sa kohë kërkimet për gratë do të mbeten në listën 'shtesë', rezultatet do të lihen jashtë përfshirjes në politiken urbane dhe nuk do të influencojnë axhendat e rëndësishme politike... Për shumë studiues, përparësia numër një .... është të sjellin në vëmendjen e të gjithëve atë që vazhdon të mbetet ende një shqetësim vetëm për specialistët, dhe përkthimin e saj në politika dhe praktika" (cituar në Chant 1996: 47).

## Bibliografia

- Alderman, Harold (2002).** Do local officials know something we don't? Decentralization of targeted transfers in Albania. *Journal of Public Economics*, (83):375-404.
- Bahsin, Kamla (2000).** *Understanding Gender*. New Delhi.
- Budowski, Monica (2002).** Lone Motherhood in Costa Rica: A Threat for Society or a Chance for Change? Pp. 121-144, in: Christian Giordano and Andrea Boscoboinik (Eds.), *Constructing Risk, Threat, Catastrophe. Anthropological Perspectives*. Fribourg: University Press Fribourg.
- Buvinic, Mayra and Geeta Rao Gupta (1997).** Female-Headed Households and Female-Maintained Families: Are They Worth Targeting to Reduce Poverty in Developing Countries. *Economic Development and Cultural Change*, 45 (2):259-280.
- Calloni, Mariana (2002).** *Albanian Women after Socialism and the Balkan War*. Utrecht: Utrecht University.
- Chafetz, Janet Saltzman (1990).** *Gender Equity: An Integrated Theory of Stability and Change*. Newbury Park, London New Delhi: Sage Publications.
- Chant, Silvia (1996).** *Gender, Urban Development and Housing*. New York, USA: United Nations Development Programme (UNDP).
- Chant, Sylvia (1997a).** *Women-Headed Households. Diversity and Dynamics in the Developing World*. New York and London: St. Martins Press.
- Chant, Sylvia (1997b).** Women-Headed Household: Poorest of the Poor? Perspectives from Mexico, Costa Rica and the Philippines. *IDS Bulletin*, 28 (3):26-48.
- Chant, Sylvia (2003).** Dangerous Equations? Female Household Headship and the Feminization of Poverty: Fictions, Facts and Forward Strategies. Paper read at the *International Workshop: Feminist Fables and Gender Myths: Repositioning Gender in Development Policy and Practice*, 2-4 July 2003, at the Institute of Development Studies, Sussex, UK.
- Cohen, Yehudi A. (1969).** Ends and Means in Political Control: State Organization and the Punishment of Adultery, Incest, and Violation of Celibacy. *American Anthropologist, New Series*, 71 (4):658-687.
- Çuli, Diana (2000).** *Ese për Gruan Shqiptare*. Tiranë.

- de Gaay Fortman, Bas (2000).** Dilemmas of Transition: The Case of Albania. Pp. 77-96, in: Faros Tarifa and Max Spoor (Eds.), *The First Decade and After. Albania's Democratic Transition and Consolidation in the Context of Southeast Europe*. The Hague: CESTRAAD, Institute of Social Studies.
- Dixon, Ruth (1978).** Rural Women at Work: Strategies for Development in South Asia. *Baltimore: John Hopkins Universtiy Press*.
- Ekonomi, Milva, Marta Muco, and Fatmira Rama (1999).** Gruaja dhe Ekonomia ne Tranzicionin Shqiptar. Pp. 47-85. Tirana.
- Fernández Kelly, María Patricia (1981).** The Sexual Division of Labor, Development, and Women's Status. *Current Anthropology*, 22 (4):414-419.
- Fuga, Artan, Rasim Gjoka, and Zyhdi Dervishi (1998).** *Between Cultural Remote, Desolation and Invigoration*. Tirana.
- Fullani, Ariana (2000).** Gjinia, ligji dhe zhvillimi shoqëror në 10 vitet e tranzicionit post-komunist. Konferenca Kombëtare "90+10", Mars, 2000, Tiranë.
- Gal, Susan and Gail Kligman (eds.) (2000).** *Reproducing Gender. Politics, Publics, and Everyday Life after Socialism*. Princeton: Princeton University Press.
- Gjermeni, Eglantina and Zef Preçi** in collaboration with **Marsela Dauti and Daniela Kalaja (2003).** *Report on Gender and Agriculture*. Tirana: The Women's Centre.
- Gjoka, Esmeralda (2004).** Trauma, instinkt i shoqërisë shqiptare. Intervistë me sociologun e njohur, prof Edmond Dragoti. *Koha Jonë*, March 13, page 24.
- Grosh, Margaret, E. and Paul Glewwe (1998).** Data Watch: The World Bank's Living Standards Measurement Study Household Surveys. *The Journal of Economic Perspectives*, 12 (1):187-196.
- Gruber, Siegfried and Robert Pichler (2002).** Household Structures in Albania in the Early 20th Century. *History of the Family*, 7:351-374.
- Holland, J. (1998).** Does Social Capital Matter? The Case of Albania. *IDS Bulletin*, 29 (3):65-71.
- Holzner, Brigitte M. (2000).** Gender, Markets, and Transition in Albania. Pp. 113-123, in: Faros Tarifa and Max Spoor (Eds.), *The First Decade and After. Albania's Democratic Transition and Consolidation in the Context of Southeast Europe*. The Hague: CESTRAAD, Institute of Social Studies.
- INSTAT (2002).** *Popullsia e Shqipërisë në 2001*. Tiranë: INSTAT.
- INSTAT (2003).** *Femrat dhe Meshkujt në Shqipëri*. Tiranë: INSTAT.
- INSTAT (2004a).** *Migracioni në Shqipëri*. Tiranë: INSTAT.
- INSTAT (2004b).** *Njerzit dhe puna*. Tiranë: INSTAT.
- La Cava, Gloria and Rafaella Y. Nanetti (2000).** *Albania. Filling the Vulnerability Gap*. World Bank Technical Paper 480. Washington, D.C.: World Bank.
- Larrabee, F. Stephen (1990-1991).** Long Memories and Short Fuses: Change and Instability in the Balkans. *International Security*, 15 (3):58-91.
- McLanahan, Sara (1983).** Family Structure and Stress: A Longitudinal Comparison of Two-parent and Female-headed Families. *Journal*

of *Marriage and the Family*, (45):347-357.

**McLanahan, Sara (1985).** Family Structure and the Reproduction of Poverty. *American Journal of Sociology*, 90 (1):873-901.

**McLanahan, Sara and Karen Booth (1989).** Mother-Only Families: Problems, Prospects, and Politics. *Journal of Marriage and the Family*, 51:557-580.

**McLanahan, Sara and Irwin Garfinkel (1989).** Single Mothers, the Underclass, and Social Policy. *Annals, AAPSS*, 501:92-104.

**McLanahan, Sara and Irwin Garfinkel (1995).** Single-Mother Families and Social Policy: Lessons for the United States from Canada, France, and Sweden. Pp. 367-383, in: Katherine McFate, Roger Lawson, and William Julius Wilson (Eds.), *Poverty, Inequality and the Future of Social Policy. Western States in the New World Order*. New York: Russell Sage Foundation.

**Miria, Silvana (2000).** Nga viktimat e tipit të vjetër në viktime të tipit të ri. Konferenca Kombëtare "90+10", gruaja në tranzicionin post komunist, Tiranë.

**Nicholson, Beryl (2002).** The Wrong End of the Telescope: Economic Migrants, Immigration Policy, and How it Looks from Albania. *The Political Quarterly Publishing*:436-444.

**Occhipinti, Laurie (1996).** Two Steps Back? Anti-Feminism in Eastern Europe. *Anthropology Today*, 12 (2):13-18.

**Pahl, Jan (1983).** The Allocation of Money and the Structuring of Inequality within Marriage. *Sociological Review*, (31):237-262.

**Pahl, Jan (1989).** *Money and Marriage*. Basingstoke: Macmillan.

**Pritchett Post, Susan E. (1998).** *Women in*

*Modern Albania*. North Carolina: McFarland.

**Saltmarshe, Douglas (2001).** *Identity in a Post-Communist Balkan State. An Albanian Village Study*. Aldershot: Ashgate.

**Sampson, Steven (1996).** The social life of projects: importing civil society to Albania. Pp. 121-142, in: Chris Hann and Elizabeth Dunn (Eds.), *Civil Society: Challenging Western Models*. London: Routledge.

**Schlegel, Alice (1972).** *Male Dominance and Female Autonomy: Domestic Authority in Matrilineal Societies*. New Haven, CT: HRAF Press.

**Schwandner-Sievers, Stephanie (2001).** Albanian constructions of identity, violence and power in times of crisis. Pp. 97-120, in: Bettina E. Schmidt and Ingo W. Schröder (Eds.), *Anthropology of Violence and Conflict*. London: Routledge.

**UNDP (1999).** *Albanian Human development Report*. Tirana: UNDP.

**UNDP (2000).** *Human Development Report: Albania*. Tirana: UNDP.

**UNICEF (2003).** *Gender Report on Education*. Tirana: UNICEF Office of Albania.

**Varley, Ann (1996).** Women Heading Households: Some More Equal Than Others? *World Development*, 24 (3):505-520.

**Visweswaran, Kamala (1997).** Histories of Feminist Ethnography. *Annual Review of Anthropology*, 26:591-621.

**World Bank (1995).** *Toward Gender Equality*. Washington D. C.: IBRD/ World Bank.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Instituti i Statistikës

Gender Prespective in Albania=Perspektiva gjinore në  
Shqipëri / Instituti i Statistiës. – Tiranë : INSTAT, 2004.

60 f; 21m x 29.7cm.

ISBN 99927-973-5-5

314.68(496.5)

311.3 : 316.346.2(496.5)

316.346.2(496.5)(083.41)